



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 42/2021 regjistër (JR)
Datë 27.07.2021

Nr. 11 i vendimit
Datë 27.04.2022

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Albana Shtylla	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 27.04.2022, ditën e mërkurë, në orën 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonči Petković, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 363, datë 01.04.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet dhe kërkimet e Komisionerit Publik të paraqitura në ankim dhe në konkluzionet përfundimtare, i cili kërkoi përfundimisht

ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit objekt shqyrtimi dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, parashtimet dhe konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit që kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit, dëgjoi gjyqtaren relatores Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), ka ushtruar detyrën e prokurores. Më datë 01.08.2018, ajo është komanduar në funksionin e drejtueses së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹. Ajo iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe e ligjit nr. 84/2016, me shortin e hedhur në datën 17.09.2018.
2. Mbështetur në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”). Konkretisht:

2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit², ka konstatuar se: (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit dhe, pas hartimit të raportit të parë³, ka hartuar një raport të dytë të cilin, pasi e ka deklasifikuar pjesërisht, ia ka dërguar Komisionit në datën 29.10.2019. Në raportin e dytë, DSIK-ja referon se disponon të dhëna për *përfshirje* të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit të saj, z. A. B., në ushtrim ndikimi të paligjshëm me qëllim mbylljen e një çështjeje në hetim, e cila nuk ka pasur vijimësi dhe nuk është sqaruar/thelluar/vërtetuar. Ndër të tjera, në raport thuhet se *informacionet e përcjella nga autoritetet verifikuese për subjektin e rivlerësimit, nuk vërtetojnë përfshirjen në veprimtari të kundërligjshme të subjektit të rivlerësimit, nuk janë vërtetuar dhe as nuk janë marrë nga burime të besueshme dhe me akses. Informacioni për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur vijimësi.* Në konkluzion, pasi DSIK-ja konfirmon konstatimin fillestar për përshtatshmërinë në

¹ Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr. 71, datë 26.03.2021, e caktoi subjektin e rivlerësimit në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një periudhë 3-vjeçare, nga data 26.03.2021 deri në datën 25.03.2024:

<https://klp.al/wp-content/uploads/2021/03/vendim-nr-71-date-26.03.2021.pdf.pdf.pdf>

² Dërguar raporti nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. {***} prot., datë 25.07.2018.

³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 30.10.2017, DSIK-ja ka përcjellë vlerësimin për përshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit.

vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit, sugjeron që rasti në fjalë të vlerësohet nën dritën e informacioneve të tjera që mund të disponohen nga Komisioni, si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ të thelluar.

2.3. KLP-ja ka kryer analizën e aftësive profesionale sipas raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të datës 15.4.2019, dhe e ka dërguar atë në Komision më datë 23.4.2019⁴.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin nr. 363, datë 01.04.2021, Komisioni vendosi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, pasi arsyetoi se ai kishte arritur nivel të mjaftueshëm për kriterin e pasurisë, të figurës dhe vlerësimit profesional. Sipas çështjeve të shqyrtuara për secilin kriter, Komisioni vlerësoi me arsyetimin e përmbledhur si vijon.

(i) Subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në *vlerësimin e pasurisë*, ka deklaruar saktë pasuritë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit; problematikat e konstatuara lidhur me pasuritë e ish-bashkëshortit në deklaratimet e kryera, bazuar në praktikën e ndjekur, nuk ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit; subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer deklarime kontradiktore gjatë procesit administrativ dhe iu përgjigj saktë pyetjeve të Komisionit lidhur me pasuritë.

(ii) Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të *kontrollit të figurës*. Hetimi administrativ nuk gjeti elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

(iii) Subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues *lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*. Nga denoncimet dhe gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, nuk u konstatuan problematika që mund të klasifikohen si shkelje apo mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit.

III. Shkaqet e ankimit

4. Më datë 05.07.2021, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, në zbatim të rekomandimit të ONM-së dhe të shtesës së rekomandimit (*addendum*), ka ushtruar të drejtën e ankimit kundër vendimit të Komisionit. Bashkëlidhur ankimit gjendet kopja e rekomandimit të ONM-së për ankim që mban datën 21.06.2021, nënshkruar nga 3 vëzhgues ndërkombëtarë. Bashkëlidhur rekomandimit gjenden dy gjetje të datave 06.08.2020 [nr. 646 prot.] dhe 21.10.2020 [nr. 849 prot.], si dhe dokumenti shtesë (*addendum*) i rekomandimit, i cili mban datën 29.06.2021 [nr. 408/2 prot.], nënshkruar nga tre vëzhgues ndërkombëtarë, bashkëlidhur të cilit gjenden disa dokumente: (i) dokumente të lëshuara nga autoritetet italiane të drejtësisë; dhe (ii) vendimi nr. {***}, datë 20.04.2016, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me kërkues Prokurorinë pranë kësaj gjykate, e përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit.

⁴ Dërguar me shkresën nr. {***} prot.

5. Në ankimin e tij, Komisioneri Publik ka argumentuar se në arritjen e përfundimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Komisioni është mbështetur në arsyetime dhe interpretime të gabuara lidhur me përmbajtjen dhe zbatimin e dispozitave kushtetuese dhe legjisllacionit të posaçëm. Ankimi i Komisionerit është ushtruar për të tria kriteret e rivlerësimit, bazuar në shkaqet e mëposhtme.

5.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë – ndryshe nga arsyetimi dhe përfundimet e Komisionit, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit pas kalimit të barrës së provës, në kuptim dhe zbatim të nenit D, paragrafët 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës. Konkretisht, lidhur me:

5.1.1. Deklarimin e regjimit pasuror për shkak të martesës – argumentimi ligjor i Komisionit nuk bazohet në një vlerësim të plotë të provave të administruara. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat e interesave privatë, ka deklaruar pasuri të paluajtshme në bashkëpronësi, nga ku nuk dëshkohet për regjim pasuror të *pasurive të ndara*. Një regjim pasuror i tillë do të kishte sjellë efekte dhe pasoja në pasuritë e deklaruara.

5.1.2. Deklarimin e pasurive – nga krahasimi i deklaratave të interesave privatë që përbëjnë provë me deklaratën *vetting*, në funksion të kontrollit të saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaramit dhe burimit të ligjshëm të pasurive, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, vërehet se:

i) *Për pasurinë e paluajtshme truall me sipërfaqe 2.500 m²*, e ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, për krijimin e së cilës ka shërbyer edhe pasuria *me sip. 400 m²*, ndodhur në {***}, Tiranë – subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, dhe neneve 33, pika 5, germa “b” e 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

ii) *Për pasurinë e paluajtshme me sipërfaqe 66 m² dhe shtesën [e legalizuar] me sipërfaqe 70,4 m²*, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë – për shkak të deklaramimeve kontradiktore të subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting*, në deklaratat e interesave privatë, deklaramimet përgjatë procesit të rivlerësimit, si dhe shpjegimeve dhe dokumentacionit të përcjellë në lidhje me këtë pasuri të paluajtshme gjatë hetimit administrativ, është e pamundur të verifikohet pasqyrimi i situatës së vërtetë lidhur me krijimin e tyre dhe, për rrjedhojë, pamundësi objektive për të kontrolluar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të tyre. Në këto rrethana, deklaramiti i subjektit të rivlerësimit është i pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

iii) *Për pasurinë e paluajtshme apartament me sipërfaqe 73 m²*, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë – deklaramiti i subjektit të rivlerësimit është i pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

iv) *Për kredinë në emër të subjektit të rivlerësimit marrë pranë BKT-së, në vitin 2006, në vlerën 2.000.000 lekë* – subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm,

në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germa “b” e 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

v) *Për pasurinë e paluajtshme godinë banimi 5-kate*, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë – subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germa “b” e 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

5.2. Për kriterin e kontrollit të figurës – 2 (dy) gjetjet nga ONM-ja, të paraqitura gjatë hetimit administrativ, ajo e datës 08.10.2020 dhe ajo e datës 21.10.2020, konsiderohen në cilësinë e provës që dëshmojnë faktin, rrethanën apo standardin ligjor të parashtruar në të dhe, si të tilla, duhet të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), dhe eventualisht të ballafaqohen me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, përfshirë edhe sa është parashtruar në shtesën e rekomandimit (*addendum*), duke mbajtur në konsideratë po ashtu edhe marrëdhëniet e interesit financiar të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, në kushtet e të ardhurave të siguruara nga ana e vëllait të personit të lidhur, në krijimin e pasurive të deklaruara për efekt të procesit të rivlerësimit.

5.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale – gjetja e ONM-së e datës 06.08.2020, u referohet dy procedimeve penale në të cilat subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e prokurorit të çështjes dhe argumentet e pasqyruara në gjetje duhet të merren në shqyrtim nga Kolegji dhe të ballafaqohen me pretendimet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit. Në këtë linjë duhet analizuar sa parashtron shtesa e rekomandimit (*addendum*), lidhur edhe me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda me nr. 51/2016, në çështjen me të pandehurin C. A. P. T., akuzuar për veprën penale të trafikimit të narkotikëve, në të cilin prokuroria përfaqësohet nga subjekti i rivlerësimit.

5.4. Çështje të etikës dhe vlerësimit tërësor – gjetjet e ONM-së që mbajnë datat: (a) 30.09.2020, lidhur me ndikimin tek ish-vëzhguesi ndërkombëtar; (b) 21.10.2020, lidhur me procedurat gjyqësore të divorcit të subjektit të rivlerësimit; (c) 21.12.2020, lidhur me dorëheqjen e njëres nga anëtarët e trupës gjyqësore të Komisionit, në kuadër të vlerësimit tërësor të çështjes, si dhe sjellja e subjektit të rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore në Komision përkufizohet si e tillë që, e vetme, konsiderohet e mjaftueshme për minimin e besimit në sistemin e drejtësisë.

6. Në ankim, Komisioneri Publik ka argumentuar që gjetjet që lidhen me kriterin e figurës dhe të aftësive profesionale, duhet të vlerësohen nga Kolegji në cilësinë e *provës*, në vlerësimin tërësor të çështjes, bazuar në parashikimet e nenit 4, pika 2 dhe nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

7. Në përfundim, Komisioneri Publik ka kërkuar që shkaqet e parashtruara në ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit dhe, pas vlerësimit tërësor të procedurave, në përfundim të gjykimit të çështjes, të vendosë ndryshimin e vendimit të Komisionit [nr. 363, datë 01.04.2021] dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj. Në konkluzionet e tij

përfundimtare, Komisioneri Publik parashtrori se gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e shkaqeve të ankimit dhe se ndodhet në situatën e parashikuar nga neni 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.

8. Bazuar në pikat 3 dhe 7 të nenit F të Aneksit të Kushtetutës, në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik i kërkoi Kolegjit ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 363, datë 01.04.2021, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj.

IV. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit

9. Më datë 21.06.2021, tre vëzhgues ndërkombëtarë të ONM-së kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, *Rekomandim për paraqitje ankimi* ndaj vendimit objekt shqyrtimi⁵ të Komisionit. Në mënyrë të përmbledhur, rekomandimi trajton çështjet që lidhen me vlerësimin e të tria kriterëve për subjektin e rivlerësimit, duke sjellë në pah sa vijon.

9.1. Për kriterin e kontrollit të pasurisë – janë evidentuar çështjet: (a) *kredi bankare* të subjektit të rivlerësimit në BKT Bank; (b) *pasuri e paluajtshme* me adresën: rruga “{***}”, Tiranë, shpenzime për legalizimin e shtesës në këtë pasuri dhe çështjet lidhur me pasurinë e paluajtshme me adresë në rrugën “{***}”, Tiranë; (c) *pasuri e paluajtshme*, banesë në katin e tretë të godinës 5-katëshe, me adresë në rrugën “{***}”, Tiranë; (ç) *pasuri e paluajtshme*, truall me sip. 2.500 m², me adresë “{***}”, Tiranë dhe çështje të lidhura me to.

9.2. Për kriterin e kontrollit të figurës – për cenimin e besimit të publikut lidhur me gjetjen për procedimet penale nga autoritetet gjyqësore italiane të shtetasve A. B. (ish-bashkëshorti) dhe A. B. (ish-kunati), në vitin 2002.

9.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale – mbi rrethanat dhe arsyet e sjelljes së subjektit të rivlerësimit si prokuror në dy procedime penale ndaj shtetasve Xh. M. dhe B. P., si dhe gjykimin e çështjes penale ndaj shtetasit kolumbian C. A. P. T. (paraqitur me shtesën e rekomandimit – *addendum*).

9.4. Për vlerësimin në tërësi – janë parashtruar çështjet lidhur me: (a) fiktivitetin e divorcit të subjektit të rivlerësimit me z. A. B.; (b) ndikimin e paligjshëm të subjektit të rivlerësimit te njëri prej ish-vëzhguesve ndërkombëtarë dhe njëres prej komisionerëve të Komisionit, që kishte qenë më herët pjesë e trupit gjykues gjatë procesit të rivlerësimit; si dhe (c) mënyrën joprofesionale të sjelljes së subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore të datës 24.03.2021.

10. Rekomandimit i janë bashkëlidhur:

⁵ Regjistruar pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë më datë 21.06.2021 [me nr. {***} prot.]. Shih: <http://ikp.al/wp-content/uploads/2021/06/Rekomandim-p%C3%ABr-vendimin-e-KPK-s%C3%AB-nr.-363-dat%C3%AB-1.4.2021.pdf>.

10.1. *Gjetjet e datës 06.08.2019*, në përmbajtje të të cilave janë paraqitur informacione⁶ në lidhje me hetimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në çështjet që përfshijnë shtetasin Xh. M., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike” [neni 283/2 i Kodit Penal] dhe procedimin penal në ngarkim të shtetasit B. P., i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Trafikim i lëndëve narkotike” [neni 283/a/2 i Kodit Penal], në bashkëpunim [neni 22].

10.2. *Gjetje e datës 21.10.2020*, e cila i referohet një denoncimi të publikut, të depozituar në ONM në datën 24.08.2020, në të cilin pretendohet se subjekti i rivlerësimit ka kryer divorc fiktiv. Në këndvështrim të një sjelljeje të mundshme joetike nga ana e subjektit të rivlerësimit në një nivel të tillë që cenon besimin te publiku, ONM-ja ka verifikuar nëse dhe sa përputhet “realiteti ligjor” – vendimi i zgjidhjes së martesës, marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 6 dhjetor 2019 – me realitetin “de facto” nëpërmjet parametrave që lidhen me arsyet për zgjidhjen e martesës, kohëzgjatjen e procedurës së zgjidhjes së martesës dhe pasojat e vendimit të zgjidhjes së martesës. Në përfundim të gjetjes, vëzhguesi ndërkombëtar ka propozuar që në funksion të procesit të rivlerësimit të subjektit, ky informacion të jetë pjesë e dosjes dhe të mbahet në konsideratë gjatë vendimmarrjes⁷.

11. Më datë 29.06.2021, tre vëzhgues ndërkombëtarë të ONM-së, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë një “Shtesë (*addendum*) të rekomandimit për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 363, datë 12.1.2021, të Komisionit.⁸ Bashkëlidhur saj, gjenden:

11.1. dokumente të autoriteteve italiane të përcjella nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë – të regjistruara pranë ONM-së më datë 09.06.2021, më datë 26.05.2021 dhe më datë 25.06.2021, të cilat përmbajnë informacion mbi procedimet penale në Itali të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit;

⁶ Sipas gjetjes, evidentohet se: (i) Është provuar se hetimi dhe shtyrjet janë të pambështetura dhe absolutisht të pajustificuara. Pavarësisht sa më sipër, më 29.12.2011, subjekti i rivlerësimit vendosi të shtyjë hetimin, të ndajë çështjen e Xh. M. nga procedimi kryesor nr. 13/2010, të shpallë moskompetencë dhe ta transferojë çështjen në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, duke arsyetuar se gjykimi ndaj A. M., I. T. dhe D. S., në lidhje me ngjarjet e qershorit 2010 (si dhe me atë të marsit 2010 për I. T. dhe D. S.), ka avancuar dhe ka arritur në atë fazë që e bën proceduralisht të pamundur që subjekti i rivlerësimit t'i drejtohet gjykatës me një kërkesë për gjykim për Xh. M.. Gjithashtu dhe për sa kohë që Xh. M. është i akuzuar vetëm për prodhim, sipas subjektit të rivlerësimit, vepra është jashtë kompetencës së Prokurorisë së Krimeve të Rënda, prandaj e ka transferuar çështjen në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. (ii) Është provuar se qasja e subjektit të rivlerësimit ndaj Xh. M. është e pajustificuar, krahasuar me të paktën një prej të hetuarve të tjerë dhe personave të akuzuar, A. M.. Theksohet se pas transferimit të çështjes së Xh. M. nga Prokuroria e Krimeve të Rënda te Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, pozita e personit të hetuar ishte qartësisht më e favorshme. Në vitin 2012, ajo gjykatë e shpalli Xh. M. të pafajshëm.

⁷ Sipas gjetjes, në mënyrën e trajtimit të kësaj çështjeje evidentohet se: (i) subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, e ka filluar procedurën e zgjidhjes së martesës me bashkëshortin e saj në bazë të arsyeve për të cilat ajo ka qenë në dijeni përpara se të martohej; (ii) subjekti i rivlerësimit ka marrë trajtim preferencial nga gjykata në shqyrtimin e kërkesëpadisë së saj për zgjidhje martesë; (iii) subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, pavarësisht kërkesëpadisë së saj bazuar në faktin se bashkëjetesa me bashkëshortin ishte bërë e pamundur, ka vazhduar të jetojë me të si çift normal, edhe pas zgjidhjes së martesës; (iv) pensioni ushqimor i caktuar nga gjykata për fëmijët nuk është paguar për 7 muaj derisa subjekti i rivlerësimit ka marrë dijeni për interesin e shtuar të ONM-së për rivlerësimin e saj.

⁸ Regjistruar pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë me nr. {***} prot., datë 29.06.2021 - <http://ikp.al/wp-content/uploads/2021/06/18.1.Shtes%C3%AB-Addendum-e-Rekomandimit-t%C3%AB-dat%C3%ABs-21.6.2021.pdf>.

11.2. një vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda [nr. 51, datë 20.04.2016], me të pandehur C. A. P. T., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Trafikim i narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/a/2-22 i Kodit Penal,⁹ ku prokuroria pranë kësaj gjykate është përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit.

III/1. Materialet e paraqitura nga ONM-ja gjatë hetimit administrativ të Komisionit

12. Gjatë hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, janë administruar 7 (shtatë) gjetje dhe 6 (gjashtë) opinione të ONM-së, lidhur me tri kriteret e rivlerësimit. Konkretisht, gjetjet janë si vijojnë.
13. *Për kriterin e pasurisë*, është administruar 1 (një) gjetje e regjistruar më datë 12.2.2020 [nga Hans Kijlstra]. Në vlerësimin e vëzhguesit, Komisioni duhet të përfshijë në rezultatet e hetimit të pasurisë gjetjet e specifikuar në aneksin bashkëlidhur gjetjes¹⁰ dhe t’i kalojë subjektit të rivlerësimit barrën e provës mbi rezultatet e hetimit për pasurinë; t’i japë subjektit të rivlerësimit mundësinë për shpjegime të mëtejshme dhe paraqitjen e provave të tjera, si dhe të japë qëndrimin e tij gjatë seancës dëgjimore; të vendosë pas seancës dëgjimore mbi procedurat e mëtejshme.
14. *Për kriterin e aftësive profesionale*, është administruar 1 (një) gjetje e datës 06.08.2020 – nëpërmjet së cilës jepen të dhëna për hetimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në dy çështje penale të ndjekura prej tij: atë që përfshin z. Xh. M. dhe procedimin penal në ngarkim të B. P. (B.P) – shtjelluar në detaj në paragrafin 10.1 më sipër.
15. *Për kriterin e figurës*, janë administruar 2 (dy) gjetje, përkatësisht:
 - (i) Gjetja e datës 08.10.2020, që lidhet me dënimin e A. B.t dhe A. B. me 8 vite burgim dhe gjobë në vlerën 55.000 euro, për përfshirjen e tyre në veprimtari të trafikimit të qenieve njerëzore dhe prostitucion. Bashkëlidhur gjendet i fotokopjuar në gjuhën italiane (i papërkthyer dhe i palegalizuar me vulë apostile) vendimi nr. 24781/02, datë 19.12.2002, i Gjykatës së Romës, Seksioni i Pestë Penal për dënimin e dhënë nga autoritetet italiane.
 - (ii) Gjetja e datës 21.10.2020, që lidhet me kontaktet e subjektit të rivlerësimit përtej datës 1 janar 2012, me persona të përfshirë në krimin e organizuar – konkretisht, kunati dhe bashkëshorti i saj (tashmë ish-bashkëshorti). Vëzhguesi ndërkombëtar referon gjetjen e datës 8 tetor 2020 që raporton dënimin përfundimtar të bashkëshortit dhe të kunatit të subjektit të rivlerësimit, siç

⁹ Me këtë vendim, Gjykata e ka dënuar të pandehurin me 15 vite burgim. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, me vendimin nr. 67, datë 10.06.2016.

¹⁰ Gjetjet lidhen me: (i) kredinë e marrë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2006; (ii) apartamentin te rruga “{***}”, Tiranë; (iii) të ardhurat nga fondi i emergjencës civile prej 780.551 lekësh; (iv) shtëpinë në katin e 3-të në rrugën “{***}”, Tiranë; (v) pasurinë e paluajtshme te rruga “{***}”, Tiranë; (vi) pasurinë e paluajtshme, truall prej 2500 m², te “{***}”, Tiranë; (vii) pasurinë e paluajtshme në {***}, Durrës; (viii) të ardhurat nga shitja e automjeteve; (ix) të drejtat reale të përfituara nga z. S. Sh. në shumën 5.000.000 lekë. Këto gjetje janë përfshirë në rezultatet e hetimit të Komisionit të datës 27.01.2021, me përjashtim të gjetjes lidhur me të ardhurat nga fondi i emergjencës civile, në shumën 780.551 lekë, pasi Komisioni nuk ka konstatuar problematika për këto të ardhura.

përcaktohet nga vendimi i gjykatës italiane – Gjykata Penale Romë – i datës 19.12.2002. Në përmbajtjen e gjetjes, thuhet se nga dokumentet në dosjen e çështjes dhe nga informacioni i disponueshëm publikisht, subjekti i rivlerësimit – pas datës 1 janar 2012 – ka jetuar në të njëjtën ndërtesë në rrugën “{***}”, Tiranë me bashkëshortin e saj (tani ish-bashkëshorti) dhe kunatin e saj (tani ish-kunati). Ndërtesa është ndërtuar nga bashkëshorti i saj (tani ish-bashkëshorti). Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të nenit Dh, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Mungesa e dijenisë nga subjekti i rivlerësimit, nëse do të provohej, mund të konsiderohet vetëm si një rrethanë lehtësuese sipas pikës 5 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016. Në çdo rast, për shkak të vazhdimësisë së mundshme të kontakteve, kjo situatë nuk e çliron Komisionin nga detyra për ta vlerësuar këtë sjellje negativisht nga pikëpamja etike, në këndvështrim të standardeve të njohura ndërkombëtarisht për etikën dhe duke pasur parasysh qëllimin e procesit të rivlerësimit. Më tej, vëzhguesi shprehet se sipas këtij skenari të fundit, zbatimi i saktë i standardeve ligjore të përshkruara në këtë dokument, duhet të passjellë referimin nga Komisioni të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, dhe të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

16. *Për çështje të etikës dhe të integritetit, janë administruar 3 (tri) gjetje, përkatësisht:*

(i) Gjetja e datës 30.09.2020, që përmban një “Deklaratë të fjalës së nderit”, dërguar nga ish-vëzhguesi ndërkombëtar, gjyqtari Hans Kijlstra nga Holanda, më datë 5 shtator 2020¹¹, si dhe denoncimin e marrë nga ONM-ja më datë 24 gusht 2020, dërguar nga z. Rr. Sh.. Në këtë material, Vëzhguesi Ndërkombëtar Theo Jacobs shprehet për sjellje joprofesionale dhe sjellje joetike/ushtim të ndikimit të paligjshëm në procesin e rivlerësimit¹². Vëzhguesi shprehet se këto lloj veprimesh nga zyrtarët që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kanë një efekt intimidues dhe mund të pengojnë rrjedhën normale të rivlerësimit. Këto fakte mund të tregojnë një model sjelljeje që është joetik, sidomos duke pasur parasysh se vetë subjekti i rivlerësimit thekson vazhdimisht të drejtën e tij të privatësisë. Këto praktika, me qëllim pengimin e hetimit nga Komisioni, duke bërë presion mbi anëtarët e institucionit të përfshirë në procesin e rivlerësimit, dhe që potencialisht dëmtojnë reputacionin e tyre, janë të papranueshme në një shtet demokratik dhe qartësisht nuk kontribuojnë në kthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë shqiptare.

¹¹ Sipas “Deklaratës së fjalës së nderit” të datës 5 shtator 2020, ish-vëzhguesi ndërkombëtar, gjyqtari Hans Kijlstra, deklaroi se: (1) subjekti i rivlerësimit ka kërkuar përjashtimin e tij si vëzhgues ndërkombëtar nga ndjekja e procesit të rivlerësimit të çështjes së saj; (2) subjekti i rivlerësimit e ka kontaktuar atë drejtpërdrejt me e-mail, në mënyrë që t’i shpjegonte situatën e saj personale; (3) ai ka marrë nëpërmjet burimeve të besueshme shqiptare, informacion se subjekti i rivlerësimit ishte në dijeni të plotë të vendndodhjes së tij dhe udhëtimeve të tij jashtë shtetit dhe dispononte një material video të tij dhe të “të dashurës së tij”; dhe (4) se ai ishte informuar nga një burim joshqiptar i besueshëm se ai ishte përndjekur nga subjekti i rivlerësimit, i cili e kishte fotografuar dhe filmuar atë.

¹² Sipas përmbajtjes së gjetjes, e-mail-i i dërguar z. Hans Kijlstra nga subjekti i rivlerësimit më 4 nëntor 2019, menjëherë pas mbërritjes së tij me fluturimin e mëngjesit nga Amsterdam, mund të perceptohet si synim i subjektit për të treguar dijeninë e vendndodhjes së vëzhguesit ndërkombëtar. Ky fakt mbështetet nga denoncimi i dërguar nga z. Rr. Sh., referuar më lart, sipas të cilit “[...] Elizabeta Imeraj ka financuar në mënyrë sekrete dhe të paligjshme survejimin e të gjithë anëtarëve të Komisionit dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, duke abuzuar me të dhënat e të afërmeve të tyre, nëpërmjet përdorimit të fakteve të nxjerra nga konteksti dhe kuptimi i tyre [...]”.

(ii) Gjetja e datës 21.10.2020, në lidhje me verifikimin e pretendimeve mbi fiktivitetin e zgjidhjes së martesës së subjektit të rivlerësimit¹³, duke konkluduar se provohet që: (1) subjekti i rivlerësimit e ka filluar procedurën e zgjidhjes së martesës për shkaqe për të cilat ai ka qenë në dijeni përpara se të marrohej; (2) subjekti i rivlerësimit ka përfituar trajtim preferencial nga gjykata në shqyrtimin e shpejtë të kërkesëpadisë për zgjidhje martese; (3) subjekti i rivlerësimit ka vazhduar të jetojë me bashkëshortin si çift normal, edhe pasi kanë zgjidhur martesën; (4) pensioni ushqimor i caktuar për fëmijët nuk është paguar për 7 muaj, derisa subjekti i rivlerësimit ka marrë dijeni për interesin e shtuar të ONM-së për rivlerësimin e saj.

(iii) Gjetja e datës 21.12.2020, në lidhje me: (1) kërkesën për heqje dorë të paraqitur nga komisionerja Etleda Çiftja më 26 nëntor 2020, duke specifikuar arsyet dhe ngjarjet që e kanë shtyrë për ta paraqitur atë dhe vendimin e marrë nga trupa gjyquese e caktuar me shortin e datës 3 dhjetor 2020, për të pranuar këtë kërkesë.

17. Ndërsa opinionet janë si vijojnë.

(i) Opinioni i datës 27.07.2020, lidhur me verifikimin e lëvizjeve të subjektit të rivlerësimit dhe personave shoqërues jashtë vendit në sistemin TIMS, me qëllim evidentimin e numrit të udhëtimeve dhe të kostove në lidhje me to, përfshirë edhe periudhën kohore nga data 01.01.2017 deri më 25.07.2020. Pjesë e këtij opinioni, ka qenë edhe një listë prej 13 kërkesash për informacion që sipas vëzhguesit, duhet t'i paraqiteshin subjektit të rivlerësimit lidhur me performancën profesionale të subjektit për veprimtarinë e tij në vitet 2018, 2019 dhe 2020; lidhur me situatën e subjektit pas divorcit, sipas vëzhguesit, duhet të pyetet subjekti për adresat zyrtare të tij dhe të ish-bashkëshortit; lidhur me shkëmbimin e pasurive në vitin 2012, me vlera të ndryshme, njëra me vlerë 4,5 milionë lekë dhe tjetra me vlerë 72 milionë lekë, si dhe me shërbimet juridike të ofruara nga ish-bashkëshorti për z. P. K. përpara vitit 2012, me vlerë 80.000 euro. Vëzhguesi është i mendimit që subjekti duhet të pyetet për të dhënë një panoramë të plotë të shërbimeve ligjore që ish-bashkëshorti ka kryer për z. P. K. përpara vitit 2012, mbështetur me dokumentacionin përkatës, përfshirë dhe dokumente nga gjykata.

(ii) Opinioni i datës 28.07.2020, lidhur me kontaktet telefonike të përditshme pas divorcit, ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortit, në dhjetor 2019, në numrat e përdorur prej tyre. Në këto kushte, ONM-ja ka kërkuar nga Komisioni që të kërkojë nga operatorët e telefonisë

¹³ Gjetja ka trajtuar çështjet mbi: (i) Arsyet për padinë e depozituar nga subjekti i rivlerësimit për zgjidhjen e martesës – bazuar në prezumimin që konfliktet midis profesorëve dhe studentëve nuk ndodhin përditë, subjekti i rivlerësimit duhet ta provojë mospasjen e dijenisë mbi incidentin në kohën e ndodhjes së tij. Deklarata e subjektit të rivlerësimit se ajo mori dijeni për këto fakte vetëm përpara se të depozitonte padinë e divorcit, nuk mund të jetë e besueshme në këtë moment. (ii) Kohëzgjatja e procedurave të zgjidhjes së martesës – që nga verifikimet, ka rezultuar se procedura e zgjidhjes së martesës në rastin e subjektit të rivlerësimit zgjati 43 ditë, çka mund të tregojë se subjekti i rivlerësimit ka përfituar nga trajtimi preferencial në shqyrtimin e çështjes. (iii) Pasojat e zgjidhjes së martesës: (1) pagesa e pensionit ushqimor mujor për fëmijët – vendimi i gjykatës nuk është zbatuar nga palët deri në korrik 2020 dhe asnjë pension ushqimor nuk është paguar për fëmijët për të paktën një vit dhe vetëm më 7 korrik 2020 - 7 muaj pas vendimit - kur u bë e qartë se ONM-ja filloi të hetojë thellësisht çështjen, një shumë prej 480.000 lekësh është transferuar në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit; (2) adresat e ndryshme të banimit të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj – në padinë drejtuar gjykatës, subjekti i rivlerësimit ka shprehur vullnetin e saj për zgjidhjen e martesës, bazuar në arsyetimin se nuk ishte më e mundur të bashkëjetonte me bashkëshortin e saj, A. B., ndërkohë që vazhdon dhe jeton në të njëjtën banesë edhe pas zgjidhjes së martesës.

celulare Telekom & Vodafone listën e telefonatave nga dhe prej dy numrave të specifikuar për periudhën 01.01.2018 – 31.07.2020.

(iii) Opinioni i datës 06.08.2020, lidhur me pensionin ushqimor që duhet të paguhet nga ish-bashkëshorti për dy fëmijët, është kërkuar dokumentacion nga subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, me fokus transfertat bankare që provojnë pagesën mujore të pensionit ushqimor nga ish-bashkëshorti i saj për fëmijët e subjektit të rivlerësimit, kopje të deklaratës tatimore vjetore të ish-bashkëshortit të saj duke filluar nga viti 2015. Po kështu, në vijim të informacionit që flet për *favorizim* të disa personave të hetuar për mashtrim dhe evazion fiskal nga ana e subjektit të rivlerësimit, është kërkuar informacion mbi hetimet penale të zhvilluara nga Prokuroria e Rrethit Tiranë që nga data 1 janar 2015, për këto vepra penale, prokurorët që kanë kryer hetimin dhe rezultatin përfundimtar.

(iv) Opinioni i datës 24.08.2020, lidhur me pastërtinë e figurës së disa biznesmenëve të lidhur me subjektin e rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, dhe ish-bashkëshortin e saj, nëpërmjet të cilit vëzhguesi ndërkombëtar ka propozuar që relatori i çështjes të kërkojë informacion nga subjekti i rivlerësimit mbi karrierën profesionale të ish-bashkëshortit të saj, nga ShISh-i, në lidhje me z. P. K. dhe znj. Xh. K. dhe lidhur me disa shtetas shqiptarë që jetojnë jashtë shtetit. Opinioni specifikon tre individë, për të cilët propozon të kërkohej shpjegim nga subjekti i rivlerësimit për lidhje familjare, si dhe nga ShISh-i, nëse ka informacione për ta.

(v) Opinioni i datës 01.09.2020, nëpërmjet të cilit është dhënë mendim lidhur me çështjen e *regjimit pasuror martesor të subjektit të rivlerësimit*, duke parashtruar çështje që fokusohen në regjimin pasuror martesor që ka pasur subjekti – nëse ai i bashkësisë ligjore ose i pasurive të ndara – dhe në varësi të këtyre përgjigjeve, informacion për si ka rrjedhur ky proces pas zgjidhjes së martesës, shoqëruar me provat përkatëse, sipas rastit.

(vi) Opinioni i datës 16.09.2020, lidhur me pasuritë e ndryshme të paluajtshme të blera ose të ndërtuara për llogari të subjektit të rivlerësimit dhe/ose ish-bashkëshortit të saj, për të cilat është kërkuar informacion për rrjedhën dhe vijueshmërinë e përfitimeve për shkak të 37% që i ka kaluar subjektit dhe personit të lidhur nëpërmjet kontratës me shoqërinë {***}, si dhe statusin e këtyre pasurive – nëse me qira, pala qiramarrëse, informacion për vlerën e qirave dhe nëse apartamentet janë shitur, duke kërkuar edhe dokumentacion justifikues. Po ashtu, opinioni propozon të kërkohej informacion mbi destinacionin e apartamentit me adresë në rrugën “{***}” dhe dokumentacion justifikues. Së fundmi, të kërkohej informacion rreth adresës së banimit të subjektit të rivlerësimit, ish-bashkëshortit të saj dhe të afërmeve të saj, meqenëse në pyetësonin e fundit, subjekti i rivlerësimit “*ka refuzuar të deklarojë adresën ku ajo banon aktualisht dhe adresën e ish-bashkëshortit*”, si dhe identitetin e banorëve të tjerë në ndërtesën ku subjekti jetonte më parë. Për sa i përket këtij informacioni të fundit, propozohet të kërkohej informacion zyrtar nga gjendja civile rreth adresës ku banon aktualisht subjekti i rivlerësimit, ish-bashkëshorti i saj (dhe që prej cilës periudhë) dhe në apartamentet e ndryshme në {***}, rruga “{***}”.

III/2. Materiale të paraqitura nga ONM-ja pas ankimit të ushtruar nga Komisioneri Publik

18. Pas depozitimit të ankimit të Komisionerit Publik, ONM-ja ka përcjellë në adresë të Kolegjit dy materiale, me përmbajtje si vijojnë.

18.1. Shkresë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, datë 02.07.2021 [nr. prot. {***}], mbërritur pranë ONM-së më 06.07.2021, në përgjigje të kërkesës për informacion më datë 14.06.2021, të shoqëruar me një ekstrakt nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, për sa u përket të dhënave që lidhen me gjendjen familjare të ish-bashkëshortit pas divorcit, z. A. B., certifikata familjare e vëllait të tij, z. A. B., si dhe fotografi të secilit prej tyre. Aktet dhe shkresat e hartuara nga ONM-ja i janë dërguar edhe Komisionerit Publik në të njëjtën datë, 08.07.2021.

18.2. Gjetje e datës 04.02.2022, përcjellë në Kolegj nga vëzhguesi ndërkombëtar Tonči Petković [me nr. prot 408/11], që lidhet me kontrollin e kriterit të figurës për subjektin e rivlerësimit. Në këtë gjetje, të shoqëruar me 20 dokumente mbështetëse, referuar edhe gjetjeve të ONM-së më datë 08.10.202 dhe 21.10.2020, vëzhguesi konkludon që ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A. B., dhe i vëllai i tij, z. A. B., janë individët të cilët, nën identitet të rremë, janë dënuar me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Romë, për veprat penale të emigracionit të paligjshëm, shfrytëzim prostitucioni në vazhdimësi dhe në bashkëpunim dhe rrëmbim personi në vazhdimësi, po ashtu kryer në bashkëpunim. Sipas të dhënave, z. A. B. është dënuar me shtatë vite burg dhe gjobë prej 54 mijë eurosh dhe se ky vendim u shfuqizua nga Gjykata e Apelit Romë. Ndërsa, z. A. B. është dënuar me vendim përfundimtar prej shtatë vjetësh burg dhe gjobë prej 54 mijë eurosh, dënim i cili më pas është ulur në katër vite burg dhe gjobë 10 mijë euro, si pasojë e zbatimit të një mase faljeje, e cila ndonëse redukton dënimin, nuk zhbën përgjegjësinë penale. Subjekti i rivlerësimit mund dhe duhet t'i kishte njohur këto fakte dhe raportuar ato sipas nenit 35, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Këto fakte, konkludon gjetja, duhet të vlerësohen në kuadër të kontrollit të figurës, por edhe të vlerësimit tërësor të subjektit të rivlerësimit.

V. Kundërankimi i subjektit të rivlerësimit

19. Më datë 12.07.2021, subjekti i rivlerësimit paraqiti kundërankim¹⁴, nëpërmjet të cilit pretendoi se ankimi ndaj saj është paraqitur përtej afatit ligjor prej 15 ditësh, duke qenë se është depozituar më datë 06.07.2021, ndërkohë që afati i ankimit ka filluar më datë 21.06.2021. Sipas subjektit të rivlerësimit, pretendimet e ngritura nga vëzhguesi ndërkombëtar në rekomandimin drejtuar Komisionerit Publik, u referohen të njëjtave argumente për të cilat ajo ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur prova mbështetëse dhe për të cilat Komisioni ka konkluduar se nuk përbëjnë elemente që të kenë cenuar figurën apo aftësitë profesionale. Në mënyrë të përmbledhur, pretendimet e subjektit të rivlerësimit fokusohen në faktin që:

19.1 Pasuritë objekt ankimi janë krijuar përpara martesës dhe se pavarësisht pasaktësive, deklaratimet e interesave privatë nuk mund të ndryshojnë origjinën, kohën dhe të drejtën e pronësisë së personave mbi këto pasuri. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, parashtron se ajo dhe ish-bashkëshorti i janë nënshtruar regjimit pasuror të ndarë dhe kanë nënshkruar kontratën

¹⁴ Regjistruar pranë Komisionit me nr. {***} prot.

martesore të redaktuar përpara lidhjes së martesës dhe të regjistruar në regjistrin e gjendjes civile, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme e kudo tjetër. Për pasuritë objekt ankimi, përkundër qëndrimit të Komisionerit Publik të shprehur në ankim, subjekti i rivlerësimit parashtrohet se:

19.1.1. *Pasuria me sipërfaqe 2.500 m², e ndodhur tek {***}, Tiranë* – nuk ka qenë asnjëherë në pronësinë e saj, bazuar në origjinën e krijimit dhe veprimeve juridike të kryera mbi të. Komisioneri Publik nuk mban në konsideratë periudhën e krijimit dhe pronësinë faktike dhe ligjore të saj. Sipas subjektit të rivlerësimit, ka dokumente që tregojnë pasuri të krijuara para lidhjes së martesës, siç janë kontrata për regjimin e pasurive të ndara, kontrata e fitimit të pasurive (3 pasuri) të ndodhura në {***}, Tiranë, të financuara dhe të krijuara para lidhjes së martesës, aktet shkresore, përfshirë deklaratën e palëve dhe aktverifikimin e pasurisë me sipërfaqe 400 m², pasuritë e ndodhura në {***}, Tiranë e që përmes shkëmbimit kanë krijuar pasurinë me sipërfaqe 2.500 m², të ndodhur tek {***}, Tiranë.

19.1.2. Ajo ka dhënë pëlqimin për kryerjen e shkëmbimit të pasurive me kërkesë të noteres, gjatë përpilimit të kontratës, ndonëse sipas ligjit nuk ka pasur asnjë tagër pronësie ndaj pasurive të ndodhura në {***}, të cilat shërbyen për krijimin e pasurisë me sipërfaqe 2.500 m². Pasuritë në {***} janë fituar me kontratë shitblerjeje nga ish-bashkëshorti përpara lidhjes së martesës, siç vërtetohet nga aktet shkresore të cilat konfirmojnë periudhën e fitimit dhe financimin për blerjen e tyre. Parcela me sipërfaqe 400 m² është fituar formalisht nga ish-bashkëshorti me kontratën e qershorit të vitit 2007, pas lidhjes së martesës, ndërsa pagesa është likuiduar në vitin 2006, sikurse rezulton nga deklarata e datës 02.10.2006. Për shkak të pasaktësive në kartelën e pasurisë, kontrata e shitblerjes u realizua pas saktësimit të këtij dokumenti.

19.2 Krijimi i tri parcelave në {***} është financiar nga të ardhurat e ish-bashkëshortit dhe të vëllait të tij, të krijuara përpara lidhjes së martesës. Për këto pasuri, ajo nuk ka të drejtë pronësie, nuk ka pasur të drejtë të disponojë mbi to në ndonjë lloj forme, dhe nuk ka krijuar apo deklaruar të ardhura individuale nga përdorimi i tyre. Përkundër shkakut të ankimit, subjekti parashtrohet se ka deklaruar saktë origjinën, burimin e krijimit dhe pronësinë individuale të bashkëshortit dhe këto pasuri rezultojnë të përfshira në regjimin e pasurive të ndara sipas kontratës së nënshkruar para lidhjes së martesës.

19.2.1. *Pasuria e paluajtshme me sipërfaqe 66 m² dhe shtesa me sipërfaqe 70,4 m², të ndodhura në rr. “{***}”, Tiranë* – ish-bashkëshorti i saj gëzon të drejtë reale dhe premtim për blerjen e kësaj pasurie. Në momentin e fitimit, kjo pasuri, edhe formalisht, do të qëndrojë individuale e tij. Prej kësaj pasurie, subjekti nuk tërheq asnjë të drejtë. Shtesa është ndërtuar dhe vetëdeklaruar në vitin 2006, periudhë në të cilën nuk ka pasur asnjë marrëdhënie apo vullnet për krijimin, ndryshimin apo shuarjen e të drejtave mbi këtë pasuri. Duke qenë pasuri e krijuar para martesë, ajo nuk i ka disponuar këto pasuri në asnjë lloj mënyre, si dhe nuk ka deklaruar të ardhura të krijuara prej tyre.

19.2.2. Për legalizimin e shtesës, kanë shërbyer të ardhurat e ish-bashkëshortit si noter, si dhe të ardhurat nga dhënia me qira e kësaj pasurie. Janë depozituar bilancet dhe janë administruar përgjigjet nga ana e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë, lidhur me të ardhurat nga aktiviteti i noterisë. Për sa u përket të ardhurave nga qiratë, sipas kontratës për vitin 2015, detyrimi për shlyerjen e detyrimeve tatimore e, për rrjedhojë, edhe pagesat për interesat dhe gjobat, ka qenë i qiramarrësit. Megjithatë, pasi janë njoftuar nga ish-bashkëshorti, qiramarrësit i kanë likuiduar detyrimet përmes pagesave në DIVA ish-bashkëshortit. Të ardhurat për financimin e krijimit të pasurisë me sipërfaqe 66 m² janë financuar nga kredia në shumën 100.000 euro, ndërsa legalizimi i shtesës është financuar nga të ardhurat e ligjshme dhe të dokumentuara të ish-bashkëshortit.

19.3. *Pasuria e paluajtshme apartament me sipërfaqe 73 m², ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë* – përbën një pasuri të krijuar në vitin 1996 nga familja e ish-bashkëshortit. Ajo nuk ka shprehur vullnet për krijimin, ndryshimin apo shuarjen e të drejtave. Sipas subjektit të rivlerësimit, në vitin 2008, në marrëveshje mes vëllezërish, kjo pasuri i është shitur ish-bashkëshortit kundrejt vlerës prej 500.000 lekësh, për t’u përdorur si kolateral për kredinë që ky i fundit do të përfitonte te Banka Kombëtare Tregtare (në vijim “BKT”). Këto pretendime të saj janë konfirmuar edhe nga Komisioni dhe janë gjetur në përputhje me ligjin. Pasuria ka qenë e regjistruar në emër të vëllait të bashkëshortit. Statusi juridik i kësaj prone është sqaruar në kontratën e marsit të vitit 2007, përpara lidhjes së martesës. Kontrata e shitjes është redaktuar në datën 04.01.2008 dhe pronësia është regjistruar e ndryshuar brenda këtij muaji.

19.4. *Kredia e marrë në vitin 2006*, ka pasur për qëllim, sikurse është deklaruar në deklaratën e interesave privatë për vitin 2006 – për të ndihmuar prindërit. Sipas ligjit nr. 84/2016, nuk është detyrim në *deklaratën vetting* deklarimi dhe dhënia e shpjegimeve për këtë kredi të mbyllur, për të cilën ka dhënë përgjigje në pyetësorët gjatë procesit të hetimit. Përkundër pretendimeve të Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, parashtron se kredia nuk ka qenë kursim të cilit do të duhet t’i deklaronte gjendjen, por është detyrim. Kredia është deklaruar si e ardhur në vitin e fitimit sepse është tërhequr prej saj në momentin e disbursimit. Në rubrikën që u dedikohet detyrimeve në deklaratat e interesave privatë, ka shpjeguar këstet e likuiduara për të. Në përgjigje të pyetësorit, ka dhënë shpjegime të sakta dhe të plota për burimin e të ardhurave për likuidimin e kësaj kredie.

19.5. *Pasuria e paluajtshme, godinë banimi, kati i tretë, në rr. “{***}”, Tiranë* – përbën një pasuri individuale të ish-bashkëshortit, të krijuar para lidhjes së martesës, e pasqyruar në kontratën e regjimit të pasurive të ndara, të datës 27.03.2007 dhe e deklaruar në deklaratën e interesave privatë për vitin 2007. Për shkak të martesës, subjekti parashtron se e ka deklaruar si adresë banimi. Duke qenë se ndërtimi i saj është kryer përpara lidhjes së martesës dhe para se ajo të fillonte të jetonte aty, ajo nuk ka kontribuar dhe nuk ka disponuar asnjëherë për këtë pasuri në asnjë formë dhe se pronar ka qenë ish-bashkëshorti.

19.6. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit shprehet se pretendimet e Komisionerit Publik për pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme dhe pasaktësi në kuptim të nenit 61, pika 3

dhe nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, janë të pasakta dhe jorelevante me situatën juridike dhe detyrimet e saj në raport me këto pasuri të paluajtshme.

19.7. Në interpretimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016 që normojnë procedurën e vlerësimit të kriterit të pasurisë, subjekti konkludon se nuk ka pasur asnjë të drejtë pronësie mbi pasuritë e paluajtshme në pronësi të ish-bashkëshortit, të krijuara përpara martesës, të cilat i janë nënshtruar regjimit kontraktor të pasurive të ndara. Për këtë arsye, në bazë të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, detyrimi i saj është përmbushur plotësisht për sa i përket saktësisë të deklaramit të pasurisë.

20. Sa u përket shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e *kontrollit të figurës* – subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, parashtrori se janë të pasakta dhe të pabazuara në ligj dhe se ka paraqitur shpjegime dhe dokumentacion lidhur me pretendimin për dënimin e ish-bashkëshortit dhe ish-kunatit në Itali, në vitin 2002. Vëzhguesi ndërkombëtar, pavarësisht emërtesës që përdor [“gjetje”], ngre pretendime dhe bën analiza mbi fakte që nuk ekzistojnë dhe nuk janë të vërteta. Prezantimi i një vendimi dënimi për personat me të dhëna dhe gjeneralitete të ndryshme, nuk mund të përbëjë provë dhe aq më pak kontakte të papërshtatshme në ngarkim të saj. Këto “insinuata” nuk përmbushin kriterin ligjor për t’u prezantuar si gjetje në kuptim të nenit 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016. Mbi këto gjetje, subjekti ka dhënë shpjegime. Për më tepër, Komisioneri Publik nuk ngre pretendime të ndryshme nga ato që pasqyrohen në materialin e vëzhguesit ndërkombëtar dhe nuk paraqet asnjë argument, por ka dalë në konkluzione të përgjithshme të pabazuara në ligj dhe në fakte.
21. Lidhur me shkaqet e ankimit që i përkasin kriterit të *vlerësimit të aftësive profesionale* – subjekti parashtron se Komisioneri Publik nuk ka paraqitur asnjë argument, ndërsa kërkon që pretendimet e vëzhguesit të shqyrtohen sërish. Subjekti argumenton se ka dhënë shpjegime dhe prova përkundër pretendimeve të vëzhguesve ndërkombëtare, të cilat janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga Komisioni. Sipas subjektit, Komisioneri Publik nuk paraqiti asnjë argument që të mund të bënte cilësim të ndryshëm të fakteve dhe rrethanave, por ka dalë në konkluzione të përgjithshme e të pabazuara në ligj dhe në prova.
22. Subjekti i rivlerësimit mohon kategorikisht gjithë pretendimet për përgjim apo fotografim të ish-vëzhguesit ndërkombëtar Hans Kijlstra dhe kërkon që ONM-ja ta analizojë çështjen e saj objektivisht e mbi baza ligjore.
23. Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur kundërankimit vendimin e Gjykatës së Apelit të Romës, të datës 09.12.2004, në gjuhën italiane.

VI. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit përgjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj

24. Në parashtrimet e saj përpara trupit gjykues të Kolegjit dhe në funksion të kundërargumenteve për shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, i kërkoi Kolegjit¹⁵:
- (i) riçeljen e hetimit duke marrë në cilësinë e provës aktet në fashikullin e depozituar në Kolegj, si dhe aktet e reja të referuara prej saj në mbështetje të pretendimeve të ngritura;
 - (ii) t'u drejtohet institucioneve përkatëse për marrjen e informacioneve shtesë të nevojshme, si dhe thirrjen e dëshmitarëve, në kuadër të një hetimi të plotë dhe të thelluar;
 - (iii) lënien në fuqi të vendimit të Komisionit.
25. Përpos argumenteve të shtjelluara më sipër, të cilat pasqyrohen në pjesën që referon prapësimet e subjektit në kundërankim, në seancat publike të zhvilluara në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, dhe përfaqësuesi i saj ligjor, në mënyrë të përmbledhur theksuan sa vijon.

25.1. Sa i përket kriterit të kontrollit të pasurisë – ajo ka pasur mungesë dijenie të veprimeve të kryera nga ish-bashkëshorti përpara martesë. Po ashtu, në vlerësimin e saj, detyrimi për të provuar të ardhurat e vëllait të ish-bashkëshortit me anën e të cilave ai ka kontribuar në ndërtimin e pasurisë së paluajtshme në rr. “{***}” [paragrafi 19.5 më sipër] është në tejkallim të detyrimeve të saj në procesin e rivlerësimit.

25.2. Sa i përket kriterit të kontrollit të figurës – ndodhitë që përfshijnë ish-bashkëshortin, kanë ndodhur përpara martesë dhe është e pamundur të provohet dijenia e saj për këto ngjarje. Subjekti theksoi në fjalën përfundimtare edhe faktin që me vendimin e formës së prerë, ish-bashkëshorti është shpallur i pafajshëm. Në kuptim të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, ky fakt e çliron atë nga përgjegjësia në procesin e rivlerësimit për kontakte të papërshtatshme. Vëllai i ish-bashkëshortit është gjykuar në mungesë dhe, si pasojë, nuk ka pasur dijeni për vendimin penal të dhënë në ngarkim të tij nga Gjykata e Apelit të Romës. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, theksoi se përveç mungesës së dijenisë, ajo *nuk* ka pasur marrëdhënie interesi me ish-kunatin, faktor që do të kishte ndikim në procesin e rivlerësimit të saj. Së fundmi, subjekti i rivlerësimit kontestoi peshën e fakteve të pretenduara në gjetje përkundër raportit të vlerësimit pozitiv të hartuar për të nga DSIK-ja.

25.3. Sa i përket kriterit të vlerësimit profesional – ka kryer detyrën me përgjegjësi dhe seriozitet, nuk ka dhënë ndonjëherë dorëheqje, ka dërguar për gjykim mbi 160 të pandehur, ndër të cilët pafajësi kanë marrë vetëm 3 (tre) prej tyre. Gjetja për dy çështjet e procedimeve penale nuk pasqyron veprimtarinë e saj profesionale në mënyrë të drejtë.

¹⁵ Subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, autorizoi dhe u përfaqësua në prani të saj nga z. Gregory Thuan Diet Dideonne, avokat i licencuar pranë Dhomës së Avokatisë së Strasburg [Francë], në bashkëpunim me studion e avokatisë Meksi Law & Consulting, nën dritën e parashikimeve të nenit 23, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”.

25.4. Sa i përket ndikimit të paligjshëm ndaj ish-vëzhguesit Hans Kiljstra, rrethanave që passollën dorëheqjen e komisioneres Etleda Çiftja nga trupi i saj gjykues, si dhe pretendimit për zgjidhjen fiktive të martesës – denoncimi që përmban një sërë pretendimesh në dëm të saj, ishte anonim dhe, si pasojë, ka mungesë të theksuar kredibiliteti.

26. Në kërkimet përfundimtare, përfaqësuesi ligjor, avokati Thuan, parashtrori se:

- (i) Ankimi i ushtruar nga Komisioneri është përtej afatit 15-ditor.
- (ii) Ka mungesë përputhshmërie me të drejtat për proces të rregullt të subjektit përkundër pjesëmarrjes së vëzhguesve ndërkombëtarë në këshillim. Në këtë drejtim, ai kërkoi që Kolegji të mos zbatonte parashikimet e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, si në kundërshtim me nenin 6 § 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”).
- (iii) Gjetjet e datave 21.12.2020, 21.10.2020 dhe 30.09.2020 duhet të konsiderohen të papranueshme dhe të rrëzohen nga Kolegji si të pabazuara pasi nuk vendosin për një fakt, standard apo kusht – me fokus në zgjidhjen e martesës, ndikimin e paligjshëm mbi ish-vëzhguesin, vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Romës, bashkëngjitur shtesës së ankimit dhe kërkesës për përjashtim të komisioneres Etleda Çiftja.
- (iv) Gjetjet bien ndesh me dispozitat e nenit 6 § 1 dhe 3 të KEDNj-së për sa i përket barazisë së armëve, ndërhyrjes brenda kufijve të arsyeshëm dhe ruajtjes së të drejtave për mbrojtje.
- (v) Ndërhyrja në jetën private nëpërmjet gjetjeve, është e tepruar nën dritën e nenit 8 të KEDNj-së, është e pajustificuar, e pabazuar në ligjin vendas dhe disproporcionale.
- (vi) Asnjë nga nënpjesët e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, nuk gjen zbatim në rastin e subjektit të rivlerësimit.
- (vii) Duhet zbatuar parimi i proporcionalitetit dhe theksoi që sjellja e subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, në seancën gjyqësore publike në Komision nuk u karakterizua nga refuzimi për t’u përgjigjur, megjithëse edhe kjo është e drejtë e saj. Përfundimisht, sikurse edhe subjekti i rivlerësimit, ai kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

VII. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

I. Aspektet procedurale të gjykimit

27. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.
28. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Nga shqyrtimi i korrespondencës, konstatohet se njoftimi i vendimit të Komisionit është regjistruar pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë më datë 21.06.2021, ndërsa ankimi mban datën 05.07.2021 (dita e 15-të nga njoftimi), është postuar nëpërmjet shërbimit postar në të njëjtën datë

dhe është regjistruar në Komision më datë 06.07.2021. Neni 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 përcakton se vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Posaçëm të Apelimeve 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

28.1. Po ashtu, meqenëse afati i mësipërm përcaktohet me ditë, dita në të cilën ka filluar ngjarja përjashtohet nga përlllogaritja, nën dritën e përcaktimeve të nenit 148 të Kodit të Procedurës Civile¹⁶. Sipas nenit 149 të po këtij Kodi, dita e fundit e afatit vazhdon deri në orën 24:00, ndërsa afatet procedurale mbarojnë në çastin e mbarimit të orarit zyrtar, ndërkohë që afati nuk quhet i humbur kur kërkesa ose akti është dërguar me postë, edhe në ditën e fundit të afatit.

28.2. Në përmbledhje të sa më sipër, rezulton se ankimi i Komisionerit Publik është përcjellë me shërbim postar ditën e 15-të të datës së njoftimit të vendimit ose ditën e 14-të nga e nesërmja e datës së njoftimit, pra brenda afatit ligjor të parashikuar nga ligji. Në këto kushte, Komisioneri Publik legjitimohet *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

29. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për të garantuar zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, çështja objekt gjykimi u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, në prani të palëve, të cilat u zhvilluan në datat 08.03.2022, 30.03.2022, 31.03.2022, 01.04.2022, 12.04.2022 dhe 22.04.2022, ndërsa vendimi u shpall në datën 27.04.2022.

II. Mbi themelin e pretendimeve sipas shkaqeve të ankimit

A. Lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë

A.1. Lidhur me deklarinimin e regjimit pasuror për shkak të martesës

30. Komisioneri Publik argumenton se Komisioni nuk e ka bazuar qëndrimin mbi deklarinimin e regjimit pasuror martesor të subjektit të rivlerësimit në një vlerësim të plotë të provave të administruara. Sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasuri të paluajtshme në bashkëpronësi në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat e interesave privatë. Këto deklarime dëshmojnë se nuk ka një regjim pasuror të pasurive të ndara, ekzistenca e të cilit do të kishte pasojë në pasuritë e deklaruara.

30.1. Lidhur me këtë çështje, Komisioni ka argumentuar se, bazuar në kontratën e datës 27.03.2007 dhe në dokumentacion provues, ndër të tjera, është përcaktuar se pesë (5) pasuri, nga të cilat njëra e drejtë reale¹⁷, janë krijuar para lidhjes së martesës mes subjektit të rivlerësimit dhe

¹⁶ Neni 148, paragrafi i parë parashikon që: “Kur afati është caktuar me ditë dhe me orë, përjashtohet dita dhe ora në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati [...]”.

¹⁷ Pasuritë e referuara janë si vijojnë: (i) banesa në {***}; (ii) një njësi me sipërfaqe 73 m² në rrugën “{***}”; (iii) banesë me sipërfaqe 61 m², në {***}, Durrës; (iv) pasuri tokë arë me sipërfaqe 1.464 m², në {***}; dhe (v) e drejtë reale për pasurinë në rrugën “{***}”.

ish-bashkëshortit. Si të tilla, ato mbeten pasuri individuale të personit që i ka fituar apo i ka në pronësi.

30.2. Përkundër pretendimit të Komisionerit Publik, subjekti argumentoi se kontrata e regjimit pasuror është redaktuar në përputhje me ligjin dhe është regjistruar në institucionet ku ka rezultuar e nevojshme – në Gjendjen Civile, në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme etj. E ka bërë të ditur këtë fakt kur i është kërkuar, duke e sjellë “në mënyrë të përsëritur” në vëmendje të Komisionit. Subjekti kërkoi nga Kolegji të konstatojë që ajo nuk ka asnjë kontribut për krijimin e pasurive paramartesore të ish-bashkëshortit, sikurse nuk ka vjelë as të ardhura prej tyre. Po ashtu, subjekti kërkoi që Kolegji të verifikojë dhe administrojë aktet shkresore dhe dokumentet që kanë ekzistuar para lidhjes së martesës, mbi bazën e të cilave të çmohet edhe çdo dinamikë tjetër që ka ndodhur me këto pasuri. Duke pasur për bazë këtë kontratë – dhe jo për shkak të regjimit pasuror që ajo përcakton – të verifikohet detyrimi i saj në funksion të procesit të rivlerësimit, në kuadër të parimit të proporcionalitetit dhe mundësinë që ajo si subjekt ka pasur për të ndikuar në çfarëdolloj mënyre në krijimin apo financimin e tyre.

30.3. Në funksion të këtij shkakut ankimi, subjekti kërkoi nga Kolegji po ashtu edhe administrimin si provë të disa akteve që përfshinin shkresa nga zyra noteriale ku ajo ka lidhur kontratën e regjimit të pasurive të ndara më datë 27.03.2007, dokumentacion nga Zyra e Gjendjes Civile,¹⁸ korrespondencë me shkrim me ASHK (ish-ZVRPP) për regjistrimin e kontratës së regjimit pasuror¹⁹. Këto akte u vlerësuan nga trupi gjykues i Kolegjit nën dritën e përcaktimeve ligjore të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, i cili normon në mënyrë të detajuar mënyrën se si institucionet e rivlerësimit duhet të përzgjedhin provat e kërkuara në proces apo të refuzojnë marrjen e tyre. Një arsyetim i rezultatit të analizës së kryer në këtë kontekst, shtjellohet në vijim.

30.4. Pasi shqyrtoi aktet e administruara në dosjen e Komisionit dhe analizoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë deklaruar asnjëherë ekzistencën e këtij regjimi të posaçëm pasuror martesor. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit janë të pabazuara në ligj dhe në prova. Mungesa e deklarimit sipas detyrimeve që parashikon neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016, sikurse respektivisht edhe ligji nr. 9049/2003, gjen vend si në deklaratën e pasurisë *vetting*, ashtu edhe në deklaratat e interesave privatë për periudhën 2004 – 2016. Për më tepër, në formularët e deklarimeve, të dy bashkëshortët kanë deklaruar të drejta pasurore në *bashkëpronësi*, sikurse edhe elemente që tregojnë për *ekonomi të përbashkët* dhe *regjim pasuror të bashkësisë ligjore*.

¹⁸ Sipas një shkrese të datës 18.02.2022, Njësia Administrative nr. {***} i ka përcjellë subjektit një certifikatë martesore, certifikatë familjare të A. B., datë 18.02.2022, kontratën e regjimit pasuror paramartesor me nr. {***} rep., datë 27.03.2007. Sipas shkresës, kjo kontratë ndodhet në regjistrin themeltar S. G. {***} që ditën kur është lidhur martesa, më datë 26.04. 2007. Pavarësisht nga referimi, në aktet e përcjella subjektit, znj. Elizabeta Imeraj, dhe nga kjo e fundit përcjellë Kolegjit, mungon kopja e regjistrit themeltar që do të dokumentonte sa referohet.

¹⁹ Drejtoria Vendore Tirana Veri (Agjencia Shtetërore e Kadastrës), më datë 22.02.2022, ka informuar znj. Imeraj se rezultoi e administruar kontrata e regjimit pasuror paramartesor me nr. {***} rep., datë 27.03.2007, në zyrat e këtij institucioni duke u pasqyruar në regjistrat përkatës edhe elektronikisht.

Konkretisht:

- në deklaratën e interesave privatë për vitin 2007, që përkon me vitin e lidhjes së martesës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në bashkëpronësi me pjesë takuese 50% pasurinë e paluajtshme shtëpi banimi private pa numër, “*në pronësi të bashkëshortit, kati i tretë*”. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit deklaroi: “*shlyerje totale kredie nga bashkëshorti për kredinë bankare, marrë në BKT në tetor 2006*”;
- në deklaratën e interesave privatë për vitin 2008 – subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerje pasurie të paluajtshme në rrugën “{***}” *për efekt dokumenti*, nga vëllai i bashkëshortit dhe që *pasuria vazhdon të jetë e tij*, për çmimin 3.900.000 lekë. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit deklaroi edhe blerje pasurie të paluajtshme në rrugën “{***}”, Tiranë, nga bashkëshorti për çmimin 45.000 euro, *regjistruar në emër të bashkëshortit, por në pronësi të përbashkët me vëllain, çmim i paguar bashkërisht, pjesa takuese 25%*;
- në deklaratën e interesave privatë për vitin 2012 – subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratë shkëmbimi, me anë të së cilës përfitohet pasuria truall 2500 m² në rrugën “{***}” Tiranë;
- në deklaratën vetting – subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si pasuri të paluajtshme, të luajtshme dhe të ardhura në “bashkëpronësi”, si vijojnë:
 - i. të ardhura të përfituara nga shitja e një banese në Tropojë, pronë e familjes së bashkëshortit që nga viti 1985;
 - ii. pasuri të paluajtshme në rrugën “{***}”, Tiranë, në emër të ish-bashkëshortit, blerë në vitin 2008, me burim krijimi kredi, në të cilën subjekti i rivlerësimit është dorëzues;
 - iii. legalizim shtesë banese në rrugën “{***}”, Tiranë, në emër të ish-bashkëshortit, me burim krijimi të ardhurat nga veprimtaria e bashkëshortit si noter dhe ekonomia familjare;
 - iv. të ardhura të përfituara nga vendimi gjyqësor i datës 12.01.2015, për shpërblim dëmi nga kompania CEZ për ish-bashkëshortin;
 - v. të ardhura të përfituara nga fondi i Emergjencave Civile sipas njoftimit të datës 22.12.2015, për ish-bashkëshortin;
 - vi. të ardhura nga qiratë e pasurisë me adresë rruga “{***}”, Tiranë²⁰;
 - vii. të ardhura nga dërgesat e realizuara nga vëllai i ish-bashkëshortit, në emër të këtij të fundit.
- gjatë hetimit administrativ të çelur për herë të dytë, në përgjigje të pyetjeve të Komisionit për sa i përket regjimit pasuror ndër vite, në datën 17.9.2020 – subjekti i rivlerësimit ka referuar regjimin pasuror të pasurive të ndara të vendosur *para lidhjes së martesës* me ish-bashkëshortin, dhe që këtë detaj e ka “vënë edhe më parë në dispozicion” të Komisionit. Bashkëlidhur përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit të kësaj date, gjendet kopja e kontratës e regjimit pasuror paramartesor në formën e regjimit të pasurive të ndara, me datë 27.03.2007, e cila përcakton se palët kanë rënë dakord të rregullojnë marrëdhëniet e tyre pasurore, duke zgjedhur si regjim

²⁰ Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar edhe të ardhura nga qiradhënia e pasurisë në rrugën “{***}”, kurse subjekti deklaroi të ardhura vetëm nga qiraja në rrugën “{***}”. Komisioneri Publik në paragrafin 19.1.5 të ankimit është shprehur se subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiradhënia e pasurive në rrugën “{***}” dhe “{***}”, Tiranë.

pasuror pas martese të pasurive të ndara sipas parashikimeve të neneve 115 – 122 të Kodit të Familjes;

- në përgjigje të rezultateve të hetimit të dytë – subjekti i rivlerësimit është shprehur se përmes kontratës për regjimin e pasurive të ndara, ka rënë dakord me ish-bashkëshortin që të gjitha pasuritë e krijuara prej tij para martese do të vijojnë të mbeten vetjake, ndër të cilat, edhe pasuria e ndodhur në rrugën “{***}”. Për këtë pasuri, shprehet subjekti, nuk ka marrë pjesë në shitblerje, nuk ka tërhequr asnjëherë të drejta pronësie dhe as të ardhura personale apo t’i ketë përdorur për ndonjë lloj interesi vetjak. Nëse përfshihen të ardhurat e qirasë së përfutur nga bashkëshorti, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, rezulton mundësi financiare me balancë pozitive, duke pasur mundësi për krijimin e shumës për legalizimin e kësaj pasurie të paluajtshme, në pronësi individuale të ish-bashkëshortit.

30.5. Nga ana tjetër, gjatë procesit gjyqësor në Kolegj²¹, pyetur nga vëzhguesi ndërkombëtar për të shpjeguar përse ky regjim pasurie nuk ishte deklaruar më parë, qoftë në harkun kohor që i parapriu pyetësorit të shtatorit 2020, në korrespondencën nëpërmjet postës elektronike me ish-vëzhguesin ndërkombëtar [Hans Klijstra], apo në momentin kur Komisioni i kaloi barrën e provës për kriterin e pasurisë në tetor 2019, gjatë hetimit të parë administrativ – sipas të cilit subjekti u njoftua se ishte në kushtet e dyfishit të pasurisë së ligjshme²² – në dallim nga sa ka pretenduar përpara Komisionit – subjekti pohoi se “nuk i kishte dhënë rëndësi” këtij fakti, “do ta kishte harruar nëse nuk do ta kishte pyetur Komisioni apo vëzhguesi” dhe që “nuk ka rubrikë të posaçme për këtë qëllim” në deklaratën e pasurisë apo në ato periodike vjetore.

30.6. Në përmbledhje të sa më sipër, nga njëra anë, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se, së pari, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar ekzistencën e regjimit të pasurive të ndara për herë të parë vetëm në shtator 2020, ndërkohë që procesi i hetimit administrativ për subjektin kishte filluar në datën 31.10.2018, dhe vetëm pasi është pyetur gjatë hetimit të dytë, për të sqaruar nëse zgjidhja e martesës kishte sjellë pasoja në pasuritë e saj. Nga analiza e akteve në dosjet e administruara nga Komisioni, rezulton që kontrata e regjimit pasuror paramartesor të pasurive të ndara [nr. {***}, datë 27.03.2007], të jetë depozituar për herë të parë vetëm në shtator 2020. Ky konstatim bazohet edhe në analizën e detajuar të raportit të kontrollit të ILDKPKI-së, për efekt të procesit të rivlerësimit, mbi pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, të dorëzuar në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 25.07.2018, ku nuk ka referencë të ekzistencës së kësaj kontrate. Në të kundërt, analiza ligjore dhe ekonomike e kryer nga ILDKPKI-ja, në kushtet e kontratës paramartesorë dhe pretendimeve të subjektit, do të ishte bazuar mbi pasuri individuale, dhe jo në bashkëpronësi. Përpos kësaj, vlen të theksohet se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar hetimit të plotë në vitin 2019 nga Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në përfundim të

²¹ Për referencë, shih procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 31.03.2022, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.

²² Neni 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 parashikon që: “Shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në këto raste: 1. Kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të [...]”. Për referencë, shih faqen 85 të rezultateve të hetimit administrativ të datës 16.10.2019, paragrafi nr. 26, “Analiza financiare”.

të cilit kanë dalë rezultatet në datën 16.10.2019. As edhe në atë moment procedural, nuk ka rezultuar referencë apo trajtim i çfarëdo forme të këtij elementi dhe as vetë subjekti nuk ka pretenduar ekzistencën e këtij dokumenti.

30.7. Nga ana tjetër, përpos që ka deklaruar ndër vite pasuritë në bashkëpronësi, referuar gjerësisht në detaje më sipër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar edhe të ardhura nga pasuritë në pronësi të ish-bashkëshortit apo ka ndërmarrë veprime të cilat përkojnë me ato të një pasurie në regjimin e bashkësisë ligjore. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar asnjë të dhënë mbi faktin e ekzistencës së kontratës për regjim pasuror të ndarë mes saj dhe bashkëshortit, çka do të kishte efekte dhe pasoja në pasuritë e deklaruara. Tashmë, Kolegji ka një jurisprudencë të konsoliduar²³ për vlerën provuese të deklaratave të interesave privatë ndër vite në procesin e rivlerësimit. Konkretisht, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga qiraja e pasurisë së ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë²⁴ dhe janë kryer veprime me këto pasuri, sikurse:

- (i) në cilësinë e bashkëpronares, ka nënshkruar kontratën noteriale të datës 07.11.2012, për shkëmbimin e pasurisë të ndodhur në {***}, Tiranë, me pasurinë me sip. 2.500 m² truall, ndodhur tek {***}, Tiranë²⁵;
- (ii) në emër të saj është lëshuar kartela e pasurisë së paluajtshme²⁶, për pasurinë e llojit truall me sip. 2.500 m², me adresë {***}, Tiranë;
- (iii) po kështu, ndonëse me më pak peshë, në datën 09.10.2006, subjekti ka përfituar një kredi në shumën prej 2.000.000 lekësh nga BKT-ja, në të cilën personi i lidhur ka dalë dorëzanës dhe hipotekues me pasuritë e tij dhe ka shlyer detyrimet e kredisë;
- (iv) në cilësinë e palës shitëse, subjekti dhe bashkëshorti kanë tjetërsuar me anën e një kontrate noteriale shitjeje [më datë 30.09.2015] shtëpinë në {***}, Tropojë, fituar nga bashkëshorti me vendim gjykate në vitin 2013. Veprimet juridike në lidhje me këtë pronë, përkojnë me sjellje të ish-bashkëshortëve që përputhet qartë me regjimin pasuror të bashkësisë ligjore dhe jo atë të regjimit të pasurive të ndara: për një banesë në të cilën familja B. ka jetuar vite përpara martesës së subjektit me ish-bashkëshortin, në momentin e tjetërsimit shitja nënshkruhet nga të dy bashkëshortët, bazuar në vendimin e gjykatës sipas të cilit pronar rezultonte ish-

²³ Shih vendimet (JR) nr. 6/2018, prg. 14; (JR) nr. 8/2018, prg. 43; (JR) nr. 12/2018, prg. 24.11; (JR) nr. 10/2018, prg. 67; (JR) nr. 5/2019, prg. 23 dhe (JR) nr. 19/2019, prg. 22.14.

²⁴ Në DVP-2009, subjekti ka deklaruar: “[...] të ardhura nga qiraja e ambientit në rr. “{***}”, Tiranë [...] – 600.000 lekë”; në DVP-2014, ka deklaruar: “[...] qira mujore, përfituar nga ambienti në rr. “{***}” (bëhet fjalë për ambientin në rr. “{***}”), Tiranë - 12.000 euro”; në DVP-2015, ka deklaruar: “[...] të ardhura nga qiraja e ambientit të ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë [...] – 4.800 euro”; në DVP-2016, ka deklaruar: “[...] të ardhura të përfituara nga qiraja e ambientit me adresë në rr. “{***}”, Tiranë [...] – 4.800 euro”; edhe në deklaratën “vetting”, subjekti ka deklaruar të njëjtat vlera të përfituara nga qiraja e këtij ambienti, sipas viteve si në deklaratat periodike vjetore.

²⁵ Më datë 19.09.2019, notere Xh. O. informon Komisionin se: “[...] Në hartimin e kësaj kontrate shkëmbimi ka pasur një lapsus juridik nga ana ime, pasi kam kërkuar të jenë palë në kontratë edhe bashkëshortët e titullarëve të pasurive të paluajtshme që do të shkëmbeheshin [...]”.

²⁶ Shih shkresën nr. {***} prot., datë 21.07.2017, të ZVRPP Tiranë, e administruar në dosjen e ILDKPKI-së (faqe 980 – versioni elektronik i dosjes së ILDKPKI-së).

bashkëshorti i subjektit²⁷. Këto rrethana faktike rezultojnë nga vendimi i Gjykatës Tropojë për parashkrimin fitues, por edhe nga pohimi i subjektit në Kolegj, që konkretisht, nga viti 1985 rezulton i dokumentuar banimi prej familjes së origjinës së ish-bashkëshortit, minimalisht që nga viti 1995. Me fjalë të tjera, një banesë mbi të cilën teorikisht kishin pasur të drejta nëna dhe vëllezërit e z. B., për shkak se sipas vendimit të Gjykatës dhe atij të Bashkisë Tropojë për ndihmë ushqimore, individualizohet si pronar dhe përdorues *vetëm* ai, dhe shitet gjatë kohës kur ky i fundit ka qenë i martuar, në cilësinë e shitëses së bashku me të, figuron bashkëshortja, por jo familjarët që kanë banuar aty. Ky veprim bindshëm përkon vetëm me regjimin e bashkësisë ligjore. Në të kundërt, në vend të certifikatës familjare të z. B. në cilësinë e pronarit, në dosjen e përcjellë nga ZVRPP Tropojë do të duhet të ishte kontrata noteriale e “regjimit të pasurive të ndara” e datës 27.03.2007, e hartuar përpara noterës Xh. B..

30.8. Sipas dispozitave të Kodit të Familjes që rregullojnë regjimin e pasurive të ndara, kontrata e nënshkruar për këtë qëllim, duhet të dorëzohet në zyrën e gjendjes civile. Fakti që ky detyrim i njihet noterit²⁸, nuk përjashton vëmendjen e palëve kontraktore për regjistrimin e kësaj kontrate në organet dhe regjistrat publikë, për qartësimin dhe njoftimin me këtë regjim edhe të tretëve. Vëmendja e nevojshme nga palët paraqet rëndësi në kushtet kur mungesa e pasqyrimin të këtij veprimi juridik në aktin e martesës, nënkupton prezumimin e regjimit pasuror martesor të *bashkësisë ligjore*²⁹. Në këtë përfundim, trupi gjykues i Kolegjit pati parasysht edhe aktet zyrtare³⁰ të mbërritura në Komision gjatë hetimit administrativ nga autoritetet e qeverisjes vendore, të cilat nuk përcollën kopje të faqes së regjistrimit themeltar të vendbanimit³¹ të subjektit dhe as kopje të aktit të martesës, për të lejuar trupin gjykues të konstatonte dhe konfirmonte sa pretendohet drejtpërdrejt nga këqyrja e akteve publike. Nën këtë dritë dhe në përmbledhje, Kolegji vëren se efekti që ka pasur ky regjim i pasurive ndaj të tretëve, përfshirë institucionet e ndryshme publike, apo detyrimet në procesin e rivlerësimit, nuk ka pasqyrim të pasojat ligjore që shoqërojnë regjimin e pasurive të ndara.

30.9. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit, përpos detyrimeve nga ligji nr. 9049/2003 për deklarimin e interesave çdo vit, duke filluar nga emërimi në funksionin zyrtar, ka pasur detyrë kushtetuese të deklaronte rishtazi dhe në mënyrë të detajuar pasurinë në përputhje me ligjin. Për

²⁷ Sipas dokumentacionit zyrtar të përcjellë Komisionit nga ZVRPP Tropojë, datë 01.04.2019 [nr. prot. 1252/1], pjesë e të cilit është kontrata noteriale e shitjes mes A., B. dhe Elizabeta Imerajt për shitjen e shtëpisë 140 m² me nr. rep. {***} dhe kol. {***} pranë noterës Elida Lamnica dhe vendimi i Gjykatës Tropojë me nr. {***}/2013, certifikatë familjare e shitësve e lëshuar për qëllim të këtij transaksioni, e datës 29.09.2015, një ditë përpara shitjes.

²⁸ Neni 69, paragrafi III i Kodit të Familjes.

²⁹ Neni 69, paragrafi IV i Kodit të Familjes, sipas të cilit, në mungesë të një kontrate të referuar në aktin e martesës, bashkëshortët do të konsiderohen kundrejt të tretëve si të martuar nën regjimin pasuror martesor të bashkësisë ligjore. Bashkësia ligjore, sipas nenit 74 të Kodit të Familjes, përbëhet nga, ndër të tjera: “[a] pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët, së bashku ose veç e veç, gjatë martesës [...]”.

³⁰ Në përgjigjen e datës 25.09.2020, Njësia Administrative nr. {***}, Bashkia Tiranë, dërguar Komisionit, ndër të tjera, lidhur me statusin civil të Elizabeta Imerajt dhe A. B., referon lidhjen dhe zgjidhjen e martesës mes subjektit dhe ish-bashkëshortit, si dhe që: “[...] Në faqen e regjistrimit {***}, është e kapur dhe kontrata e regjimit pasuror [...]”, por mungon kopje e faqes së regjistrimit përkatës dhe akti i martesës.

³¹ Regjistri themeltar i Zyrës së Gjendjes Civile, rr. “{***}”, Nj. {***}. nr. {***}.

më tepër, në vështrim të ndryshimeve kushtetuese, pritej vëmendje e shtuar që në deklaratën e pasurisë *vetting* të pasqyroheshin saktë dhe plotësisht fakte me pasoja thelbësore ligjore në kriterin e kontrollit të pasurisë. Neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016 parashikojnë penaltete në drejtim të prezumimit të masës disiplinore të shkarkimit nëse vërtetohet deklarim i pasaktë e i pamjaftueshëm³². Në këto kushte, pretendimi i subjektit për pasuri të ndara, u gjet pa rëndësi në procesin e rivlerësimit të subjektit. Në këtë konkluzion, Kolegji pati në konsideratë: (i) deklaratimet katërçipërisht kontradiktore të subjektit të rivlerësimit në procesin e hetimit administrativ në Komision, përkundër atyre në procesin gjyqësor publik në Kolegj që variuan nga pretendimi se ka referuar regjimin pasuror *rregullisht*, në përpjekje për t’ia atribuar mungesën e deklarimit *harresës*; (ii) mungesën e pasqyrimin të këtij fakti ligjor në regjistrat publikë dhe në raport me institucionet zyrtare; (iii) dhe deklarimin e pasurisë në bashkëpronësi dhe sjelljen si bashkëpronare. Së fundmi, trupi gjykues sjell në vëmendje që objekt kontrolli dhe vlerësimi në procesin e rivlerësimit, në zbatim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, janë pasuritë e subjekteve të rivlerësimit, si dhe ato të personave të lidhur³³, pavarësisht nga fakti nëse pasuritë e tyre janë ose jo në bashkëpronësi. Për sa më sipër, argumentet e Komisionerit Publik për këtë shkak ankimi, u gjetën të bazuara dhe Kolegji analizoi pasuritë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, siç shtjellohet në vijim të këtij arsytimi.

30.10. Për të njëjtat arsye dhe bazuar mbi të njëjtat përcaktime kushtetuese dhe ligjore, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi pa peshë dhe të panevojshme të mbante në konsideratë në procesin e kontrollit të kriterit të pasurisë, kallëzimin penal që subjekti i rivlerësimit ka ushtruar më datë 25.02.2022, për të kontestuar bashkëpronësinë e referuar në disa nga aktet e përcjella ILDKPKI-së dhe Komisionit nga AShK-ja gjatë procesit të rivlerësimit, referuar më sipër. Paraprakisht, Kolegji sjell në vëmendje që në nivelin parimor, ky rregullim ligjor i kushton rëndësi të veçantë analizës për nevojën e marrjes së provave, rëndësisë së faktit që kërkohet të provohet për procesin – apo mungesës së rëndësisë së faktit – përshtatshmërisë së mjetit të provës, sikurse edhe testeve të tjera, të cilat duhet të merren në analizë nga Kolegji në pranimin e akteve. Në zbatim të kësaj dispozite, marrja e akteve të sipërcituara dhe rezultati i këtij procedimi duket se janë të panevojshëm në funksion të zgjidhjes së çështjes, në kushtet kur nuk sjellin asnjë risi dhe përpiqen të vërtetojnë të kundërtën e fakteve të provuara nëpërmjet akteve në dosjen e përcjellë nga Komisioni në Kolegj ose pretendimeve të subjektit të bëra pjesë e analizës, nëpërmjet parashtrimeve të tij gjatë procesit të gjyqimit në Kolegj³⁴.

30.11. Përpos dhe në vijim të sa është shtjelluar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje që ushtrimi i kallëzimit penal në këtë fazë të procesit, e konkretisht, pasi subjekti u

³² Neni D, pikat 1, 2, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 30 dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

³³ Neni 30 i ligjit nr. 84/2016: “Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij”.

³⁴ Neni 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

njoftua për datën e seancës publike në Kolegj³⁵, dëshmon që veprimet janë ndërmarrë vetëm në funksion të procesit gjyqësor në Kolegj. Duke risjellë në vëmendje sa është argumentuar më sipër – shpjegimet kontradiktore të dhëna nga subjekti për arsyet për të cilat ajo dhe personi i lidhur, të dy juristë me përvojë, nuk kanë deklaruar regjimin e pasurive të ndara për 13 vjet [nga viti 2007 deri në shtator 2020] – edhe këto veprime të ndërmarra në një fazë të avancuar të procesit, për të kontestuar fakte të cilat subjekti duhej t’i kishte njohur më së hershmi kur është njohur me fashikujt e Komisionit³⁶, dëshmojnë për një qasje që ka për qëllim pasqyrimin e fakteve në një dritë që favorizon subjektin në procesin e rivlerësimit. Nëse qëllimi ishte pasqyrimi i së vërtetës juridike, kallëzimi penal ose veprime me të njëjtin objektiv, logjikisht do të ishin ndërmarrë në momentin e marrjes djepi, e konkretisht më së paku gjatë hetimit administrativ – i cili zgjati dy vjet – ose gjatë procedurës së zgjidhjes së martesës, apo edhe në pikën fundore – pas njohjes së këtij shkakut ankimi të ushtruar nga Komisioneri Publik më 05.07.2021. Në paragrafin 21.8.2. të ankimit³⁷, Komisioneri referon në mënyrë të drejtpërdrejtë kartelën e pasurisë së paluajtshme, ku subjekti pasqyrohet si bashkëpronar, numrin e referencës së pasurisë dhe detajet e tjera identifikuese, sikurse edhe aktin shkresor tek i cili referohet bashkëpronësia. Për sa më sipër, kjo kërkesë e subjektit të rivlerësimit u gjet e pabazuar dhe pa ndikim në procesin e rivlerësimit.

A.2. Lidhur me pasuritë e deklaruar

1. Pasuria e paluajtshme truall³⁸ me sipërfaqe 2.500 m², e ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë (në vijim “pasuria truall 2500 m²”)

31. Lidhur me këtë pasuri, sikurse edhe me pasurinë “tokë arë” në {***}, Tiranë, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germa “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

31.1. Në rezultatet e hetimit, respektivisht të datave 16.10.2019 dhe 27.01.2021, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës lidhur me:

- o mungesën e dokumentacionit justifikues provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave të deklaruar për blerjen e pasurisë me sipërfaqe 400 m² në vitin 2007;
- o mungesën e deklaramit në deklaramtën e interesave privatë për vitin 2007 dhe në deklaramtat vijuese, të pasurive tokë arë në {***};

³⁵ Urdhri për fillimin e shqyrtimit u shpall më 10.02.2022 dhe iu njoftua subjektit dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë: <https://kpa.al/wp-content/uploads/2022/02/Shpallje-seance-publike-SR-Elizabeta-Imeraj.pdf>.

³⁶ Nga aktet në fashikull, rezulton se subjekti është njohur me dokumentacionin e përcjellë në Komision, pjesë e fashikujve të krijuar, minimalisht në datën 29.01.2021 dhe 03.02.2021. Sipas akteve, rezulton që subjekti të jetë njohur me dokumentacionin fizik dhe në formë elektronike (CD) të dosjeve të hetimit administrative të zhvilluar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe të ketë marrë gjithë dokumentacionin e kërkuar prej tij.

³⁷ Faqja 13 e ankimit të Komisionerit Publik. Për referencë: <http://ikp.al/wp-content/uploads/2021/07/Ankim-kund%C3%ABr-vendimit-nr.-363-dat%C3%AB-1.4.2021-t%C3%AB-KPK-s%C3%AB-p%C3%ABr-subjektin-e-rivler%C3%ABsimit-znj.-Elizabeta-Imeraj.pdf>.

³⁸ Me nr. {***}, {***}.

- mungesën e justifikimit me dokumentacion provues të diferencës së çmimit të pasurive të paluajtshme të shkëmbyera;
- mungesën e ndonjë dokumenti për të provuar faturimin dhe deklarimin e shërbimeve ligjore (si avokat) në shumën prej 80.000 eurosh dhe pagesën e detyrimeve përkatëse pranë autoriteteve tatimore; si dhe
- mungesën e deklarimit në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat e interesave privatë të huadhënies prej 80.000 eurosh, në formën e detyrimit të dhënë si shërbim z. P. K. nga A. B..

31.2. Në përfundim, Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, nuk ka kryer veprime për këto pasuri dhe as është përfutuese e tyre. Sipas Komisionit, sipërfaqet e tokës të ndodhur në {***}, janë blerë dhe pagesat janë likuiduar para martesës nga ish-bashkëshorti. Ky konstatim i Komisionit vlen edhe për sipërfaqen prej 400 m² tokë (blerë për çmimin 1.000.000 lekë), pavarësisht se kontrata e shitjes mban datën 26.06.2007 – rreth dy muaj pas lidhjes së martesës. Në përmbledhje, Komisioni, duke analizuar vlerën provuese, nga njëra anë, të një kontrate noteriale të rregullt lidhur mes palëve dhe një *deklarate* për premtim shitjeje, i ka dhënë vlerë provuese kësaj të fundit, duke pranuar kërkimin e subjektit që pasuria të konsiderohej e likuiduar përpara martesës, në funksion të përmirësimit të situatës së saj. Po ashtu, Komisioni ka krijuar bindjen që *pasaktësitë* në deklarimin e këtyre pasurive në *bashkëpronësi* nga subjekti i rivlerësimit, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 apo në deklaratën e pasurisë nga subjekti dhe ish-bashkëshorti, i atribuohen vetëm ish-bashkëshortit “si pronar i vetëm i këtyre pasurive të krijuara para martesë dhe të përfshira në kontratën për regjimin pasuror të pasurive të ndara”. Në përfundim, Komisioni nuk konstatoi problematika për këtë pasuri dhe subjekti ka bërë deklaram të saktë në përputhje me pikën 5/a të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

31.3. Në analizë të pretendimeve të Komisionerit, konkluzioneve të Komisionit, akteve të administruara dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, siç shtjellohet gjerësisht më poshtë, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin që vlerësimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri, është i pabazuar në ligj. Komisioni nuk rezulton të ketë arsyetuar se përse aktet zyrtare, sikurse kartela e pasurisë në emër të subjektit³⁹, deklarimi periodik vjetor nën përgjegjësi dhe i nënshkruar nga subjekti në vitin 2007 dhe deklarata *vetting* në vitin 2017, nënshkruar nga subjekti dhe ish-bashkëshorti nuk kishin vlerë provuese, përkundër një deklarate të thjeshtë për premtim shitjeje apo pretendimeve të parashtruara nga subjekti vetëm në hetimin e riçelur në janar të vitit 2020. Ky konkluzion bazohet në analizën e akteve të administruara në dosje, përfshirë veprimet juridike të kryera dhe dispozitave ligjore që gjejnë zbatim në rrethanat konkrete, përkatësisht neni D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 30 dhe 33, pika 5, germa “b”, neni 49, pika 4, 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe neni 690 i Kodit Civil.

31.4. Konkretisht, pasuria truell me sipërfaqe 2.500 m² është përfutuar nëpërmjet shkëmbimit të tri parcelave të tokës arë në {***} [me një individ, z. P. K.], të cilat fillimisht janë përfutuar nëpërmjet

³⁹ Gjatë procesit të rivlerësimit të Komisionit, nga ana e subjektit nuk rezulton të ketë pasur kontestim për falsifikim të kësaj kartele.

veprimeve juridike të shitblerjes. Më tej, në saje të një kontrate sipërmarrjeje me një person juridik për ndërtimin e një godine shërbimesh dhe banimi prej 13 katesh, ish-bashkëshorti i subjektit ka krijuar kushtet për të përfituruar 37% të vlerës së sipërfaqes së ndërtimit. Veprimet e ndërmarra dhe që kanë rëndësi për fitimin e kësaj pasurie, renditen më poshtë në mënyrë kronologjike.

- a. Ish-bashkëshorti i subjektit ka blerë tri parcela toke në {***} me tri kontrata shitjeje noteriale, respektivisht: (a) parcela me sipërfaqe 532 m², me kontratën e shitblerjes së datës 02.10.2006, me çmim 1.750.000 lekë; (b) parcela me sipërfaqe 532 m², me kontratën e datës 21.02.2007, me çmim 1.700.000 lekë; (c) parcela me sipërfaqe 400 m², me kontratën e datës 26.06.2007, me çmim 1.000.000 lekë.
- b. Më datë 02.10.2006, shitësit e parcelës së parë prej 532 m² [D. dhe S. K.], me deklaratë të thjeshtë për premtim shitjeje, deklarojnë dakordësinë për t'i shitur ish- bashkëshortit të subjektit dhe vëllait të tij A. B. parcelën e tretë të sipërcituar dhe që çmimi është tërësisht i likuiduar. Me fjalë të tjera, në të njëjtën ditë në të cilën formalizohet përpara noterit shitja e një parcele, nëpërmjet një kontrate të rregullt, shitësit e dakordësuar deklarojnë një fakt kyç, atë të pagesës së kryer edhe për një parcelë të dytë, në një forum dhe format të dytë, të ndryshëm – përpara një avokati – dhe duke zgjedhur një akt të cilit i mungon ana formale, tetë muaj përpara formalizimit të shitjes. Është e paqartë përse ish-bashkëshorti i subjektit, në cilësinë e palës së interesuar për formalizimin e plotë të transaksionit, në kushtet kur pretendohet që ka kryer gjithë pagesën, nuk kreu të dyja shitjet me akt noterial⁴⁰. Po ashtu, ekzistenca e këtij *premtimi* apo shlyerja e vlerës, tetë (8) muaj më herët, nuk referohet në kontratën e shitjes së kryer përpara noterit më 26.06.2007.
- c. Më datë 21.06.2007, me kontratën noteriale të porosisë, përfaqësimit dhe ndërmjetësimit (referuar “kontrata e porosisë”), ish-bashkëshorti i subjektit ka rënë dakord që të kryejë shërbime ligjore për porositësin, z. P. K., kundrejt një shpërblimi të rregullt mujor [parashikuar në nenin 4⁴¹ të kësaj kontrate].
- d. Më datë 03.07.2012, në një deklaratë për vërtetim nënshkrimi, P. K.: (i) njeh detyrimin prej 80 mijë eurosh kundrejt ish-bashkëshortit të subjektit për shërbime ligjore/avokatie; (ii) referon se shlyerja e këtij detyrimi mund të kryhet edhe në natyrë nëpërmjet shkëmbimit apo dhurimit; (iii) deklaron që do të “*përpijojë kontratë huaje*” për të njohur detyrimin në formë huaje; dhe (iv) deklaron se në rast dështimi në pagesën e shërbimit për avokatin, *do të shkëmbejë 2.500 m² tokë pasuri e paluajtshme, e ndodhur tek {***} me pasuritë e paluajtshme në pronësi të z. A. B., të ndodhura në {***} [...].* Pavarësisht nga kjo dakordësi, në kontratën e huamarrjes së lidhur më datë 01.08.2012, nga dy palët [huadhënës, z. A. B. dhe huamarrës, z. P. K. dhe znj.

⁴⁰ Deklarata premtim shitjeje është hartuar nga avokat B. B., i cili e ka firmosur atë krahas deklaruësve.

⁴¹ Në nenin 4, parashikohet: “Shpërblimi për punën dhe shërbimin që do të kryhet nga pala e porositur [...] do të vlerësohet në shumën 1.300 euro në muaj. Kjo shumë do të rivlerësohet rast pas rasti, në varësi të punës së kryer dhe shërbimit të ofruar. Pagesa do të kryhet me bankë në llogarinë bankare të palës së porositur. Në rast se porositësi nuk kryen pagesën si më sipër, mënyra e pagesës dhe koha e kryerjes së saj do të përcaktohen rast pas rasti në monedhën dhe/ose në natyrë me pasuritë e tij të luajtshme ose të paluajtshme, sipas një marrëveshjeje me mirëkuptim të ndërsjellë midis palëve, me shkrim”.

- Xh. K.], për shumën prej 80.000 eurosh, garancia pasurore për kthimin u vendos të ishte një apartament banimi me sipërfaqe 147 m² në {***}, Tiranë.
- e. Më datë 07.11.2012, ish-bashkëshorti i subjektit ka konfirmuar përpara noterit kthimin e shumës prej 80.000 eurosh nga z. P. K..
 - f. Një muaj më pas, më datë 07.12.2012, palët kanë shkëmbyer pasuri të paluajtshme pa kundërshtim. Si pasojë e kësaj kontrate, z. A. B. dhe znj. Elizabeta Imeraj, si bashkëpronarë të pasurive me sipërfaqe 532 m², me sipërfaqe 532 m² dhe me sipërfaqe 400 m², të ndodhura në {***}, Tiranë, bëhen pronarë të truallit prej 2.500 m² të ndodhur tek {***}. Nga ana tjetër, z. P. K. dhe znj. Xh. K., bashkëpronarë të truallit me sipërfaqe 2500 m², bëhen pronarë të tri parcelave në {***}.
 - g. Me dy kontrata sipërmarrjeje, respektivisht të datave 25.12.2012 (disa javë pas shkëmbimit) dhe 23.04.2014, ish-bashkëshorti i subjektit ka nënshkruar dy kontrata sipërmarrjeje për ndërtim godine banimi dhe shërbimi, në cilësinë e pronarit të pasurisë së paluajtshme me sipërfaqe 2.360 m², me një shoqëri ndërtimi [{"***"} ShPK]. Nuk rezulton në akte, shpjegimi i arsyeve përse është revokuar kontrata e parë e sipërmarrjes. Nga aktet e depozituara, rezulton që leja zhvillimore nga Bashkia Tiranë është lëshuar në tetor dhe dhjetor 2014, gjë që nënkupton që kontrata e parë e sipërmarrjes është nënshkruar ndërsa ndërtimi nuk ishte formalizuar dhe lejuar nga organet e qeverisjes vendore. Në të dyja kontratat, porositësi do të përfitojë 37% të sipërfaqes së ndërtimit të godinës së banimit dhe shërbimeve me 12 kate dhe me një kat nëntokë.

31.5. Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë në pjesë takuese “bashkëpronësi”, me sipërfaqen përkatëse, *shkëmbimin me pasurinë në {***}-Tiranë* dhe, për sa i përket vlerës, ka referuar “*pasuri e këmbyer*”. Nuk ka deklarim nga personi i lidhur, ish-bashkëshorti. Kontrata noteriale e sipërmarrjes nuk është deklaruar. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar asgjë lidhur me këtë pasuri. Ndërkohë që personi i lidhur ka deklaruar llojin, sipërfaqen, ndarjen në tri pjesë, kontratën e shkëmbimit si burim krijimi dhe tokën në {***}, *blerë në vitin 2006 nga të ardhurat e A. dhe A. B.. Pjesa takuese: Bashkëpronësi [...]. Po ashtu, personi i lidhur ka deklaruar të drejta reale të krijuara si rezultat i marrëdhënies kontraktuale me “{***}”, sipas kontratës së sipërmarrjes së datës 23.04.2014, me nr. {***}, pjesën takuese prej 37% të ndërtimit të përgjithshëm dhe detaje të lejes zhvillimore të Bashkisë Tiranë⁴². Pasuria deklarohet në bashkëpronësi.*

31.6. Në përgjigjet e rezultateve të dy hetimeve administrative, për sa i përket mungesës së burimeve financiare të rezultuar nga analiza e kryer nga Komisioni, subjekti ka pretenduar se këto pasuri janë blerë para martese dhe që personi i lidhur ka pasur mundësi për të mbuluar me burime të ligjshme pasuritë e blera deri në muajin prill 2007. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar edhe analizat financiare të kryera nga Komisioni për investimet e personit të lidhur deri në momentin e martesës, duke kërkuar përfshirjen: (i) në mesin e burimeve të ligjshme të të ardhurave nga qiraja

⁴² Nr. prot. {***}, datë 13.10.2014, akorduar “{***}” me vendimin e Bashkisë Tiranë me nr. {***}, datë 30.07.2014.

për periudhën 2005-prill 2007, në shumën 1.360.000 lekë; (ii) në zërin “të ardhura”, edhe të shumave të dërguara nga z. A. B. në vitin 2006, në shumën 5.313.509 lekë.

31.7. Huaja prej 80.000 eurosh dhe pagesa nga z. P. K., sipas subjektit të rivlerësimit, ka përbërë shpërblim për shërbime ligjore të kryera për rreth 6 vite, të vlerësuara nga palët në këtë vlerë. Për rrjedhojë, palët ranë dakord të kompensojnë shërbimet ligjore përmes shkëmbimit të pasurive që ish-bashkëshorti dispononte me vëllanë, në {***}, Tiranë, me sipërfaqen që z. K. kishte në pronësi, pranë {***}, Tiranë. Subjekti po ashtu pranoi që nuk ka dokumentacion për të provuar faturimin e shërbimit të avokatisë apo të deklaramit në organet tatimore të shumës 80.000 euro, sepse ky shërbim nuk është faturuar dhe as është deklaruar. Sipas subjektit, meqenëse palët janë likuiduar me shkëmbimin e pasurive, përjashtohen nga deklarimi në organet tatimore.

31.8. Në parashtrimet e saj në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, e shpjegoi deklaramin në vitin 2012 në bashkëpronësi si pasojë e perceptimit të saj të gabuar, apo me qëllim që “të prezantojë ekzistencën e një pasurie të krijuar nga shkëmbimi i një pasurie [...] në pronësi të ish-bashkëshortit dhe familjarëve të tij”, por që gjithsesi pronësia reale nuk është e saj. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, paraqiti një sërë aktesh që sipas saj provojnë se ajo nuk ka pasur asnjë të drejtë pronësie mbi parcelat e tokës⁴³ dhe që përfshirja e saj në cilësinë e bashkëpronares në kontratën e shkëmbimit [shih më sipër, paragrafin 31.4/f] ka qenë gabim i noteres publike⁴⁴. Sa i përket ligjshmërisë së krijimit të vlerës monetare prej 80 mijë eurosh, subjekti kërkoi të pranohet në cilësinë e provës një deklaratë noteriale nga z. P. K.⁴⁵ dhe një shkresë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT). Në deklaratën noteriale, z. K. konfirmon sa ka pretenduar subjekti në hetimin administrativ. Shkresa e DPT-së konfirmon që për të ardhurat personale dhe këmbimin e pasurive, regjistrimi i pronës kushtëzohet nga pagesa e detyrimit tatimor⁴⁶. Në këtë kontekst, subjekti i rivlerësimit, znj.

⁴³ Dy kërkesa dhe kthim përgjigje datë 22.02.2022 [nr. {***} dhe nr. prot. {***}] nga ASHK dhe dy kërkesa dhe kthim përgjigje më datë 28.02.2022 nga ASHK [nr. prot. {***} dhe prot {***}]. Nga përmbajtja e përmbledhur e këtyre akteve, ASHK-ja referon që: (i) ka mospërputhje mes kartelës së pasurisë; (ii) ASHK-ja ka të administruar kontratën e regjimit pasuror të pasurive të ndara dhe që subjekti nuk rezulton të ketë fituar tagër pronësie mbi njërin nga parcelat e tokës. ASHK-ja po ashtu përshkruan mënyrën sesi identifikohen pronat në kartela dhe që kartela e pronësisë lëshuar nga ky institucion Komisionit: “nuk është lëshuar nga ana jonë, pasi nuk pasqyron gjendjen e pronës më datë 20.08.2013”. Së fundmi, ASHK-ja referon se janë likuiduar të gjitha detyrimet e lindura si pasojë e kontratës së shkëmbimit nr. {***}, datë 07.11.2012.

⁴⁴ Në përgjigjen e datës 01.03.2022, notere Xh. O. shprehet se përfshirja e znj. Imeraj në kontratën e shkëmbimit të pasurive mes z. P. K. dhe z. A. B., si dhe citimi në objektin e kontratës se “shtetasit A. B. dhe Elizabeta Imeraj kanë në bashkëpronësi”, është “vlerësuar si një lapsus juridik nga ana e saj” [kontrata me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.11.2012].

⁴⁵ Nëpërmjet kësaj deklaratë noteriale, z. P. K. konfirmon marrëveshjen e datës 03.07.2012, referuar më sipër në paragrafin 31.4/d me ish-bashkëshortin e subjektit, z. A. B., shërbimet juridike të referuara në deklaratën e datës 21.06.2007 [paragrafi 31.4./c, detyrimin e tij ndaj z. B., konfirmuar me deklaratën e cituar në pikën 31.4/d dhe pohimet e subjektit, referuar në paragrafin 31.5, dhe përmbajtjen e kontratës noteriale të shkëmbimit të parcelave të tokës në {***} me ato në {***}, cituar ndër të tjera në paragrafin 31.4/f.

⁴⁶ Në përgjigje të kërkesës së subjektit të rivlerësimit për interpretim, me shkresën nr. {***}, datë 25.02.2022, DPT-ja sqaron se, për sa i përket tatimit mbi të ardhurat personale, në rastin e shkëmbimit të pasurive të paluajtshme, regjistrimi i pasurive të paluajtshme nga zyrat e regjistrimit kushtëzohet nga dokumentimi i pagesës së detyrimeve tatimore dhe që zyra e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, në rolin e agjentit tatimor, referuar në dipozitat e ligjit

Elizabeta Imeraj, paraqiti edhe një kopje të kallëzimit penal të ushtruar prej saj në datën 25.02.2022 dhe një deklaram të saj, të dokumentuar në procesverbalin e kallëzimit penal⁴⁷.

31.9. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi aktet zyrtare të sipërcituara, pretendimet e Komisionerit dhe ato të subjektit të rivlerësimit, vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, lidhur me rrethanat mbi të cilat janë krijuar pasuritë e paluajtshme qoftë në regjimin e pasurive të ndara, ashtu edhe në bashkëpronësinë *faktike* të personit të lidhur, z. A. B. me vëllezërit e tij, nuk është bindës. Siç është shtjelluar më sipër, lidhur me burimin e krijimit të truallit 2.500 m² në dy deklaratat – *vetting* dhe për vitin 2012 – subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shkëmbimin e pasurive të ndodhura në {***}, Tiranë. Ndërkohë që gjatë hetimit administrativ ka pretenduar se si kompensim për shkëmbimin e pasurive të paluajtshme, ka shërbyer edhe shuma prej 80.000 eurosh, nga shërbimet e avokatisë të ofruara nga personi i lidhur⁴⁸. Rezulton se si pasojë e shkëmbimit, subjekti dhe personi i lidhur kanë përfituar tokë truall, në këmbim të tokës arë, me sipërfaqe më të madhe, me vendndodhje afër qendrës, me potencial të ndryshëm zhvillimi ekonomik dhe social dhe me vlerë *210 herë* më të lartë krahasuar me tokën arë në {***}⁴⁹.

31.10. Po kështu, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ish-bashkëshorti ka përfituar vlerën prej 80 mijë eurosh si shpërblim në natyrë, sipas kontratës së porosisë të lartpërmendur, bie ndesh me përcaktimet kontraktore për mënyrën e pagesës së shërbimit ligjor – çdo muaj, në vlerën 1300 euro në llogarinë bankare – sikurse edhe me mënyrën alternative të pagesës – në natyrë. Në fakt, nga subjekti pretendohet që porositësi i ka shlyer detyrimet alternative *njëkohësisht* dhe në të dyja format. Është po ashtu e paqartë se si palët ishin në dijeni paraprakisht që porositësit i mungonin mjetet monetare për të paguar rregullisht dhe gjithsesi nënshkruan kontratën në këtë formë. Përpos sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje që ky pretendim është kryer për herë të parë në përgjigjet e pyetësorëve gjatë hetimit të parë administrativ. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar dhe, për pasojë, nuk ka lënë gjurmë të këtyre transaksioneve që përbënin interesa private të ish-bashkëshortit në deklaratën e interesave private të vitit 2007 apo në atë të vitit 2012 për deklarimin e përfitimeve të parashikuara nga kontrata e porosisë, si detyrim që buron nga neni 4, germa “e” e ligjit nr. 9049/2003⁵⁰, në kushtet e pritshmërisë për të ardhura nga këto angazhime në

nr. 9920, datë 28.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, është e detyruar të llogarisë, verifikojë dhe paguajë tatimin në buxhetin e shtetit.

⁴⁷ Arsyetuar gjerësisht edhe në paragrafët 30.10 dhe 30.11. Kallëzimi penal, ushtruar nga subjekti i rivlerësimit, lidhet me të dhënat e pasqyruara në kartelën e pasurisë së paluajtshme, sipas së cilave znj. Imeraj rezulton bashkëpronare për pasurinë me sipërfaqe 2500 m², të ndodhur tek {***} Tiranë. Sipas kallëzueses, referuar procesverbalit të kallëzimit penal, nga përgjigjet e sipërcituara të ASHK-së, “krijohen dyshime të forta për ekzistencën e një akti të falsifikuar”, i cili nuk është lëshuar nga institucioni përkatës.

⁴⁸ Shih përgjigjet e datës 30.5.2019, rubrika F, pika 4.

⁴⁹ Subjekti ka dhënë tokë arë, me sipërfaqe 1464 m², në një zonë larg qendrës dhe që, referuar vlerave të trojeve sipas përcaktimit në VKM-në nr. 139, datë 13.2.2008, përlllogaritet në 341.122 lekë. Ndërkohë, subjekti ka përfituar truall me sipërfaqe 2500 m² në {***}, afër qendrës, që sipas VKM-së nr. 139, datë 13.2.2008, përlllogaritet në 71.647.500 lekë.

⁵⁰ Neni 4 parashikon që: “Subjektet [...] detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive [...] brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: e) të ardhurat personale për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale; [...] g) angazhime në

vitin 2007, apo në momentin e materializimit të përfitimeve, të pretenduara në vitin 2012. Së fundmi, subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë të ardhur prej 80.000 eurosh as në deklaratën e pasurisë *vetting*, sipas detyrimeve kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit.

31.11. Sipas dispozitave ligjore në fuqi⁵¹, mbi bazën e të cilave është lidhur kontrata e porosisë mes z. K. dhe ish-bashkëshortit të subjektit, ky i fundit ushtronte profesionin mbi bazën e lejes për ushtrimin e profesionit në emër të tij dhe të regjistrimit në organet tatimore. Konkretisht, rezulton se ish-bashkëshorti i subjektit, z. A. B., është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit si person fizik (avokat) në datën 06.09.2007 dhe është pajisur me NIPT. Për rrjedhojë, duke filluar nga data e regjistrimit, çdo shërbim i ish-bashkëshortit për klientët, përfshirë shërbimet e kryera sipas kontratës së porosisë, do të duhej të shoqërohen me faturë tatimore. Për këtë arsye, pretendimi i subjektit se mungon detyrimi për të deklaruar vlerën prej 80 mijë eurosh meqenëse është këmbim në natyrë, nuk qëndron, në kushtet kur mungojnë gjurmë të faturimit të shërbimeve të kryera, për llogari të të cilave palët kanë konstatuar detyrimin në këtë vlerë. Me fjalë të tjera, shlyerja e detyrimit të pretenduar prej 80 mijë eurosh, nëpërmjet këmbimit në natyrë, është një veprim që pason ofrimin e shërbimit të ndodhur në një moment kohor të mëparshëm, por mënyra e shlyerjes nuk shuan kurrësi detyrimin ligjor të ish-bashkëshortit të subjektit për të faturuar shërbimin e ofruar dhe detyrimin e subjektit për ta deklaruar të ardhurën e pritshme për t'u mbledhur në të ardhmen nga shitja e këtij shërbimi. Në përmbledhje, përveç mungesës së deklarimit të ekzistencës së kësaj shume ndër vite dhe në deklaratën *vetting*, për sa kohë nuk provohet gjenerimi i kësaj shume dhe as pagimi i detyrimeve tatimore që i kishin lindur personit të lidhur për shkak të përfitimit të saj e, për pasojë, as ligjshmëria, në zbatim të përcaktimit të shprehur të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për testin e ligjshmërisë së pasurive⁵², ajo nuk u mor në konsideratë nga trupi gjykues i Kolegjit.

31.12. Një ndër parcelat që kanë shërbyer për shkëmbimin e pasurive, si burim i krijimit të truallit prej 2500 m², rezulton të jetë edhe parcela e tokës arë me sipërfaqe 400 m², fituar nëpërmjet kontratës së datës 26.06.2007 – që nënkupton pas lidhjes së martesës të subjektit të rivlerësimit [datë 26.04.2007]. Ky transaksion nuk rezulton të jetë deklaruar në deklaratën e interesave privatë

veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, përfshirë çdo lloj të ardhure, të krijuar nga kjo veprimtari ose ky angazhim [...]”.

⁵¹ Ligji nr. 9109, datë 17.07.2003, “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar nga ligji nr. 9795, datë 23.7.2007 dhe ligji nr. 7758, datë 12.10.1993, “Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet”, i ndryshuar, nenet 2 dhe 4, respektivisht – Neni 2: “Ky ligj vepron mbi çdo subjekt, person fizik, i cili ushtron veprimtari profesionale [...] Për zbatimin e këtij ligji, me “veprimtari profesionale” kuptohet çdo veprimtari [...] shërbimi, duke përfshirë edhe profesionet e lira [...]”. Neni 4: “Fatura. Çdo [...] kryerje punimi e shërbimi që destinohen për një veprimtari profesionale, është objekt faturimi. Çdo faturë duhet të përmbajë numrin, datën dhe vendin e lëshimit, emrin dhe adresën e palëve, datën e realizimit të shitjes ose të punimit a shërbimit, emërtimin e saktë të tyre, çmimin e plotë të shitjes dhe, nëse është rasti, rabatat e zbritjet e tjera të zbatuara, si dhe shumat e shifruara, cilado qoftë mënyra e likuidimit të faturës. Faturat për shitjen e sendeve a kryerjen e punimeve e të shërbimeve, të cilat janë objekt i kërkimit të një tatimi, janë fatura tatimore [...]”.

⁵² “[...] Pasuri të ligjshme, për qëllimet e këtij ligji, konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore [...]”.

për vitin 2007⁵³. Kjo parcelë është një ndër pasuritë objekt i kontratës së regjimit pasuror të pasurive të ndara, të sipërcituar. Subjekti argumenton se burim krijimi i kësaj pasurie ka qenë deklarata për premtim shitjeje me z. D. dhe znj. S. K., e datës 02.10.2006 [shih ndër të tjera paragrafin 31.4/b].

31.13. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim i subjektit nuk duhet të pranohet për disa arsye. Së pari, në një krahasim mes një kontrate shitblerjeje të lidhur rregullisht nga palët përpara noterit, me një deklaratë të thjeshtë noteriale, nën dritën e nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile, kontrata e shitblerjes shoqërohet me peshë të plotë provuese për shkak të autoritetit që i jep ligji, për rrethanat e faktit që ajo përmban. Sipas nenit 690 të Kodit Civil, kontrata ka forcën e ligjit për palët. Së dyti, në kontratën e shitjes, nuk rezulton asnjë referencë në deklaratën për premtim shitjeje, ndërkohë që sipas kësaj të fundit, ishte shlyer e gjithë pagesa. Për më tepër, pa përsëritur sa thënë më sipër, palët nuk duket të kenë pasur asnjë pengesë të hartonin edhe për këtë parcelë një kontratë shitjeje të mirëfilltë, në kushtet kur pagesa pretendohet e kryer dhe objekti i premtimit të shitjes i qartë. Për këto arsye, trupi gjykues, nën dritën e testit të përcaktuar nga pika 4 e nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, për të vendosur mbi bazën e akteve dhe provave në harmoni të dukshme me njëra-tjetrën⁵⁴, e mbështet vlerësimin për këtë pasuri mbi bazën e kontratës së shitblerjes të datës 26.06.2007. Ky qëndrim i trupit gjykues është në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit në raste të ngjashme, në të cilat kontratat e lidhura në mënyrë të rregullt kanë marrë vlerë provuese përkundër deklaratave noteriale⁵⁵. Për të njëjtën arsye, me vendim të ndërmjetëm, trupi gjykues vendosi të mos thërrasë z. P. K. në cilësinë e dëshmitarit, pasi dëshmia e tij, parë në dritën e dispozitave të nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, ishte e panevojshme, në kushtet kur aktet në fashikuj përmbanin dokumentacion të mjaftueshëm lidhur me faktet që kërkohen të provohen.

31.14. Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme financiare për blerjen e truallit prej 400 m² sipas kontratës – në qershor 2007. Në analizën financiare të kryer në vijim të këtij shkak ankimi nga Komisioneri, edhe në Kolegj, rezulton që subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës. Po kështu, edhe nëse përlllogaritja e burimeve të ligjshme nga ana e ish-bashkëshortit bazohet në mundësinë financiare në momentin e pretenduar nga subjekti – në datën 02.10.2006 – sërish ish-bashkëshorti

⁵³ Ekzistenca e tokave arë të ndodhura në {***}, është deklaruar për herë të parë nga subjekti në deklaratën periodike të vitit 2012, kur është deklaruar transaksioni i shkëmbimit me truallin në {***}.

⁵⁴ Neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon “[4.] Komisioni dhe Kolegji i Apelimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...]”.

⁵⁵ Ndër të tjera, në çështjet: nr. 6/2018(JR) që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Besa Nikëhasani, paragrafët 35 dhe 36; çështja nr. 34/2019(JR) që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Prifti, paragrafi 85.2; çështja nr. 2/2020(JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Besnik Cani, paragrafi 20.5; çështja nr. 5/2020(JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Adnand Kosova, paragrafi 41.2; çështja nr. 23/2020(JR) që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Donika Prella, paragrafi 26.2; çështja nr. 29/2020(JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Edison Ademi, paragrafët 32.5 dhe 34.3; çështja nr. 33/2020 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Seci, paragrafi 20.5; si dhe çështja nr. 11/2021 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Përparim Kulluri, paragrafi 20.2.

rezulton me balancë negative për mbulimin e pasurive të krijuara deri në prill 2007, përfshirë këtu edhe pagesën e pasurisë tokë arë 400 m² prej 1.000.000 lekësh. Subjekti ka kërkuar të përfshihen në analizë të ardhurat nga qiratë në periudhën kohore 2005 – prill 2007. Në këtë kontekst, trupi gjykues së pari vëren që ambienti i dhënë më qira, nuk rezulton të ketë qenë pronë e ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës së qirasë. Së dyti, këto të ardhura nuk plotësojnë kriteret e ligjshmërisë, përcaktuar nga pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës pasi nga aktet zyrtare, rezulton që ish-bashkëshorti është regjistruar për detyrime mbi të ardhurat individuale vetëm në vitin 2018⁵⁶. Nga përmbajtja e kësaj shkrese, rezulton se detyrimet tatimore lidhur me të ardhurat e realizuara nga marrëdhëniet e qirasë për disa prej kontratave, janë deklaruar pranë organeve tatimore për efekt të shlyerjes së detyrimeve fiskale, pas dorëzimit të deklaratës *vetting*. Shlyerja e detyrimeve pas dorëzimit të deklaratës *vetting*, ka gjetur trajtim të konsoliduar në jurisprudencën e Kolegjit, ku është theksuar se për efekt të procesit të rivlerësimit, nuk do të merret në konsideratë pagesa e detyrimeve tatimore me vonesë, pas dorëzimit të deklaratës *vetting*⁵⁷. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se edhe kjo e ardhur nuk mund të konsiderohet e ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, duke ndikuar në analizën financiare të viteve përkatëse dhe mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur me të, për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet dhe investimet e kryera.

31.15. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit për përfshirjen në analizën financiare edhe të fondeve të dërguara personit të lidhur [ish-bashkëshortit] nga i vëllai, z. A. B.⁵⁸, situata financiare nuk do të pësonte ndryshime në kah pozitiv. Nëse pranohet premisa që godina 5-katëshe është investim i përbashkët i vëllezërve B., dhe z. A. B. ka investuar për dy kate, në analizë do të duhej të reflektohej kontributi i tij për pjesën takuese, prej përrreth 8.000.000 lekësh. Mbi bazën e kësaj përlllogaritjeje, z. A. B. do të rezultonte me pamjaftueshmëri financiare, pasi vetëm investimi i pretenduar rezulton më i lartë se vlera e shumave të dërguara, prej 5.313.509 lekësh.

31.16. Në përmbledhje të sa është argumentuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar këtë shkak ankimi të Komisionerit. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur gjenden në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të krijuar këtë pasuri, parashikuar në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit, *për pasurinë tokë arë me sip. 400 m², e ndodhur në {***}, Tiranë*, e cila është shkëmbyer me pasurinë e sipërcituar, rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e saj⁵⁹ në datën e kontratës

⁵⁶ Sipas shkresës së DRT Tiranë, datë 11.11.2019 [nr. {***} prot], personi i lidhur është regjistruar si individ për deklaratën DIVA, me datë regjistrimi në sistemin {***}, 09.01.2018, “me datë fillimi transaksioni 01.01.2011”.

⁵⁷ Shih vendimet (JR) nr. 7/2019, (JR) nr. 8/2019, (JR) nr. 19/2019, (JR) nr.5/2020.

⁵⁸ Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka kërkuar që në investimet e z. A. B., në krijimin e pasurive të përbashkëta me personin e lidhur me të, të përfshihet vlera prej 5.313.509 lekësh, që është ekuivalenti i 28.776 GBP, dërguar prej tij nga Britania e Madhe në vitin 2006.

⁵⁹ Nga analiza financiare e kryer në Kolegji, për verifikimin e ligjshmërisë së burimeve financiare të krijimit të kësaj pasurie, rezulton se ish-bashkëshorti i subjektit ka qenë në pamundësi financiare për krijimin e pasurive, kursimeve apo kryerjen e shpenzimeve para lidhjes së martesës, deri në prill 2007. Për rrjedhojë, në analizën e burimeve të ligjshme, është marrë në konsideratë vetëm mundësia e subjektit për të kursyer para martesë dhe të ardhurat familjare për muajt maj-qershor 2007 – meqenëse kontrata e shitblerjes është e muajit qershor 2007. Pamundësia financiare e

së shitblerjes, 26.06.2007, minimalisht në vlerën e konstatuar nga rezultatet e hetimit të Komisionit, në vlerën (-) 803.830 lekë.

31.17. Për rrjedhojë të këtij arsyetimi, nën dritën e nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, aktet e paraqitura nga subjekti në cilësinë e provës, cituar në paragrafin 31.8, u konsideruan pa vlerë provuese, në kushtet kur nuk sjellin asnjë risi, referojnë fakte të provuara nëpërmjet akteve në fashikullin e përcjellë nga Komisioni në Kolegj, ose pretendime të subjektit të analizuar gjerësisht më sipër në këtë arsyetim. Si të tilla, trupi gjykues veçon aktet noteriale nga z. P. K. që konfirmon sa ka pretenduar subjekti, shkresën nga DPT-ja që referon dispozitat ligjore që kushtëzojnë regjistrimin e një pasurie të paluajtshme me pagesën e detyrimeve tatimore, apo kallëzimin penal e ushtruar prej saj në datën 25.02.2022 dhe një deklaram shoqërues që, siç shtjellohet më sipër, u vlerësua pa peshë në procesin e rivlerësimit, nën dritën e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore të subjektit për deklaram dhe të momentit kur është materializuar ky kallëzim.

2. *Apartament me sipërfaqe 66 m² dhe shtesë me sipërfaqe 70,4 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë*

32. Komisioneri Publik ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me këto pasuri, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për shkak se ka kontradikta mes deklaramës *vetting*, deklarameve periodike vjetore, deklarameve përgjatë procesit të rivlerësimit dhe gjatë hetimit administrativ. Shpjegimet e dhëna dhe dokumentacioni i përcjellë krijojnë pamundësi për të verifikuar se cilat, ndër deklaramet e subjektit të rivlerësimit, pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike lidhur me krijimin e pasurive në fjalë dhe, për rrjedhojë, pamundësi objektive për të kontrolluar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të tyre. Komisioneri Publik ka përthithur rekomandimin e ONM-së dhe ndan qëndrim të ndryshëm me Komisionin, pasi, sipas tij, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri.

32.1. Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit në të dy rezultatet e hetimit [përkatësisht të datave 16.10.2019 dhe 27.1.2021], për sa i përket:

- mospërputhjes ndërmjet deklaramës *vetting* dhe deklaramës të interesave privatë periodikë për vitin 2008, lidhur me *pronësinë*, *vlerën* dhe *burimin* për blerjen e pasurisë së apartamentit 66 m². Konkretisht: në deklaramën *vetting* subjekti ka deklaruar vlerën 4.000.000 lekë, ndërsa në deklaramën e interesave privatë për vitin 2008 ka deklaruar vlerën 45 mijë euro; lidhur me pjesën në bashkëpronësi, në deklaramën *vetting* është deklaruar në bashkëpronësi me bashkëshortin 50%, ndërsa në deklaramën e interesave privatë për vitin 2008, ish-bashkëshorti ka deklaruar 25% në bashkëpronësi me vëllanë;

subjektit dhe ish-bashkëshortit për blerjen e tokës me sip. 400 m² dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera deri në qershor 2007, sipas analizës së kryer në Kolegj, është në vlerën 2.739.422 lekë.

- mospërputhjes lidhur me *burimin* e krijimit, pasi në deklaratën e interesave privatë për vitin 2008 deklarohen si burim të ardhurat e bashkëshortit dhe vëllait të tij, ndërsa në deklaratën *vetting*, burimi i deklaruar është një kredi prej 100.000 eurosh, hua nga BKT-ja;
- ndryshimit të çmimit të parashikuar në kontratë, në shumën 4.000.000 lekë, shumës së paguar nëpërmjet Bankës, prej 90.000 eurosh, dhe deklaratës të administruar në dosjen e BKT-së, për vlerën 150.000 euro;
- mungesës së burimeve të ligjshme për likuidimin e kredisë 90.000 euro në të gjitha vitet, si dhe për pagesën e tarifës së legalizimit të pasurisë shtesë, legalizuar 70,4 m² në vitin 2015⁶⁰;
- mosdeklarimit në deklaratën *vetting* dhe në deklaratën periodike vjetore të huas prej 55.000 eurosh, marrë nga z. A. B.;
- shlyerjes së huas me anë të kredisë bankare, ndërkohë që kredia e marrë i është transferuar znj. M. D., një (1) ditë para marrjes së huas;
- mos deklarimit në deklaratën *vetting* dhe në deklaratën e interesave privatë të huas prej 45.000 eurosh, të pretenduar të marrë nga kunati A. B. në vitin 2004 nga M. D., dhe e pretenduar e shlyer nga kredia e marrë prej tij (subjektit);
- mospërputhje midis deklarimit në deklaratën e interesave privatë për vitin 2008 dhe deklarimeve gjatë hetimit administrativ për *qëllimin* e marrjes dhe përdorimin e kredisë bankare prej 90.000 eurosh.

32.2. Në përfundim, Komisioni konkludoi se lidhur me këto pasuri, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë, në analogji edhe *me dy deklaratat noteriale* të datës 03.02.2016. Sipas Komisionit, burim i krijimit të pasurisë ka qenë kredia bankare në vlerën prej 100.000 eurosh, e përfituar nga ish-bashkëshorti, nuk u konstatuan probleme dhe nga analiza financiare përfundimtare, rezultoi se subjekti dhe ish-bashkëshorti kishin mundësi financiare për legalizimin e shtesës së kësaj pasurie dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës.

32.3. Në konsideratë të pretendimeve të Komisionerit, konkluzioneve të Komisionit, pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve të administruara, nën dritën e dispozitave të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 33, pika 5, germa “a” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe siç shtjellohet në detaj në vijim, trupi gjykues i Kolegjit konkludoi që vlerësimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri, është i pabazuar në ligj dhe në prova. Nga analiza e veprimeve juridike të kryera, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim në rrethanat konkrete, rezultoi që shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk ishin bindëse e parashtrimet e tij nuk arritën të zhbënin sa është konstatuar në barrën e provës. Konkluzioni i mësipërm merr në konsideratë një sërë aspektesh të arsyetuara në vijim, përfshirë deklaramet e subjektit ndër vite, në deklaratën e pasurisë, në procesin e rivlerësimit, si dhe aktet e administruara në fashikull. Ndërkohë, pjesa e arsyetimit që i përket analizës së burimeve të ligjshme për të kryer shpenzimet e legalizimit të shtesës së pasurisë në vitin 2015, gjendet e grupuar me analizën e burimeve të ligjshme për shlyerjen e kredive të marra në vitet 2006 dhe 2008, në pjesën e arsyetimit të numërtuar 3, ndërsa referencat

⁶⁰ Ky aspekt i kontrollit të pasurisë është grupuar në arsyetim më tej, në pjesën A.2/3, së bashku me analizën për burimet e ligjshme të shlyerjes së kredive të marra në vitet 2006 dhe 2008.

në këtë rubrikë janë kryesisht për të lejuar një panoramë të plotë të çështjeve që lidhen me këtë pasuri.

32.4. Nga përmbajtja e deklaratave periodike vjetore të viteve 2008 dhe 2015, rezulton se subjekti i ka deklaruar këto dy pasuri *në bashkëpronësi*. E njëjta mënyrë deklarimi rezulton edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*. Në vitin 2008, çmimi i apartamentit është deklaruar 45 mijë euro, ndërsa në deklaratën e pasurisë është deklaruar 4 milionë lekë – diferencë ekuivalente me rreth 1.500.000 lekë ose rreth 12.000 euro. Ndryshimi tjetër rezulton edhe në natyrën e pronësisë. Konkretisht, në vitin 2008, subjekti ka deklaruar që apartamenti i regjistruar *në emër të personit të lidhur*, është në *pronësi të përbashkët me të vëllanë*, ndërsa në deklaratën *vetting* ky specifikim nuk rezulton. Së fundmi, ndërsa në deklaratën e pasurisë si burim krijimi specifikohet kredia nga BKT-ja në vlerën 100 mijë euro nga personi i lidhur, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, burim krijimi deklarohen të ardhurat e bashkëshortit dhe të vëllait.

32.5. Pjesa e pasurisë që përkon me shtesën prej 70,4 m², është deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015, personi i lidhur [ish-bashkëshorti], ku është specifikuar sipërfaqja, legalizimi, të dhëna të tjera për vendndodhjen, si dhe vlera e paguar, që përbëhet nga 1.447.802 lekë dhe bono privatizimi 2.020.000 lekë. Pjesë takuese është deklaruar 100%. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar lidhur me këtë pasuri në deklaratën periodike për vitin 2015. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar gjithë detajet e treguara më sipër, me burim nga *të ardhurat* nga veprimtaria e bashkëshortit si noter dhe *ekonomia familjare*. Subjekti ka deklaruar edhe këtë pasuri *“në bashkëpronësi”*. Personi i lidhur ka deklaruar të njëjtat pasuri, me vlera dhe burime të njëjta dhe pjesë takuese *në bashkëpronësi*, në masën 50%.

32.6. Gjatë hetimit administrativ dhe në përgjigje të barrës së provës për rezultatet e hetimit të datës 27.01.2021⁶¹, subjekti i rivlerësimit është shprehur se ish-bashkëshorti ka gëzuar një të drejtë reale mbi apartamentin objekt analize, qysh para lidhjes së martesës – referuar kontratës së datës 17.03.2007 [për regjimin e pasurive të ndara]. Lidhur me mospërputhjet në çmimin e apartamentit në dokumente të ndryshme dhe në kohë të ndryshme, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se çmimi është 4 milionë lekë sipas kontratës së shitjes, që përbën të vetmin akt juridik sipas parashikimeve të Kodit Civil. Shuma 150.000 euro e përmendur në deklaratën e datës 16.01.2008 [shih paragrafin 32.8/a], sipas subjektit të rivlerësimit, nuk është paguar dhe deklarata nuk prodhon efekte juridike pasi termat e vendosur në të ishin “eventuale”. Ajo përbën një akt përmes të cilit palët zotoheshin se në të ardhmen do të kryenin një shitblerje. Ndërsa shuma 90.000 euro, e transferuar te znj. M. D. [paragrafi 32.8/c] ka qenë kërkesë e shitëses së apartamentit dhe për shlyerjen e një huaje marrë më parë pa kontratë dhe pa interes nga vëllai i personit të lidhur (A. B.). Po ashtu, sipas subjektit, personi i lidhur ka pasur një balancë pozitive burimesh financiare të ligjshme në datën 27.08.2015, datën e pagesës së vlerës së truallit.

⁶¹ Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime për këtë pasuri dhe në përgjigjen e datës 22.11.2019, për rezultatet e hetimit të datës 16.10.2019 (f. 33 - 41).

32.7. Në parashtrimet e saj në Kolegj për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, ritheksoi si burim kredinë bankare prej 100.000 eurosh nga BKT-ja, marrë nga ish-bashkëshorti. Ajo po ashtu argumentoi edhe që dorëzania nuk e bën atë pronare apo bashkëpronare, meqenëse dorëzanës mund të jenë edhe individë pa asnjë lidhje me një pasuri. Ky aspekt, sipas saj, e bën ankimin të papranueshëm pasi nuk konfirmon bashkëpronësinë. Mospërputhja mes çmimit të referuar në kontratën e shitjes dhe pagesës së kryer sipas transfertës bankare në dobi të çiftit D., konkretisht 4 milionë lekë kundrejt 45 mijë eurove (që në ALL është ekuivalenti i rreth 1.500.000 lekëve ose rreth 12.000 eurove), është pasojë e një vlerësimi të kostos së shtesës së ndërtuar nga pronarët e pasurisë, sipas ish-bashkëshortit. Sipas subjektit, shtesën e kanë ndërtuar pronarët, por kanë autorizuar për legalizim [dhe vetëdeklarim] pranë autoriteteve përkatëse ish-bashkëshortin e saj, në qershor të vitit 2006⁶².

32.8. Së pari, nga aktet në fashikull rezultojnë një sërë veprimesh juridike që paraprinë dhe pasuan kontratën e shitblerjes së apartamentit prej 66 m² më datë 31.01.2008, lidhur mes shitëses [znj. M. P.] dhe ish-bashkëshortit të subjektit, z. A. B., kundrejt çmimit prej 4 milionë lekësh. Për lehtësi reference, hapat e ndjekur vijojnë në rrjedhë kronologjike:

- a. Më datë 16.01.2008, shitësja [M. P.], në prani të subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, dhe ish-bashkëshortit të saj, si dhe z. M. dhe znj. M. D., ka lëshuar një deklaratë sipas së cilës është rënë dakord për shitjen e apartamentit “për shumën 150.000 euro”, nga të cilat janë parapaguar 5.000 euro. Pjesa tjetër do t’i jepet në momentin e përpilimit të kontratës së shitjes.
- b. Më datë 29.01.2008, është lidhur kontrata e kredisë dhe ajo hipotekore mes Bankës Kombëtare Tregtare (në vijim “BKT”) dhe kredimarrësit A. B.. Në cilësinë e dorëzanës për kredinë, pasqyrohet subjekti i rivlerësimit, referuar në kontratë znj. Elizabeta B. (Imeraj). Kredia është akorduar në shumën 100.000 euro për blerje shtëpie. Me kontratën hipotekore, po atë ditë, z. A. B. (hipotekues) dhe subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta B. (Imeraj), me cilësinë e bashkëshortes së hipotekuesit, kanë lidhur kontratë hipoteke. Subjekti ka shprehur miratimin për nënshkrimin e këtij akti. Në nenin 2 të kontratës përcaktohet se garanci është pasuria apartament me sipërfaqe 73 m², në rrugën “{***}”, Tiranë.
- c. Më datë 31.01.2008, është kryer shitblerja e apartamentit, siç referohet më sipër, në cilësinë e shitëses, znj. P.. Sipas kontratës, vlera e apartamentit është 4 milionë lekë. Në të njëjtën ditë, është disbursuar kredia në shumën 100.000 euro, prej tyre shuma 90 mijë euro është transferuar në llogari të znj. M. D. – një individ që nuk është shitësja [M. P.] – me përshkrimin: “sa kaluar në llogari për blerje apartamenti për M. D.”. Po atë ditë, më 31.08.2008, znj. M. D. ka transferuar te një individ tjetër, z. G. L., shumën prej 90 mijë eurosh, me përshkrimin: “sa kaluar në llogari për blerje apartamenti”.

⁶² Nga një kontratë premtim shitjeje e datës 09.06.2006 [në fashikull], me objekt apartamentin në fjalë, në pronësi të M. P., i ofrohet ish-bashkëshortit të subjektit, z. A. B., “sapo të jetë gati për shitje”. Nga ana tjetër, sipas kontratës, z. A. B. rezulton se “ka edhe pjesën ballore të banesës” – një ndërtim pa leje rreth 50 m² – për të cilin “ka të drejtën e aplikimit për legalizim”. Shitësja deklaroi se ka marrë një paradhënie në momentin e përpilimit të kontratës. Prezentë në lidhjen e kësaj kontrate, kanë qenë dhe M. D. dhe M. D..

- d. Më datë 01.02.2008, një ditë pas (i) marrjes së kredisë; (ii) blerjes së apartamentit; dhe (iii) transfertës bankare në favor të çiftit D. – si pretenduar, “për blerje apartamenti për M. D.” – ish-bashkëshorti i subjektit i ka marrë hua znj. M. D. 55 mijë euro, me afat deri njëvjeçar [deri në 01.02.2009]⁶³. Në kontratë nuk është përcaktuar qëllimi i përdorimit të huas.
- e. Më datë 03.02.2016, 8 (tetë) vite pas transaksionit të konfirmuar bankar në paragrafin “c” më sipër, përfituesit e shumës prej 90 mijë eurosh, znj. M. dhe z. M. D., kanë hartuar një deklaratë noteriale sipas së cilës rezulton se nga shuma prej 90 mijë eurosh, e përfituar prej tyre më 31.01.2008, referuar më sipër, vetëm 45 mijë euro kanë qenë për apartamentin objekt shqyrtimi, shitur A. B. nga znj. M. P.. Shuma e mbetur prej 45 mijë euro ka qenë kthim i një huaje të marrë atyre nga vëllai i ish-bashkëshortit, z. A. B., në vitin 2004⁶⁴. Z. A. B., deklaronë ata, e kishte marrë këtë hua pa interes dhe me të drejtë kthimi prej 5 (pesë) vjetësh. Në të njëjtën datë [03.02.2016], edhe individit që rezulton në cilësinë e shitëses së apartamentit, znj. M. P., ka hartuar një deklaratë noteriale për të konfirmuar se “shuma e shitjes së apartamentit në rrugën “{***}” i është dorëzuar nga e afërmeja e saj znj. M. D.”.

32.9. Në përmbledhje të sa më sipër, rezulton që subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, ka hyrë në kontratë hipotekore në cilësinë e bashkëshortes së personit të lidhur, për të garantuar një kredi, nëpërmjet një pasurie të paluajtshme [shtjelluar në vijim]. Kredia e marrë, prej 100 mijë euro, nuk përkon me çmimin e pasurisë së blerë, duke qenë më shumë se dyfish më e lartë në vlerë. Nga shuma e kredisë, 90 mijë euro u janë transferuar në të njëjtën ditë individëve që nuk janë shitës, dhe rimarrë mbrapsht 55 mijë prej tyre si hua, për qëllime të paspecifikuara. Tetë vite më pas, në prag të miratimit të ligjit për rivlerësimin kalimtar, shitësja dhe palët në transaksionet bankare të mësipërme, kanë deklaruar që pagesa e apartamentit i është lëvruar shitëses, që kjo e fundit është e afërme e tyre, e që shuma që mbetej ishte hua e prapambetur që u detyrohej atyre nga z. A. B., vëllai i personit të lidhur [ish-bashkëshortit] të subjektit. Huaja e marrë nga ish-bashkëshorti dy individëve të cilëve një ditë më herët u lëvroi 90% të kredisë së marrë, nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike të vitit 2008 dhe nuk gjen pasqyrim as në vitet në vijim, ndonëse përbënte minimalisht detyrim sipas ligjit nr. 9049/2003, neneve 1 dhe 4, germa “dh” dhe potencialisht edhe detyrim kushtetues nëse huaja ka ekzistuar në kohën kur subjekti ka plotësuar deklaratën e pasurisë *vetting*. Kolegji sjell në vëmendje që dy javë përpara lëvrimin të kredisë dhe kontratës së shitjes së kësaj pasurie, në prani të subjektit, ish-bashkëshortit dhe dy individëve të tjerë të sipërcituar, vlera e apartamentit është deklaruar të jetë 150 mijë euro, dhe shitëses i janë parapaguar 5 mijë euro.

32.10. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit çmoi që shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk ishin bindëse. Së pari, pasi siç rezulton qartë nga aktet e sipërcituara, në aktet zyrtare për të cilat subjekti mban përgjegjësi personale dhe profesionale, ndër vite, ka deklaruar pasurinë në

⁶³ Sipas një deklaratë noteriale të M. dhe M. D., hartuar në datën 08.04.2013, z. A. B. e ka shlyer detyrimin në të holla që u ka marrë më datë 01.02.2008.

⁶⁴ Me deklaratën noteriale të datës 12.11.2019, gjatë hetimit administrativ të parë, z. A. B. ka deklaruar se në vitin 2004 i ka marrë hua 55.000 euro M. dhe M. D..

bashkëpronësi me ish-bashkëshortin. Konkretisht, lidhur me pjesën takuese: në deklaratën *vetting*, subjekti deklaroi *bashkëpronësi*, ndërsa në deklaratën e interesave privatë për vitin 2008 deklaroi *bashkëpronësi në pjesë takuese 25%*. Një situatë ligjore e ngjashme mospërputhjes gjen zbatim edhe sa i përket vlerës së pasurisë: në deklaratën *vetting*, vlera e apartamentit 66 m² deklarohet 4 milionë lekë, ndërsa në deklaratën e interesave privatë për vitin 2008 deklarohet 45 mijë euro, një diferencë prej rreth 1.500.000 lekësh ose rreth 12.000 eurosh. Nga ana tjetër, të dyja këto vlera janë të ndryshme nga vlera 90 mijë euro e transfertës në favor të M. D. për blerje apartamenti, teksa të nesërmen e transfertës ish-bashkëshorti duket se ka rimarrë 55 mijë euro mbrapsht nga i njëjti person si hua, pa specifikuar qëllimin apo nevojën. Së fundmi, subjekti ka qenë kontradiktor edhe lidhur me burimin e krijimit: në deklaratën *vetting* deklarohet si burim kredia bankare pranë BKT-së, ndërsa në deklaratën e interesave privatë për vitin 2008 deklarohet pagesa bashkërisht me vëllanë e personit të lidhur.

32.11. Pa përsëritur sa është arsyetuar më sipër lidhur me regjimin e pasurive të ndara dhe pasojën që sjell ky pretendim i ngritur për herë të parë në procesin e rivlerësimit, pasi ndërsa ndër vite dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti dhe personi i lidhur janë shprehur për bashkëpronësi, mospërputhjet në lidhje me çmimin e apartamentit në akte dhe në pohimet e saj, apo në burimin e krijimit, çojnë në paqartësi lidhur me shpenzimet reale të blerjes së këtyre pasurive, apo identifikimit të versionit të saktë mbi bazën e të cilit institucionet e rivlerësimit do të duhet të kryejnë kontrollin e kriterit të pasurisë.

32.12. Lidhur me marrëdhëniet e huave të lidhura me kredinë, të rezultuara gjatë hetimit administrativ, sikurse (i) *hua marrë nga A. B. në shumën 45.000 euro* (deklaruar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit të Komisionit, si një nga destinacionet e kredisë së marrë në vitin 2008); dhe (ii) *hua marrë nga A. B. në shumën 55.000 euro*, nga të dhënat e sipërcituara në rubrikën e veprimeve të renditura në mënyrë kronologjike, pa përsëritur sa është shtjelluar më sipër në paragrafin 32.9, për detyrimet që ka pasur subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, për deklaram, mungesa e deklaramit analizohet në drejtim të besueshmërisë së pretendimeve të kryera prej saj gjatë procesit të rivlerësimit, dhe si një përpjekje për të kapërcyer hendekun mes sa rezulton nga aktet dhe çfarë ajo ka deklaruar dhe pohon. Asnjë nga këto hua nuk është deklaruar në asnjë prej deklaramave të interesave privatë, sikurse nuk rezulton të jetë deklaruar as kthimi i huas në shumën 55.000 euro. Nuk rezulton i qartë as edhe destinacioni i kredisë, i pretenduar të ketë shërbyer pjesërisht për shlyerjen e huas në shumën 45.000 euro, në kushtet kur personi i lidhur ka marrë hua të re nga një individ të cilit një ditë më parë i kishte lëvruar 90 mijë euro. Në rrethanat që deklaramet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga institucionet e rivlerësimit, sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, fakti që këto veprime nuk kanë lënë gjurmë as në deklaramet e subjektit ndër vite, në zbatim të ligjit nr.

9049/2003⁶⁵, e bën pranimin e pretendimeve të saj në proces të pamundur, shtjelluar gjerësisht nga Kolegji në jurisprudencën e tij⁶⁶.

32.13. Në përfundim, për pasurinë e paluajtshme, e përbërë nga një apartament me sipërfaqe 66 m² dhe shtesë [e legalizuar] me sipërfaqe 70,4 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, për sa është shtjelluar në detaj më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur gjenden në kushtet e deklaramit të pasaktë, që bie ndesh me parashikimet e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Si pasojë e deklaramive kontradiktore të subjektit të rivlerësimit gjatë plotësimit të deklaratës *vetting*, në deklaratat e interesave periodikë/vjetorë, deklaramive përgjatë procesit të rivlerësimit, si dhe qëndrimit gjatë hetimit administrativ, është krijuar pamundësi objektive për institucionet e rivlerësimit për të identifikuar cilat janë faktet që pasqyrojnë situatën e vërtetë të pasurisë në fjalë dhe, për rrjedhojë, pamundësi objektive për të kontrolluar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të tyre.

3. *Kreditë e viteve 2006 dhe 2008 dhe shpenzimet e vitit 2015*

- 33.** Pas shqyrtimit të akteve të administruara në dosjen e Komisionit, bazuar në rekomandimin e ONM-së të datës 21.06.2021 dhe në përmbajtjen e gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, të datës 12.02.2020, Komisioneri Publik ka argumentuar që subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar për shlyerjen e kredisë së marrë në tetor 2006, për sa kohë që nuk rezulton të ketë deklaruar kursime *cash* apo posedim të likuiditeteve *cash* në DV-2006. Po ashtu, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës për shlyerjen e kësteve të kredisë së marrë në janar 2008, si dhe për shpenzimet e kryera për legalizimin e shtesës në vitin 2015. Në këto kushte, Komisioneri Publik konstaton se deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i pamjaftueshëm, në referencë të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Komisioneri Publik sjell në vëmendje që, në referencë të pikës 10 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, gjetjet e vëzhguesve ndërkombëtarë përbëjnë provë që dëshmon një fakt, rrethanë apo standard ligjor.

33.1. Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës në rezultatet e hetimit të datës 16.10.2019, lidhur me:

- mospërputhjet për destinacionin e kësaj kredie midis deklaramit të subjektit në deklaratën e interesave privatë për vitin 2006 dhe qëllimit të kredisë të parashikuar në kontratën me bankën;

⁶⁵ Neni 4, shkronja “dh” parashikon detyrimin e subjekteve deklaruese që brenda datës 31 mars të çdo viti, të deklarojnë gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës, të detyrimeve financiare, përfshirë detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj.

⁶⁶ Shih edhe jurisprudencën e Kolegjit, e konkretisht vendimet nr. 6/2018, nr. 8/2018, nr. 9/2018, nr. 11/2018, nr. 12/2018, nr. 5/2019, nr. 19/2019, nr. 20/2019, nr. 5/2020, nr. 27/2020.

- faktin se nga kontrata e hipotekimit, rezulton se ndërtesa 5-katëshe, në pronësi të bashkëshortit të subjektit, nuk ka qenë e përfunduar, ndryshe nga sa deklarohet në deklaratën *vetting*;
- faktin se gjendja *cash* në shtëpi (shuma e kredisë së tërhequr), nuk është deklaruar në deklaratën e interesave privatë për vitin 2006;
- mospërputhjet midis deklaratimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, në deklaratën periodike të vitit 2007, që kredia është shlyer plotësisht nga ish-bashkëshorti i saj dhe shpjegimeve të saj gjatë hetimit;
- faktin se nga analiza financiare, rezulton se subjekti dhe personi i lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme shlyerjen e parakohshme të kredisë dhe mbulimin e shpenzimeve të periudhës, për një diferencë negative prej [-] 1.235.725 lekësh;
- mungesën e burimeve të ligjshme për likuidimin e kredisë 100.000 euro në të gjitha vitet, si dhe për pagesën e tarifës së legalizimit të pasurisë shtesë 70,4 m², në vitin 2015.

33.2. Në rezultatet e hetimit të datës 27.01.2021, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për gjithë sa më sipër, me përjashtim të pikës së fundit, konkretisht, mungesën e burimeve të ligjshme për likuidimin e kredisë prej 100.000 eurosh në të gjitha vitet. Nga ana tjetër, në analizën financiare të kryer nga Komisioni, pjesë e këtyre rezultateve hetimore, vitet 2008 dhe 2009 rezultojnë me balancë negative në vlerën totale prej (-) 773.408 lekësh.

33.3. Në përfundim, Komisioni ka konkluduar se nuk u konstatua shpenzim i kryer për shlyerjen e vlerës së kredisë për ndërtim shtëpie në vitet 2006 dhe 2007, dhe i konsideroi bindëse deklaratimet e subjektit për mospërdorimin e kredisë, meqenëse kredia e përfituar është deklaruar edhe në deklaratën periodike për vitin 2006. Vlera e kredisë së papërdorur në vitin 2006, u konsiderua si burim kryesor i shlyerjes në vitin 2007, së bashku me të ardhurat e subjektit dhe të ish-bashkëshortit. Mosdeklarimin e gjendjes *cash* në deklaratën e interesave privatë për vitin 2006, Komisioni e konsideron si paqartësi të subjektit në plotësimin e deklaratës, pasi subjekti e ka deklaruar si të ardhur kredinë e përfituar në këtë vit, duke u pasqyruar kështu edhe gjendja e saj deri në datën 31.12.2006. Sipas Komisionit, detyrimi për të deklaruar gjendjen *cash* ka lindur “vetëm me ndryshimet e ligjit nr. 9049/2003 në vitin 2014”. Së fundmi, Komisioni vlerësoi se subjekti dhe ish-bashkëshorti kishin mundësi financiare për legalizimin e shtesës së pasurisë së trajtuar më sipër, në pjesën e numërtuar 2 [apartament dhe shtesë në rrugën “{***}”] dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës.

33.4. Në konsideratë të pretendimeve të Komisionerit, konkluzioneve të Komisionit, pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve të administruara, nën dritën e dispozitave të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 33, pika 5, germa “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe siç shtjellohet në detaj në vijim, trupi gjykues i Kolegjit konkludoi që vlerësimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri është i pabazuar në ligj dhe në prova. Nga analiza e veprimeve juridike të kryera, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim në rrethanat konkrete, rezulton që shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, nuk ishin bindëse e parashtrimet e

saj nuk arritën të zhbënin sa është konstatuar në barrën e provës. Po ashtu, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se gjetjet e vëzhguesve ndërkombëtarë dëshmojnë për fakte e rrethana ligjore, nën dritën e nenit 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016⁶⁷. Si rrjedhojë, përmbajtja e gjetjes së datës 12.02.2020, e depozituar nga vëzhguesi ndërkombëtar, u mor në shqyrtim dhe është pjesë integrale e analizës së trupit gjykues të Kolegjit.

33.5. Konkluzioni i mësipërm merr në konsideratë një sërë aspektesh të arsyetuara në vijim, përfshirë deklaratimet e subjektit ndër vite, në deklaratën e pasurisë, në procesin e rivlerësimit dhe aktet e administruara në fashikull. Një analizë e të gjitha këtyre aspekteve parashtrohet në vijim, përfshirë veprimet juridike të cilat rezultojnë nga aktet në fashikull.

- a. Me kontratën e kredisë të datës 09.10.2006, lidhur ndërmjet BKT-së dhe subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, në cilësinë e kredimarrëses dhe z. A. B., në cilësinë e dorëzanësit, është miratuar lëvrimi i një shume kredie prej 2.000.000 lekësh, në favor të kredimarrëses, me qëllim “ndërtimin e një shtëpie”. Sipas kushteve të kontratës së kredisë, kredimarrësi dhe dorëzanësi sigurojnë kredinë e dhënë nga banka, me anë të hipotekimit të dy pasurive në emër të dorëzanësit, e konkretisht një truall me sipërfaqe 332 m², ndodhur në {***}, si dhe një apartament dhe ambiente ndihmëse me sip. 61 m², të ndodhur në {***}, Durrës.
- b. Në të njëjtën datë, më 09.10.2006, është nënshkruar kontrata e hipotekimit, me hipotekues z. A. B. dhe subjektin e rivlerësimit, në cilësinë e së fejuarës. Sipas kontratës, kredimarrësi dhe dorëzanësi garantojnë se me marrjen e titullit të pronësisë për objektin në ndërtim mbi truallin prej 332 m², do të bëhet bllokimi në favor të BKT-së, brenda shtatorit 2007. Kontrata parashikon edhe penalitete në rast vonese.
- c. Nga llogaria bankare e subjektit të rivlerësimit pranë BKT-së, rezulton se kredia është disbursuar në datën 17.10.2006, dhe është tërhequr në *cash* në po të njëjtën datë nga subjekti.
- d. Në datën 07.05.2007, subjekti ka depozituar në BKT shumën 2.079.000 lekë, me përshkrimin: “sa derdhur për mbyllje kredie”.
- e. Kredia bankare nga BKT-ja, në vlerën 100 mijë euro, referuar në detaj më sipër, është marrë në vijim të kontratës së kredisë së datës 29.01.2008 dhe kontratës së hipotekës së të njëjtës datë. Garanci për këtë kredi, ish-bashkëshorti dhe subjekti kanë vendosur apartamentin prej 73 m² [trajtuar në vijim], me vendndodhje në rrugën “{***}”, Tiranë⁶⁸.
- f. Sa u përket veprimeve juridike që kanë paraprirë shtesën anësore me sipërfaqe 70,4 m², nga aktet në fashikull, ajo rezulton të jetë vetëdeklaruar fillimisht nga personi i lidhur, ish-bashkëshorti, më 22.10.2006, pranë ALUIZNI-t. Si pasojë e veprimeve administrative të kryera në vijim, përfshirë kontratën e kalimit të pronësisë të parcelës ndërtimore dhe lejes së

⁶⁷ Neni 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016 përcakton: “[...] 10. Gjetja, e paraqitur në formën e një deklaratë, dokumenti ose raporti të dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar përbën provë që dëshmon një fakt, rrethanë ose standard ligjor, i cili ekziston ose ka ndodhur. Gjetja parashtron rrethanat për konstatimin e bërë. Komisioni ose Kolegji i Apelitimit e çmon gjetjen si të barasvlershme me mendimin e dhënë nga një ekspert. Refuzimi i gjetjes bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionit ose të Kolegjit të Apelitimit [...]”.

⁶⁸ Shih edhe referencën në të njëjtën kontratë në pasuritë në rrugën “{***}”, shtjelluar në paragrafin 32.8/b.

legalizimit për shtesën, ish-bashkëshorti është bërë pronar edhe i shtesës kundrejt pagesës së 1.447.802 lekëve, respektivisht në datat 27.08.2015 dhe 31.08.2015, për parcelën ndërtimore.

33.6. Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2006, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar kredinë prej 2 milionë lekësh nga BKT-ja, *për rregullimin e shtëpisë dhe blerjen e pajisjeve elektroshtëpiake*. Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *shlyerje totale kredie nga bashkëshorti* në muajin maj 2007.

33.7. Kredia e dytë objekt analize, marrë në vitin 2008, referuar edhe më sipër, është deklaruar në deklaratën periodike vjetore për vitin 2008, në rubrikën që u përket detyrimeve financiare, në emër të A. B., *për blerje apartamenti tek “{***}” dhe tek “{***}” dhe vlerën përkatëse [100 mijë euro]*.

33.8. Sa u përket veprimeve juridike që kanë paraprirë shtesën anësore me sipërfaqe 70,4 m², nga aktet në fashikull, ajo rezulton të jetë vetëdeklaruar fillimisht nga personi i lidhur, ish-bashkëshorti, më 22.10.2006 pranë ALUIZNI-t. Si pasojë e veprimeve administrative të kryera në vijim, përfshirë kontratën e kalimit të pronësisë të parcelës ndërtimore dhe lejes së legalizimit për shtesën, ish-bashkëshorti është bërë pronar edhe i shtesës kundrejt pagesës së 1.447.802 lekëve, respektivisht në datat 27.08.2015 dhe 31.08.2015 për parcelën ndërtimore.

33.9. Në përgjigje të barrës së provës⁶⁹, për sa u përket *mospërputhjeve në deklarin e qëllimit të kredisë*, subjekti i rivlerësimit ka rikonfirmuar sa është referuar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, e konkretisht që kredia ka pasur për qëllim *konstrukcion banese dhe blerjen e pajisjeve shtëpiake*. Së fundmi, lidhur me pamundësinë financiare të konstatuar për shlyerjen e kredisë, subjekti ka argumentuar se kredia është deklaruar saktë në deklaratën periodike të vitit 2006 – në rubrikën e detyrimeve financiare – por nuk është deklaruar në rubrikën e ndryshimeve të pasurisë, pasi ka vlerësuar se nuk lidhej me gjendjen e krijuar për shkak kursimi. Po ashtu, subjekti ka deklaruar se kredia nuk është përdorur në asnjë pjesë, e më pas i është kthyer bankës.

33.10. Gjatë seancave gjyqësore në Kolegj dhe në parashtrime, në mënyrë të përmbledhur, argumentet e subjektit të rivlerësimit konsistojnë në shpjegime se si ajo e ka kuptuar ligjin në momentin e plotësimit të deklaratës periodike vjetore për vitin 2006, si pasojë e së cilës, nuk ka deklaruar gjendjen *cash* të kredisë së papërdorur. Subjekti kërkoi që të mos merren në konsideratë shkaqet e ngritura nga Komisioneri Publik lidhur me këtë kredi, pasi ato bien ndesh me vlerësimin e bërë nga Komisioni. Për të provuar që kredia e marrë dhe tërhequr në *cash* menjëherë pas disbursimit në tetor 2006, nuk është konsumuar në fund të vitit, dhe rikthyer disa muaj më vonë në bankë, subjekti paraqiti disa akte shkresore⁷⁰. Analiza e kryer në këtë vendim, është bazuar ndër të tjera edhe në sa provojnë këto akte shkresore, apo sa janë relevante. Ndër to, kredia bankare ishte pjesë e fashikujve të përcjellë nga Komisioni [referuar e përmbledhur më sipër në paragrafin

⁶⁹ Përgjigje të rezultateve të hetimit të datës 27.01.2021.

⁷⁰ Konkretisht: i) kontratë kredie bankare nr. {***}, datë 09.10.2006; (ii) aneks mbi likuidimin e kredisë në vijim; (iii) shkresa e datës 17.03.2022, lëshuar nga BKT ShA; (iv) shkresa e datës 21.02.2022, lëshuar nga DPPZHT, Bashkia Tiranë; dhe (v) deklarata vjetore e pasurisë, viti 2006.

33.5/a] dhe është pjesë integrale e këtij shkaku ankimi, sikurse është edhe fakti i provuar që kredia e marrë për 240 muaj, është shlyer pas shtatë (7) muajsh me fondet e arkëtuara nga subjekti i rivlerësimit, konkretisht në datën 07.05.2007⁷¹. Po ashtu, pjesë e fashikujve është edhe deklarata periodike e pasurisë për vitin 2006, mbi bazën e së cilës është ngritur ky shkak ankimi. Provë të re përbën shkresa që provon se prindërit e subjektit të rivlerësimit nuk rezultojnë të kenë përfituar leje ndërtimi, zhvillimi apo të kenë deklaruar ndërtim pa leje në vitet 2005-2008⁷². Këto konstatime paraqesin rëndësi nën dritën e përcaktimeve ligjore të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, siç shtjellohet edhe më sipër. Në zbatim të kësaj dispozite, aktet e sipërcituara, u vlerësuan pa vlerë provuese, në kushtet kur nuk sjellin asnjë risi dhe referojnë fakte të provuara nëpërmjet akteve në fashikullin e përcjellë nga Komisioni në Kolegj, ose pretendime të subjektit të bëra pjesë e analizës nëpërmjet parashtrimeve të saj gjatë procesit të gjykimit në Kolegj.

33.11. Në përmbledhje të sa më sipër, mbetet i pakontestuar fakti që subjekti i rivlerësimit në fund të vitit 2006 nuk ka deklaruar se kredia e tërhequr ishte ruajtur *cash* në shtëpi. Po ashtu, subjekti ka deklaruar dhe përfituar kredinë për ndërtimin e një shtëpie, ndërsa në deklaratën periodike vjetore të pasurisë është shprehur për rregullim shtëpie dhe blerje pajisjesh shtëpiake. Së treti, në deklaratën periodike vjetore për vitin pasardhës, subjekti ka deklaruar se shlyerja e plotë e kredisë është kryer nga ish-bashkëshorti. Përkundër këtyre tri deklaratave të kohës, pavarësisht nga mospërputhjet mes qëllimit të pretenduar në cilësinë e kredimarrëses kundrejt asaj të subjektit deklarues si funksionare publike [ligji nr. 9049/2003], subjekti ka parashtruar pretendime krejtësisht të ndryshme në procesin e rivlerësimit, të cilat janë pranuar nga Komisioni.

33.12. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimet e subjektit të rivlerësimit në procesin e rivlerësimit, janë jobindëse. Ky konkluzion mbështetet jo vetëm në mospërputhjet e identifikuara më sipër, por edhe në konsideratë të rëndësisë provuese të deklaratave periodike vjetore sa i përket gjendjes së *cash*-it jashtë sistemit bankar, sipas dispozitave të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që ka gjetur trajtim gjerësisht në një sërë çështjesh të gjykuara nga Kolegji⁷³. Sikurse u trajtua edhe në paragrafët e mësipërm, në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, neni 4, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklaronte saktësisht gjendjen financiare të likuiditeteve, pas tërheqjes së tyre nga banka. E njëjta frymë përshkruhet edhe në udhëzimet e formularit për plotësimin e deklaratës periodike. Në këtë dokument, në rubrikën “deklarimi i interesave privatë, pasuri të paluajtshme/të luajtshme”, përfshihet edhe detyrimi për të deklaruar [...] *vlerën e likuiditeteve, gjendjen në cash,*

⁷¹ Shkresa e Bankës Kombëtare Tregtare e sipërcituar në poshtëshënim, e cila konfirmon sa është administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, mbi bazën e fakteve të dokumentuara, prej së cilës Komisioneri ka ngritur këtë shkak ankimi. Sipas kësaj shkrese, kredia e disbursuar më datë 17.10.2006, bazuar në kontratën e kredisë nr. {***} rep., {***} kol., datë 09.10.2006, është likuiduar përpara afatit të maturimit më datë 07.05.2007, me fondet e arkëtuara nga znj. Elizabeta Imeraj.

⁷² Në këtë përgjigje, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit informon se znj. Elizabeta Imeraj, z. A. I. dhe znj. Zylfie Imeraj nuk janë pajisur me leje ndërtimi, leje zhvillimi apo deklaratë paraprake punimesh gjatë viteve 2005, 2006, 2007, 2008.

⁷³ Shih, ndër të tjera, vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit Xh. Zaganjori [JR 19/201], vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit D. Peka [JR 33/2020], vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit A. Martini [JR 13/2021] etj.

në llogari rrjedhëse [...] në datën 31 dhjetor të vitit paraardhës. Nën dritën e këtyre normave, në kushtet kur subjekti nuk ka deklaruar gjendje cash më 31 dhjetor 2006, prezumohet se nuk kishte të tillë. Ky prezumim duket se është në të njëjtën linjë edhe me deklarimin e vetë subjektit në deklaratën e vitit pasardhës [vitin 2007] për “shlyerje totale të kredisë nga bashkëshorti”. Nga ana tjetër, pretendimi i subjektit në proces për një mënyrë të kuptuari, sipas së cilës cash-i i përfituar nga kredia dhe i papërdorur nuk nevojitej të deklarohet, për sa kohë nuk ishte fitim nga të ardhurat, është i pakuptimtë nën dritën e parashikimeve të qarta të ligjit dhe të formularit, sikurse edhe i papranueshëm për një magjistrate me përvojë. Po ashtu, është i pabazuar konkluzioni i Komisionit se vetëm me ndryshimet e ligjit nr. 9049/2003 në vitin 2014⁷⁴, u parashikua detyrimi për deklarimin e gjendjes së cash-it. Detyrimi i deklarimeve të cash-it ka qenë pjesë integrale e ligjit nr. 9049/2003. Ndryshimet e sjella në vitin 2014 vetëm shtuan togfjalëshin sqarues “jashtë sistemit bankar”, ndërsa deklarimi i cash-it në çfarëdo vendndodhje ishte qartazi i parashikuar që në vitin 2003. Edhe subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, duhet të ketë qenë e qartë për këtë përcaktim të shprehur, siç rezulton nga deklarata periodike vjetore e saj për vitin 2012, përpara ndryshimeve të vitit 2014. Konkretisht, në deklaratën për vitin 2012, subjekti ka deklaruar kursime cash në vitin 2012 – nga paga e saj në lekë, si dhe euro, ndihma nga vëllezërit e bashkëshortit⁷⁵.

33.13. Për rrjedhojë, duke i parë mospërputhjet e deklarimeve të subjektit ndër vite dhe në proces në tërësinë e tyre, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë provuar të kundërtën e barrës së provës lidhur me pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar për shlyerjen e kredisë në maj 2007, për sa kohë që nuk rezulton të ketë deklaruar kursime cash apo posedim të likuiditeteve cash në deklaratën e interesave private për vitin 2006. Pretendimi i saj për cash-in e disponuar, mbeti në nivel deklarativ. Kjo analizë vjen në qasje me jurisprudencën e konsoliduar tashmë të Kolegjit, në lidhje me deklarimet e kursimeve cash nga ana e subjekteve të rivlerësimit⁷⁶. Për rrjedhojë, mungesa e burimeve të ligjshme të konstatuara nga Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ, u konfirmua edhe në analizën e kryer në Kolegji për vitin 2007. Në konkluzion të sa më sipër, pretendimi i Komisionerit Publik është i bazuar, pasi personi i lidhur rezulton me një balancë negative prej [-] 1.239.726 lekësh minimalisht⁷⁷.

33.14. Më tej, Kolegji analizoi shkakun e ankimit të Komisionerit Publik që lidhet me mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për të kryer shpenzimet e legalizimit të shtesës në vitin 2015, në pasurinë në “{***}” [shtjelluar më sipër në detaj, për sa i përket apartamentit]. Nga aktet në fashikull, rezulton që subjekti ka deklaruar si burim të mbulimit të shpenzimeve, të ardhurat

⁷⁴ Sipas ligjit nr. 45/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, germa “d” e nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003 ka ndryshuar: “d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lek ose në valutë të huaj [...]”.

⁷⁵ Faqe 3 e deklaratës periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit për vitin 2012, depozituar më 20.03.2013.

⁷⁶ Shih vendimet (JR) nr. 11/2019, në pikën 27.12.18 të prg. 27; (JR) nr. 19/2019, në prg. 84; (JR) nr. 20/2019, në prg. 59 dhe (JR) nr. 29/2019, në prg. 31.

⁷⁷ Në analizën e kryer në Kolegji, kjo diferencë thellohet. Ndryshimi i balancës është pasojë e përlllogaritjes së kryer në Komision, sipas së cilës të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit janë përlllogaritur sikur martesa të kishte ndodhur në 1 janar 2007, dhe jo në prill 2007.

nga qiratë e përfituara nga ish-bashkëshorti, për periudhën deri në pagesën e tarifave përkatëse, e konkretisht: 350.000 lekë nga qiradhënia e pasurisë së paluajtshme të ndodhur në rr. “{***}”, për periudhën 5-mujore dhe 448.000 lekë nga dhënia me qira e pasurisë së ndodhur në rr. “{***}” për tetë muaj, janar – gusht 2015. Në kontratat e qiradhënies, sipas subjektit, është përcaktuar detyrimi i *qiramarrësit* për të likuiduar detyrimin tatimor të lindur nga kontrata e qirasë. Përveç kësaj, në të dyja kontratat e atij viti [2015], objektet e disponuara në qiradhënie, kanë pasur si qiramarrës subjekte tregtare të regjistruara si biznese në QKB, që nënkupton detyrimin e qiramarrësve për shkak të ligjit. Moszbatimi i detyrimit ligjor nga ana e qiramarrësve nuk mund të përbëjë mangësi apo mospërbushje të detyrimit ligjor nga ish- bashkëshorti, e kurrësi mospërbushje nga ana e saj. Në funksion të këtij shkak ankimi, subjekti kërkoi administrimin si provë të një shkresë, përcjellë asaj si përgjigje nga DPT më datë 25.02.2022, dhe të një raporti financiar të hartuar në datën 28.02.2022 nga eksperti kontabël I. C.⁷⁸, si dhe thirrjen e ekspertit për të dhënë mendim në seancë.

33.15. Në vijim të sa më sipër, me vendim të ndërmjetëm, trupi gjykues i Kolegjit vendosi të mos pranojë të thërrasë e pyesë z. I. C. në cilësinë e ekspertit, pasi çmtoi se kjo kërkesë nuk lejohet nga ligji, nën dritën e dispozitave të nenit 225 e në vijim të KPrC që rregullojnë thirrjen e ekspertit nga gjykata dhe kryerjen e ekspertimit, dhe të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 që përcakton refuzimin e marrjes së provës nga Kolegji, nëse nuk lejohet nga ligji. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje që ekspertiza e kryer nga z. C., në formë shkresore, gjendet e administruar në fashikull dhe, si e tillë, iu nënshtua analizës së trupit gjykues. Për qëllimet ndihmëse të vendimmarrjes, Kolegji mbështetet në shërbimet e specializuara të Njësisë së Shërbimit Ligjor.

Nga analiza e akteve në fashikull, trupi gjykues vëren që të ardhurat nga qiradhënia e pasurive të ndodhura në rrugën “{***}” dhe në rrugën “{***}”, nuk plotësojnë testin e ligjshmërisë së përcaktuar nga pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pika 11 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, pasi nga shkresa e dërguar subjektit nga DRT Tiranë⁷⁹, rezulton që personi i lidhur është regjistruar për Deklaratën Individuale Vjetore të të Ardhurave [DIVA] në datën 09.01.2018, me datë fillimi transaksioni retroaktiv, e konkretisht 01.01.2011. Me fjalë të tjera, detyrimet tatimore lidhur me të ardhurat e realizuara nga marrëdhëniet e qirasë për disa prej kontratave, janë deklaruar pranë organeve tatimore pas dorëzimit të deklaratës *vetting*. Shlyerja e detyrimeve në funksion të procesit të rivlerësimit dhe pas dorëzimit të deklaratës *vetting*, ka gjetur trajtim të konsoliduar në jurisprudencën e Kolegjit, ku është theksuar se për efekt të procesit të rivlerësimit, nuk do të merren në konsideratë pagesa e detyrimeve tatimore me vonesë, pas dorëzimit të deklaratës *vetting*⁸⁰. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se detyrimin për tatimin e kanë pasur qiramarrësit, nuk gjen zbatim pasi në kontratat e qirasë, qiramarrësi paraqitet si individ e jo si person juridik. Në këto kushte, edhe shkresa e DPT-së, sjellë në cilësinë e provës nga subjekti e që konsiston në interpretim të ligjit për detyrimin tatimor, nëse njëra nga palët është person juridik, nuk përbën risi dhe as mbështet pretendimet e subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, kjo e ardhur nuk u përllorarit në të

⁷⁸ Kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 25.02.2022, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe raporti financiar i datës 28.02.2022.

⁷⁹ Nr. {***} prot., datë 11.11.2019.

⁸⁰ Shih vendimet (JR) nr. 7/2019; (JR) nr. 8/2019; (JR) nr. 19/2019; (JR) nr. 5/2020.

ardhurat që kanë shërbyer për të kryer investimet dhe shpenzimet e subjektit dhe personit të lidhur në vitin 2015, duke ndikuar në analizën financiare të viteve përkatëse dhe mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet dhe investimet e kryera. Konkretisht, analiza financiare e kryer nga Komisioni dhe përcjellë subjektit të rivlerësimit me rezultatet e hetimit të dytë administrativ, rezultojnë me një balancë negative në momentin e kryerjes së pagesës së legalizimit prej (-) 108.762 lekësh, ndërsa rezultati negativ për gjithë periudhën 2008- 2016, është (-) 773.408 lekë. Nëse nga kjo përlllogaritje e Komisionit, përjashtojmë të ardhurat nga qiraja, për të cilat nuk provohet ligjshmëria, pa ndryshuar asnjë vlerë tjetër, do të rezultonte një balancë negative në momentin e kryerjes së pagesës së legalizimit prej (-) 377.470 lekësh, ndërsa rezultati negativ për gjithë periudhën pas martese, maj 2007- 2016 do të ishte (-) 2.243.720 lekë⁸¹. Në analizën e kryer në Kolegj, bazuar mbi sa është arsyetuar më sipër dhe në vijim, kjo diferencë thellohet dukshëm⁸².

33.16. Në përfundim, mungesa e burimeve të ligjshme për pagesën e vlerës së legalizimit në gusht të vitit 2015, e konstatuar nga Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ, u konfirmua edhe në analizën e kryer në Kolegj. Për pasojë, rezultojnë që pretendimi i Komisionit Publik është i bazuar. Subjekti dhe personi i lidhur rezultojnë me një balancë negative prej (-) 828.239 lekësh nga analiza e kryer në Kolegj për periudhën deri në datën e kryerjes së pagesës së legalizimit. Në këtë analizë, siç shtjellohet në paragrafin pararendës, nuk janë përlllogaritur të ardhurat nga qiratë, për të cilat është kryer pagesa e tatimit vetëm në vitin 2018, janë përlllogaritur shpenzime të dokumentuara për tatime e sigurime⁸³, të cilat nuk pasqyrohen në analizën e Komisionit, ndonëse kanë qenë pjesë e fashikujve dhe janë vlerësuar shpenzimet e udhëtimit sipas metodologjisë së përcaktuar nga Kolegji me vendimin nr. 11/2019.⁸⁴

33.17. Për sa i përket kredisë së marrë në vitin 2008, referuar ndër të tjera edhe në paragrafin 33.7. më sipër, Komisioneri Publik ka argumentuar se subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme për të shlyer këstet e kredisë në vite. Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit në lidhje me këtë aspekt të kontrollit të kriterit të pasurive, me rezultatet e hetimit të datës 16.10.2019. Sipas analizës së hartuar nga Komisioni, subjekti rezultonte me mungesë të ardhurash për likuidimin e kësaj kredie në secilin nga vitet. Po ashtu, siç është sjellë në vëmendje më sipër, në rezultatet e hetimit të datës 27.01.2021, Komisioni ka gjetur një balancë negative për *dy vite* [2008 dhe 2009], në vlerën në total prej (-) 773.408 lekësh⁸⁵, e cila nga analiza e ripunuar, është

⁸¹ Këto përlllogaritje u përkasin vetëm investimeve dhe shpenzimeve të kryera pas martese, pra nuk janë të përfshira vlerat negative që rezultojnë nga analiza e ish-bashkëshortit, para martese [ndërtimi në rrugën “{***}” etj.].

⁸² Sipas analizës së kryer në Kolegj, rezultati negativ në momentin e kryerjes së pagesës së legalizimit është (-) 828.239 lekë; rezultati negativ për gjithë vitin 2015 është (-) 924.850 lekë, ndërsa rezultati negativ për gjithë periudhën pas martese, maj 2007- 2016, është (-) 6.783.120 lekë.

⁸³ Pagesa faturash për tatime e sigurime për subjektin e rivlerësimit sipas konfirmës bankare dhe pagesa për Vodafone, në total 374.374 lekë.

⁸⁴ <https://kpa.al/wp-content/uploads/2019/07/E-Islamaj-vendim-i-anonimizuar-p%2c3%2cabr-web.pdf>. Sipas kësaj metodologjie, shpenzimet e udhëtimit në Kolegj përlllogariten në vlerën 229.172 lekë, përkundër 150.648 lekëve të përlllogaritura nga Komisioni.

⁸⁵ Për referencë, analiza financiare e përfshirë në rezultatet e hetimit administrativ të vitit 2021, faqe 51.

reduktuar në (-) 365.264 lekë⁸⁶. Kjo balancë negative rezulton edhe pasi Komisioni pranoi si të ligjshme të ardhurat nga qiratë e ambienteve [shtjelluar më sipër], për të cilat tatimi është paguar gjatë procesit të hetimit administrativ, si dhe duke përlllogaritur të ardhura të personit të lidhur, të cilat *nuk ishin deklaruar* në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe për të cilat as nuk ishte konfirmuar ligjshmëria.

33.18. Konkretisht, rezulton që në analizën e kryer për katër (4) vite, Komisioni ka pranuar pretendimin e subjektit për të ardhura shtesë, bazuar në kontrata të sjella nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të dytë të hetimit administrativ, për shërbime konsulence pranë një personi juridik. Këto të ardhura, në vlerën 5,6 milionë lekë, janë përpos atyre të deklaruara dhe të cilat janë konfirmuar nëpërmjet deklarimeve në organet e administratës tatimore. Kështu, ndërsa në deklaratën periodike të vitit 2007, subjekti ka deklaruar 1,2 milionë lekë, dhe nga administrata tatimore personi i lidhur rezulton *pa fitime* [vlerë fitimesh 0], Komisioni ka përlllogaritur të ardhura në vlerën 2,2 milionë lekë. Në vijim të kësaj qasjeje, në vitin 2011, Komisioni rezulton të ketë përlllogaritur **3,6** milionë lekë të ardhura, përkundër **1,9** milionë lekëve të deklaruara dhe *asnjë* fitim të konfirmuar nga kontrolli i kryqëzuar me administratën tatimore. Për vitin 2012, Komisioni ka përlllogaritur **3,8** milionë lekë kundrejt **2,16** milionë lekëve të deklaruara dhe fitime në vlerë **0 lekë** nga kontrolli i kryqëzuar me administratën tatimore. Së fundmi, në vitin 2013, Komisioni ka përlllogaritur **1,23** milionë lekë kundrejt **1,08** milionë lekëve të deklaruara, e për të cilat qarkullimi i deklaruar për qëllim të tatimit, ishte 1,08 milionë lekë, ndërsa fitimi i tatueshëm më i ulët, por i papërlllogaritur.

33.19. Në vijim të pretendimeve të Komisionerit dhe pas analizës së akteve në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se subjekti nuk arrin të zhbëjë sa është konstatuar në barrën e provës. Nga analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera ndër vite, përfshirë edhe shlyerjen e kësteve të kredisë së marrë më 31.01.2008, subjekti i rivlerësimit rezulton me një balancë negative, minimalisht në vlerën (-) 2.243.720 lekë. Nga ana tjetër, përlllogaritja e shtjelluar më sipër nga Komisioni, bazuar mbi dokumentacion të prodhuar në një fazë të avancuar të procesit të hetimit administrativ, në funksion për të përmirësuar situatën financiare nëpërmjet pretendimit të të ardhurave të padeklaruara më parë, dhe për të cilat nuk ka gjurmë në administratën tatimore, sipas ligjit, bie ndesh me përcaktimet e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit:

[4.] Komisioni dhe Kolegji i Apelimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...].

33.20. Në zbatim të kësaj dispozite, trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni duhej të kishte vlerësuar besueshmërinë e deklaratave periodike vjetore, të cilat përbëjnë provë, dhe të kryente përlllogaritjen e burimeve të ligjshme të konfirmuara në pajtueshmëri me sa referohet nga

⁸⁶ Për referencë, analiza financiare e kryer nga Komisioni, e emërtuar “Analiza_financiare_vendim”, pjesë e fashikujve.

administrata tatimore, në kontekstin e rrethanave në të cilat u ngritën pretendimet e subjektit për të ardhura të tjera, të padeklaruara dhe të papretenduara e konfirmuara më parë. Në analizën financiare të kryer në Kolegj, të ardhurat ndër vite, përfshirë edhe vitet në analizë, u përlogaritën sipas udhëzimit të shprehur të dispozitës së mësipërme. Sipas kësaj analize, rezultoi balanca negative ndër vite e referuar më sipër, për periudhën maj 2007 – dhjetor 2016, në vlerën (-) 6.783.120 lekë.

33.21. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të drejtë pretendimin e Komisionerit Publik, se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germa “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur gjenden në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për shlyerjen e kësteve të kredisë së marrë në vitin 2006, kredisë së marrë në vitin 2008 dhe pagesës së legalizimit të kryer në vitin 2015, për pasurinë e referuar më sipër, ndodhur në rrugën “{***}”.

*4. Pasuria e paluajtshme apartament me sipërfaqe 73 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë (në vijim “apartament 73 m²”)*

34. Komisioneri Publik vlerëson se deklarami i subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë pasuri, është i pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Komisioneri referon rekomandimin e ONM-së dhe ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni për këtë pasuri.

34.1. Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës në rezultatet e hetimit të datave 29.11.2019 dhe 27.01.2021, lidhur me:

- mungesën e *burimeve* për blerjen e këtij apartamenti (sipas kontratës së blerjes, kjo pasuri është blerë më 04.01.2008 dhe duket se të ardhurat e siguruara nga punësimi deri në atë datë, nuk kanë qenë të mjaftueshme për blerjen e pasurisë);
- *mosdeklarimin* në deklaramen të interesave privatë për vitin 2007 të kursimeve *cash*;
- *mospërputhjet* midis çmimit të blerjes së deklaruar në deklaramen *vetting*, në vlerën 500.000 lekë me vlerën 3.900.000 lekë, të deklaruar në deklaramen të interesave privatë për vitin 2008, si dhe me vlerën 146.000 euro (ose 18.000.000 lekë), bazuar në raportin e vlerësimit të datës 28.12.2007;
- *mospërputhjet mbi burimin e krijimit* të kësaj pasurie midis deklarames *vetting*, ku burimi deklarohet “nga punësimi” dhe deklarames së interesave privatë për vitin 2008, ku burimi deklarohet “kredi nga BKT”.

34.2. Në përfundim, Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka asnjë të drejtë reale mbi këtë pasuri, dhe as ka realizuar përfitime prej saj, nuk u konstatuan probleme dhe deklarimet janë të sakta, në përputhje me nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

34.3. Në konsideratë të pretendimeve të Komisionerit, konkluzioneve të Komisionit, pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve të administruara, nën dritën e dispozitave të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 33, pika 5, germa “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, siç shtjellohet në detaj në vijim, trupi gjykues i Kolegjit konkludoi që vlerësimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri, është i pabazuar në ligj dhe prova. Nga analiza e veprimeve juridike të kryera, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim në rrethanat konkrete, rezulton që shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, nuk ishin bindëse e parashtrimet e saj nuk arritën të zhbënin sa është konstatuar në barrën e provës.

34.4. Konkluzioni i mësipërm merr në konsideratë deklaratimet e subjektit ndër vite në deklaratën e pasurisë, në procesin e rivlerësimit, sikurse edhe aktet e administruara në fashikull. Një analizë e të gjitha këtyre aspekteve, duke nisur nga veprimet juridike të dokumentuara nga aktet në fashikull, parashtrohet në vijim.

- a. Më datë 28.12.1996, vëllai i personit të lidhur, z. A. B., ka blerë pasurinë [apartament me sipërfaqe 73 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë], në shumën 1.750.000 lekë.
- b. Në kontratën e regjimit të pasurive të ndara, të datës 27.03.2007, kjo pasuri është emërtuar njësi në “emër të A. B., në bashkëpronësi reale të të gjithë familjes” dhe e administruar me prokurën e datës 18.04.2005 nga A. B..
- c. Më datë 04.01.2008, me kontratë shitblerjeje, palët shitëse, z. A. dhe znj. S. B., i kanë shitur z. A. B. [personit të lidhur] apartamentin objekt analize, në çmimin 500.000 lekë.

34.5. Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e këtij apartamenti në datën 04.01.2008, duke e cilësuar transaksionin “për efekt dokumentesh”. Po ashtu, subjekti ka shpjeguar se shitësi, vëllai i bashkëshortit, vazhdon të ruajë pronësinë mbi këtë pasuri. Sipas kësaj deklarate, subjekti përcakton se apartamenti ka vlerën *39.000.000 lekë*⁸⁷, ndërsa nuk ka përshkrim të *pjesës takuese*. Në rubrikën që u përket detyrimeve financiare, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *kredinë* në shumën 100.000 euro nga BKT-ja [shtjelluar në detaj më sipër, në seksionet numër 2 dhe 3 të këtij arsytimi]. Sipas specifikimit, kredia ka shërbyer si burim edhe për blerjen e apartamentit tek “{***}”, përpos pasurisë në “{***}”, sipas deklaramit të bërë. Në deklaratë deklarohet e njëjta pasuri, në emër të personit të lidhur. Në deklaratë, subjekti dhe personi i lidhur nuk specifikojnë pjesë takuese.

34.6. Në ndryshim nga deklarata periodike, në deklaratën e pasurisë *vetting*, personi i lidhur ka deklaruar këtë pasuri në emër të tij, por në pronësi “*të përbashkët të familjarëve [...] A. B., etj.*”. Dy ndryshime të tjera në mënyrën e deklaramit në deklaratën e pasurisë konsistojnë në burimin e krijimit dhe vlerën e pasurisë. Konkretisht, ndërsa në deklaratën periodike vjetore burim është deklaruar *kredia* dhe vlera 39 milionë lekë [të vjetra], në deklaratën e pasurisë burim janë deklaruar *të ardhura nga veprimtaria e punësimit* dhe vlera 500.000 lekë. Pjesë takuese, deklarohet nga personi i lidhur si *bashkëpronësi*. Subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën *vetting*.

⁸⁷ Deklaruar në “lekë të vjetra”, mënyrë referencë e vlerave monetare sipas standardit të përdorur në jetën e përditshme.

34.7. Në përgjigje të barrës së provës⁸⁸, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar se personi i lidhur e ka blerë këtë pasuri nga i vëllai [z. A. B.], në vlerën *500.000 lekë*, për qëllim të kolateralit. Sipas të njëjtave shpjegime të subjektit, çmimi është likuiduar i shtrirë në kohë, “*për shkak të marrëdhënies së tyre*”. Ndërsa, në përgjigje të barrës së provës së kaluar për mospërputhjet e çmimit, subjekti ka parashtruar që blerja e pasurisë nevojitej ngutshëm, për efekt të marrjes së kredisë prej 100 mijë eurosh, në janar 2008. Po ashtu, subjekti ka shtjelluar faktet që konstatohen nga aktet e referuara më sipër në paragrafin 34.4/c, e konkretisht që akti i shitblerjes është përpiluar në janar 2008. Sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, praktika e marrjes së kredisë provon pretendimet e saj.

34.8. Në parashtrimet në Kolegj lidhur me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka ripohuar sa ka shpjeguar në hetimin administrativ për sa i përket qëllimit të blerjes së pasurisë, mënyrës së shlyerjes së detyrimit, meqenëse palët – personi i lidhur dhe vëllai – përpos lidhjes së posaçme, kanë trajtuar në mënyrë të përbashkët pasurinë e tyre, e cila është krijuar para lidhjes së martesës. Subjekti ka shtuar se regjimi i pasurive të ndara, zgjedhur prej saj dhe ish-bashkëshortit, ka pasur si qëllim primar që subjekti të mos ketë asnjë raport me pasuritë dhe as me të ardhurat e siguruara nga pasuria e ish-bashkëshortit dhe e familjarëve të tij. Në konkluzion, për këtë shkak ankimi, subjekti argumentoi që kërkimi i Komisionerit Publik nuk mund të passjellë një vlerësim të ndryshëm nga ai i Komisionit në kushtet, sipas saj, e mungesës së verifikimit me objektivitet të gjithë rrethanave. Në mbështetje të këtij konkluzioni, subjekti i rivlerësimit referon marrëdhëniet e posaçme që gjejnë zbatim në këtë rast, statusin juridik të pasurisë dhe mënyrën e administrimit të pasurive paramartesore. Përpos sa më sipër, në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka paraqitur në Kolegj katër (4) akte shkresore. Dy prej tyre janë deklarata noteriale [vërtetim nënshkrimi], të hartuara gjatë procesit të rivlerësimit⁸⁹, i treti është një prokurë e posaçme e vitit 2005⁹⁰. Së fundmi, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës kontratën e hipotekimit për efekt të kredisë [datë 29.01.2008], referuar gjerësisht më sipër, në paragrafët 32.8/b dhe 33.5/e.

34.9. Parë nën dritën e përcaktimeve të nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, aktet e sipërcituara u vlerësuan pa vlerë provuese, në kushtet kur nuk sjellin asnjë risi dhe referojnë fakte të provuara nëpërmjet akteve në fashikullin e përcjellë në Kolegj apo synojnë të provojnë në terma

⁸⁸ Përgjigje të rezultatit të hetimit të datës 27.01.2021.

⁸⁹ Deklaratë [vërtetim nënshkrimi] e ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, hartuar në datën 01.03.2022. Deklaruesi konfirmon parashtrimet e subjektit të rivlerësimit në hetimin administrativ dhe në parashtrimet në Kolegj, për sa i përket qëllimit të blerjes së apartamentit objekt analize, mënyrës së shlyerjes së pagesës së çmimit të shitjes “me dakordësi të plotë mes tyre përgjatë vitit 2008” dhe marrëdhënies së posaçme midis vëllezërve”. Deklarata tjetër [vërtetim nënshkrimi], nga z. A. B. – vëllai i ish-bashkëshortit të subjektit – deklaroi çfarë është konfirmuar dhe referuar gjerësisht në aktet shkresore të referuara ndër të tjera në paragrafët 32.8/c, 33.5/e dhe 34.1 në pikën e parë, lidhur me kontratën nëpërmjet së cilës ai i ka shitur vëllait pasurinë objekt analize, dhe konfirmon sa ka parashtruar subjekti i rivlerësimit në hetim dhe në Kolegj dhe sa ka deklaruar personi i lidhur me të në deklaratën e cituar në krye të këtij poshtëshënimi.

⁹⁰ Prokurë e posaçme e datës 18.04.2005, nëpërmjet të cilës z. A. B. emëron përfaqësues të posaçëm vëllanë e tij A. B., [personin e lidhur me subjektin e rivlerësimit], për apartamentin në rrugën “{***}” Tiranë.

deklarativë pretendime të subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, nëpërmjet parashtrimeve të saj gjatë procesit të gjykimit në Kolegj.

34.10. Komisioneri Publik argumenton se edhe pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me, së pari, me pamjaftueshmërinë e konstatuar për blerjen e kësaj pasurie më datë 04.01.2008, edhe në analizë të bazuar mbi vlerën e pasqyruar në kontratë. Subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur me të nuk kanë deklaruar kursime në *cash* në deklaratën periodike vjetore për vitin 2007, sikurse edhe në deklaratimet paraardhëse. Së dyti, kredia bankare nga BKT-ja, e deklaruar në deklaratën periodike vjetore për vitin 2008 si burim krijimi për këtë pasuri, rezulton e marrë pas blerjes së pasurisë, e konkretisht: pamjaftueshmëria financiare e konstatuar nga Komisioni, i referohet çmimit të blerjes të përcaktuar në kontratë, prej 500.000 lekësh, që është vlerë më e ulët sesa edhe çmimi i blerjes së kësaj pasurie 12 vite më parë – 1.750.000 lekë – apo vlerësimit të kryer nga Banka – ndodhur në dosjen e BKT-së, prej 146.000 eurosh.

34.11. Në konsideratë të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje, së pari, disa konstatime të natyrës kronologjike që rezultojnë të dokumentuara. Konkretisht, rezulton që pronësia mbi këtë pasuri është fituar *pas* lidhjes së martesës të subjektit të rivlerësimit me personin e lidhur. Po ashtu, kredia bankare nga BKT-ja, e deklaruar si burim krijimi në vitin 2008, është marrë *pasi* apartamenti objekt analize ishte blerë nëpërmjet kontratës së shitjes e, për pasojë, nuk mund të shërbente si burim krijimi i apartamentit. Konkretisht, apartamenti është blerë në datën 04.01.2008, ndërsa kredia është lëvruar në datën 31.01.2008. Përpos këtyre dy mospërputhjeve kronologjike, Kolegji vëren që subjekti ka qenë kontradiktor në specifikimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie ndër vite. Konkretisht, ndërsa në deklaratën periodike vjetore për vitin 2008 është deklaruar kredia si burim krijimi i pasurisë, në deklaratën e pasurisë *vetting*, personi i lidhur ka deklaruar *të ardhurat nga veprimtaria e punësimit* si burim për krijimin e kësaj pasurie. Për sa më sipër dhe në kushtet kur subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur nuk kanë deklaruar kursime në *cash* në deklaratën e interesave private për vitin 2007, çka mund të justifikonte disponimin e fondeve të mëhershme për të mundësuar blerjen e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me pamjaftueshmëri financiare për të blerë këtë pasuri, edhe nëse përlllogaritja bazohet në çmimin e përcaktuar në kontratë, prej 500.000 lekësh. Për pasojë, pretendimi i Komisionerit për këtë shkak ankimi, referuar më sipër, është i bazuar në tërësinë e tij, përfshirë edhe mospërputhjen mes çmimit të blerjes së kësaj pasurie 12 vite më parë [1.750.000 lekë] apo vlerësimin e bankës – sipas të cilit pasuria është vlerësuar me një vlerë dhjetëra herë më të lartë [146.000 euro] se ajo e shitjes, prej 500 mijë lekësh.

34.12. Në të kundërt me vlerësimin e Komisionit se subjekti nuk ka asnjë të drejtë reale dhe as ka realizuar përfitime prej kësaj pasurie, Kolegji vlerësoi se ai është i pabazuar pasi bie ndesh haptazi me deklaratimet ndër vite të subjektit të rivlerësimit – të cilat përbëjnë provë sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 – dhe rezulton një pasqyrë e pretendimeve të subjektit në hetimin e dytë administrativ të kryer nga Komisioni. Konkretisht, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *të ardhurat* nga qiradhënia e kësaj pasurie në katër deklaratata periodike:

- a. në deklaratën e interesave private të vitit 2007, ka deklaruar të ardhura të bashkëshortit në vlerën 1,6 milionë lekë [të vjetra] nga një banesë [e të vëllait];
- b. në deklaratat e interesave private 2009 dhe 2015, ka deklaruar të ardhura në vlerën 960.000 lekë për secilin vit;
- c. në deklaratën e interesave private të vitit 2016, ka deklaruar të ardhura në vlerën 960.000 lekë dhe 160.000 lekë.

34.13. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se pretendimi i Komisionerit Publik është i drejtë. Nëpërmjet deklaramëve kontradiktore për çmimin ekzakt të pasurisë dhe burimin e krijimit, subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, nuk ka përmbushur detyrimin e saj për deklarim të plotë e të saktë, duke mos mundësuar kontrollin e kësaj pasurie dhe arritjes së një përfundimi lidhur me mundësinë e krijimit të kësaj pasurie me burime të ligjshme. Për të gjitha këto arsye, Kolegji arrin në konkluzionin se për pasurinë e paluajtshme objekt analize [apartament me sipërfaqe 73 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë], subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur gjenden në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, edhe sipas analizës së bazuar mbi çmimin e kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie. Nëse analiza do të bazohej në çmimin e referuar në deklarimin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e interesave periodikë/vjetorë për vitin 2008 apo aktet e tjera në fashikull, kjo mungesë burimesh do të thellohej edhe më tej.

5. *Pasuria e paluajtshme godinë banimi 5-katëshe, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë*

35. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit për bashkëpronësi *faktike* të personit të lidhur me vëllezërit, është i pabazuar në dispozitat ligjore që rregullojnë pronësinë. Më tej, subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë burime të ligjshme financiare të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie. Të ardhurat nga qiraja e ambientit në rrugën “{***}”, për vitet 2005 – 2007, nuk mund të konsiderohen të ligjshme nën dritën e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

35.1. Me rezultatet e hetimit të datës 16.10.2019, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi:

- nuk provohet me dokumentacion ligjor ndërtimi i banesës *në vitin 2006*;
- nuk provohet me dokumentacion ligjor *kostoja* e ndërtimit të kësaj pasurie (godinë banimi 5-katëshe) në shumën 4.000.000 lekë;
- bazuar në kostot e ndërtimit të përcaktuara nga EKB-ja, personi i lidhur A. B. *nuk ka pasur mundësi* të krijojë pasuritë e krijuara para martesë për një diferencë negative në vlerën – 20.576.598 lekë.

35.2. Me rezultatet e hetimit të datës 27.1.2021, pasi ka konsideruar si investim të personit të lidhur për ndërtimin e katit të tretë të godinës 5-katëshe vetëm shumën prej 4.000.000 lekësh, Komisioni

konstatoi se personi i lidhur gjendet në kushtet e pamjaftueshmërisë financiare në shumën (–) 5.510.528 lekë, për të mbuluar investimet e kryera deri në prill 2007. Sa i përket gjendjes në të cilën ishte ndërtesa e lënë kolateral për efekt të kredisë, subjekti thekson se banesa është ndërtuar dhe përfunduar në vitin 2006, para martesës, gjithë aktet dokumentare dëshmojnë këtë pretendim, sipas tij. Po ashtu, subjekti ka argumentuar se në aplikimin për dhënien e kredisë në vitin 2006, është vendosur kolateral trualli ku është ndërtuar banesa 5-katëshe dhe jo vetë kjo ndërtesë.

35.3. Në përfundim, Komisioni ka konkluduar se i gjeti të sakta deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe nuk konstatoi problematika për këtë pasuri në lidhje me nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Burim krijimi i kësaj pasurie, kanë qenë të ardhurat në vite të personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe të të afërmeve të tij. Problematikat me pasurinë i atribuohen vetëm personit të lidhur, ndërsa pasuria është krijuar përpara martesës, sipas Komisionit, në konkluzion. Subjekti nuk ka pasur “raport” me katin e tretë ku ka banuar në këtë pasuri. Deklarimi i pasurive sipas ndarjes në kate në pronësinë “reale” nga personi i lidhur në deklaratën e pasurisë *vetting*, përjashton subjektin nga çdo përgjegjësi për këtë pasuri.

35.4. Në parashtrimet e paraqitura si dhe gjatë seancave publike në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, pretendoi se Komisioni ka kryer gjithë hetimet e nevojshme për sa i përket *momentit* të krijimit të pasurisë, ajo ka sjellë prova për origjinën e krijimit të pronës, sikurse vetëdeklarimi për legalizim të vitit 2006, kontratat e furnizimit me energji elektrike, aktin e kolaudimit të ndërtesës dhe akte të tjera. Pretendimet e Komisionerit Publik i referohen një fotografimi nga lartësia, ndërsa pretendimet e saj bazohen në disa akte zyrtare, jo vetëm mbi deklaratat e individëve. Banesa është ndërtuar dhe *përfunduar* në vitin 2006. Hetimi i Komisionit ka konfirmuar që banesa prej 5 katesh u përkiste *pronarëve të ndryshëm*, një prej të cilëve edhe personi i lidhur, si pronar i katit të tretë. Ky fakt provohet nga përshkrimi i kësaj pasurie në kontratën e regjimit pasuror⁹¹, kontratën e vitit 2006 për shitblerjen e truallit, si dhe “*dokumentacionin tjetër teknik të kësaj pasurie*”. Këto akte, sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, dëshmojnë ndërtimin e plotë të ndërtesës para lidhjes së martesës dhe pronësinë faktike të ndërtesës ndërmjet vëllezërve. Të ardhurat e përdorura si *burim* për krijimin e pasurisë, janë të dokumentuara dhe të ligjshme, dhe rrjedhin nga punësimi dhe dhënia me qira e pasurive të personit të lidhur. Subjekti argumenton se sa më sipër, provon se ajo vetë nuk ka ndikuar në krijimin apo posedimin e kësaj banese. Sipas saj, shkak i ankimit të Komisionerit Publik nuk është i bazuar dhe, për pasojë, nuk mund të sjellë një vlerësim të ndryshëm nga ai i Komisionit në vendimin objekt shqyrtimi.

35.5. Në mbështetje të pretendimeve të sipërcituara, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar që Kolegji të marrë në konsideratë gjithë aktet shkresore në fashikullin e hetimit administrativ, sikurse ka paraqitur edhe katër (4) akte të tjera: (i) vetëdeklarimin për legalizim të vitit 2006; (ii) kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë; (iii) aktin e kolaudimit të ndërtesës 5-katëshe; dhe (iv) aktin e ekspertimit/raport financiar, përpiluar nga I. C.. Ky akt i fundit është pjesë e kërimit tërësor

⁹¹ *Detajuar më sipër, ndër të tjera, në pjesën e numërtuar 1 në këtë vendim.*

për kriterin e pasurisë. Analiza ligjore e këtyre akteve është pjesë e arsyetimit në vijim. Sa i përket kërkesës për marrjen në konsideratë të akteve në fashikujt e hetimit administrativ në Komision, kërkesa është e panevojshme pasi shqyrtimi në Kolegj mbështetet kryesisht mbi to.

35.6. Në konsideratë të pretendimeve të Komisionerit, konkluzioneve të Komisionit, pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve të administruara, nën dritën e dispozitave të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 33, pika 5, germa “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, siç shtjellohet në detaj në vijim, trupi gjykues i Kolegjit konkludoi që vlerësimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri është i pabazuar në ligj dhe në prova. Nga analiza e veprimeve juridike të kryera, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim në rrethanat konkrete, rezulton që shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk ishin bindëse e parashtrimet e tij nuk arritën të zhbënin sa është konstatuar në barrën e provës.

35.7. Konkluzioni i mësipërm merr në konsideratë deklaratimet e subjektit ndër vite, në deklaratën e pasurisë, në procesin e rivlerësimit, sikurse edhe aktet e administruara në fashikull. Një analizë e të gjitha këtyre aspekteve, duke nisur nga veprimet juridike të dokumentuara nga aktet në fashikull, parashtrohet në vijim.

- a. Më datë 19.04.2006, personi i lidhur, z. A. B., ka fituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes, truallin me sipërfaqe 332 m², për çmimin 3.300.000 lekë.
- b. Me vetëdeklarimin e datës 08.08.2006, personi i lidhur ka nisur procesin e legalizimit të objektit “shtëpi banimi”. Koha e ndërtimit, sipas vetëdeklarimit, është 03.03.2006, nr. i kateve: 5⁹².
- c. Vlera e investimit, sipas formularit të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë [datë 12.11.2010], është llogaritur në total 22.349.070 lekë, ndërsa vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë në shumën 111.745 lekë. Kjo vlerë është paguar nga z. A. B., po në nëntor 2010.
- d. Në datën 28.01.2011, personi i lidhur ka deklaruar [për qëllim të legalizimit] që godina e banimit është ndërtuar në parcelën në pronësi të tij, me sip. 332 m². Personi i lidhur po ashtu deklaroi që *“është njohur dhe ka kryer të gjitha pagesat e detyrueshme për efekt legalizimi, ka shlyer të gjitha detyrimet, është në dijeni të matjeve të kryera në terren”* [nga ALUIZNI Tiranë] dhe shpreh dakordësinë.
- e. Më datë 29.03.2011, është lëshuar leja e legalizimit në emër të personit të lidhur për ndërtesën objekt analize.
- f. Më datë 27.09.2011, janë lëshuar 5 (pesë) certifikata për vërtetim pronësie për pasurinë, me numërtimet përkatëse, në emër të personit të lidhur.
- g. Me kontratat e dhurimit të datës 08.02.2017 – gjashtë vite pas legalizimit dhe një muaj pas deklaratës së pasurisë së rivlerësimit – personi i lidhur u ka dhuruar nënës dhe vëllezërve të

⁹² Në vetëdeklarim specifikohet që godina është ndërtuar në truallin me sipërfaqe 332 m², blerë nga personi i lidhur në datën 19.04.2006 dhe regjistruar në emër të tij, mbi bazën e certifikatës për vërtetim pronësie.

tij, apartamentet e ndodhura në katër nga pesë katet e godinës objekt shqyrtimi, legalizuar në vitin 2011.

35.8. Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2007, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri *në pjesë takuese 50%, në pronësi të bashkëshortit, kati i tretë, në vlerën 40 milionë lekë [të vjetra]*. Në të njëjtën deklaratë në emër të personit të lidhur, deklarohen të njëjtat të dhëna dhe specifikime në lidhje me to. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka deklarim vetëm nga personi i lidhur. Aty specifikohet vendndodhja e pasurisë [në rr. “{***}”, Tiranë], përbërja prej 5 katesh, si dhe që kati i tretë *është regjistruar* dhe është në pronësi e *përdorim* të personit të lidhur. *Burim* krijimi deklarohen të ardhurat e personit të lidhur dhe të familjarëve të tij ndër vite. Vlera është ndarë në vlerën e truallit prej 3.300.000 lekësh, atë të ndërtimit prej 4.000.000 lekësh “për pesë kate”, në vlerën për legalizim prej 127.745 lekësh (për pesë kate). Pjesa takuese deklarohet 100%. Në rubrikën e deklarimit të pasurive, personi i lidhur ka deklaruar katet përkatëse duke specifikuar që janë regjistruar në emër të tij [deklaruesit], por “*në pronësi*” individuale të tre vëllezërve, njëri prej të cilëve [A. B.] edhe jeton në katin përkatës.

35.9. Në përgjigje të barrës së provës, më datë 29.11.2019 dhe 24.02.2021, subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, ka argumentuar se formulari i vetëdeklarimit për legalizim [datë 08.08.2006, cituar në paragrafin 35.7/b] provon që ndërtesa është ndërtuar në vitin 2006, dhe që gjithë *financimi* është realizuar përpara lidhjes së martesës prej saj, më datë 26.4.2007. *Kostoja e ndërtimit* të katit ku ajo jeton, përputhet me koston e ndërtimit sipas standardit të përdorur nga Enti Kombëtar i Banesave [EKB]. Shtëpia përbën pasuri të krijuar para martesë, është në emër të bashkëshortit të saj, dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka asnjë detyrim për të justifikuar *burimin* e krijimit të saj. Lidhur me balancën negative prej (-) 5.510.528 lekësh, që tregon *pamjaftueshmëri* financiare të personit të lidhur për të financuar investimet e kryera deri në prill 2007, subjekti ka argumentuar se nga hetimi që ka kryer “në rang moral më shumë se në rang ligjor”, ish-bashkëshorti ka përfituar 7.635.600 lekë të ardhura të ligjshme nga pagat për periudhën 2004 – prill 2007. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, thekson se detyrimi i saj qëndron vetëm për këtë banesë, të cilën e ka përdorur si derivat i martesës, e për të cilën ish-bashkëshorti ka pasur mundësi dukshëm për ta krijuar në vitin 2006. Për pasuritë e personit të lidhur të krijuara para martesë [prill 2007], subjekti ka kërkuar që në analizën financiare të përfshihen në burimet e ligjshme edhe (i) të ardhurat nga qiraja e pasurisë apartament me sip. 73 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, për periudhën 2005 - prill 2007, në shumën 1.360.000 lekë; si dhe (ii) shumat e dërguara nga vëllai i personit të lidhur në vitin 2006, në shumën totale 5.313.509 lekë.

35.10. Për sa rezulton nga të dhënat e sipërcituara, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për bashkëpronësi “faktike” të personit të lidhur me vëllezërit e tij, është një koncept që nuk mbështetet në normat ligjore që rregullojnë pronësinë, në Kodin Civil. Shpjegimi i subjektit të rivlerësimit se pasuria e regjistruar në emër të personit të lidhur është “*në pronësi të vëllezërve*”, nuk gjen mbështetje në ligj. Sipas Kodit Civil, pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të përcaktuara në atë kod apo në mënyra të tjera të caktuara me ligj të veçantë. Asnjë

nga mënyrat e parashikuara nga Kodi Civil për fitimin e pronësisë së paluajtshme, nuk rezulton të përfshijë pronësi “faktike”⁹³.

35.11. Po kështu, nga aktet e sipërcituara që datojnë në periudhën kohore mes 2006 – 2011, rezulton se personi i lidhur vetidentifikohet si pronar i vetëm i truallit dhe objektit 5-katësh të ndërtuar mbi të. Konkretisht, rezulton se qoftë truall, qoftë ndërtimi mbi të, përfshirë edhe në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*, kanë qenë pronë e personit të lidhur. Truallit që përbën pjesë të kësaj pasurie, ashtu si edhe objekti “në ndërtim” në datën 09.10.2006⁹⁴, do të vendoseshin në favor të bankës si garanci pasurore për kredinë e kërkuar nga subjekti i rivlerësimit, “për ndërtimin e një shtëpie⁹⁵”, përreth 6 muaj përpara lidhjes së martesës ligjore. Me fjalë të tjera, dhe në vijim të sa është shtjelluar më sipër në shkaku e ankimit që lidhet me kreditë, personi i lidhur ka referuar në 9 tetor 2006 se ndërtesa objekt i këtij shkaku ankimi, ishte e papërfunduar, ndërsa subjekti aplikonte për një kredi për ndërtim shtëpie. Fakti që ndërtimi ishte i papërfunduar në vitin 2006, përkon edhe me aktet e përcjella nga ALUIZNI⁹⁶. Në ato akte, të cilat përfshijnë edhe fotografi të objektit, në kohën e aplikimit për kredi nga subjekti i rivlerësimit, godina në fjalë është e papërfunduar. Ajo rezulton në gjendje karabina, e mbyllur me tulla dhe e pabanueshme. Së fundmi, pretendimi i subjektit se shtëpia ishte e përfunduar përpara martesës apo që ajo ka filluar të banojë atje sapo është martuar, nuk është pasqyruar në deklaratën periodike vjetore të kohës. Konkretisht, në deklaratën e interesave privatë për vitin 2007, dorëzuar më 30 mars 2008, subjekti ka deklaruar se banon në apartamentin në rrugën “{***}”, Tiranë [pasuria e numërtuar 4, më sipër]. Në kushtet kur pasuria objekt analize është deklaruar për herë të parë si adresë banimi vetëm duke filluar nga viti 2009⁹⁷, parë edhe nga ky këndvështrim, pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, se ndërtesa ishte e përfunduar përpara prillit 2007 kur ajo lidhi martesë, janë jobindëse. Akti i kolaudit i referuar nga subjekti si provë për këtë pretendim të saj, nuk ka asnjë peshë provuese në kushtet kur është pa datë dhe referon fakte të cilat nuk janë kontestuar – që *projekti* mban datën 15.04.2006.

35.12. Referuar rezultatit të analizës financiare të kryer në Komision, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës lidhur me burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë objekt analize. Nga ana tjetër, edhe nëse merret në konsideratë pretendimi i subjektit të rivlerësimit që mundësia financiare e burimeve të ligjshme duhet të analizohet duke u kufizuar vetëm në

⁹³ Sipas neneve 162 e në vijim, deri në nenin 192 të Kodit Civil, pronësia mbi pasuritë e paluajtshme fitohet me kontratë, me trashëgim, nëpërmjet parashkrimit fitues, me bashkim e përzierje, me përpunim, me anë pushtimi dhe me anë shpronësimi.

⁹⁴ Cituar në paragrafin 33.5/b më sipër. Sipas kontratës, kredimarrësi dhe dorëzanësi garantojnë se me marrjen e titullit të pronësisë për objektin në ndërtim mbi truallin prej 332 m², do të bëhet bllokimi në favor të BKT-së, brenda shtatorit 2007. Kontrata parashikon edhe penalitete në rast vonese. Kontrata e hipotekimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.10.2006. Ndër të tjera, në kontratë parashikohet: “[...] Kredimarrësi dhe dorëzanësi garantojnë se me regjistrimin dhe marrjen e titullit të pronësisë për objektin i cili po ndërtohet mbi truallin e specifikuar në pikën 2.1: a) do të bëjnë bllokimin në favor të BKT, dega Stacioni i Trenit, brenda shtatorit 2007 [...]”.

⁹⁵ Shtjelluar në detaj në pjesën e arsytimit të numërtuar 3.

⁹⁶ Me shkresën nr. {***} prot., datë 30.10.2018.

⁹⁷ Datë deklarimi 25.03.2009, faqe 2 e formularit të deklaratës periodike vjetore për vitin 2008.

shpenzimet e kryera për një kat të banesës 5-katëshe, personi i lidhur rezulton me pamjaftueshmëri financiare për mbulimin me burime të ligjshme të pasurive të krijuara deri në prill 2007, minimalisht në vlerën e konstatuar nga Komisioni, prej (-) 5.510.528 lekësh⁹⁸. Nëse në analizë përfshihen vlerat e dërguara nga ish-kunati, si kontribute për ndërtimin – sipas kërkesës së subjektit të rivlerësimit – në analizë do duhet të përfshihen edhe shpenzimet e kryera prej tij për pjesën takuese të investimit [konkretisht 2 kate, nga 4.000.000 lekë secili]. Si rrjedhojë e zbatimit të kësaj logjike, duke pranuar dërgesat e vëllait të personit të lidhur, dhe zbritur ato nga shuma e investimit që pretendohet të jetë kryer prej tij [8 milionë lekë], sërish subjekti dhe personi i lidhur rezultojnë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve pasi vlera e investimit që i përket z. A. B., është më e lartë se vlera e dërgesave prej tij⁹⁹.

35.13. Në këtë analizë, trupi gjykues i Kolegjit thekson se përfshirja e të ardhurave nga qiraja e ambientit të ndodhur në rrugën “{***}” për vitet 2005 - prill 2007, kërkuar nga subjekti i rivlerësimit, u vlerësua se do të ishte e pabazuar në fakte dhe në ligj. Aktet në fashikull dëshmojnë që pasuria që ka gjeneruar të ardhura nga qiraja, nuk ka qenë në pronësi të personit të lidhur, ish-bashkëshortit. Kjo pasuri ka qenë në pronësi të vëllait të tij [z. A. B.]. Prokura e posaçme e lëshuar prej këtij të fundit më datë 18.04.2005¹⁰⁰, është një prokurë e zakonshme në të cilën porositësi/i përfaqësuar i jep tagra standarde përfaqësimi të porositurit në çdo veprim juridik që lidhet me këtë pronë. Në asnjë pjesë të prokurës nuk rezulton që i porosituri – personi i lidhur – të ketë tagra të përfitimit dhe gëzimit të lirë të të ardhurave që burojnë nga këto veprime juridike, përfshirë edhe qiradhënien. Përkundrazi, porositësi, ndër të tjera, ka përcaktuar që përfaqësuesi duhet të veprojë “duke mbrojtur me nder e dinjitet interesat e mia në lidhje me këtë pronë” dhe në realizimin e të drejtave të pronësisë që janë rrjedhojë e qenies së tij “pronar i ligjshëm i apartamentit, me adresë në rrugën “{***}”, Tiranë. Quartazi, nga përmbajtja e prokurës, nuk rezulton që porositësi të ketë hequr dorë nga interesat e tij. Në këto kushte, pretendimi i subjektit se personi i lidhur ka disponuar lirisht të ardhurat nga qiraja e ambientit në pronësi të të përfaqësuarit prej tij, është i papranueshëm nën dritën edhe të parimeve bazike ligjore të përfaqësimit me prokurë. Edhe parë në të kundërtën, nëse personi i lidhur dhe vëllai kishin mes tyre një dakordësi sipas së cilës i pari kishte liri të pakufizuar të gëzonte përfitimet pasurore që i takonin të dytit, kjo qasje e pakufizuar, e barabartë në efekt me një dhurim të pakushtëzuar dhe të pakufizuar në kohë, nuk rezulton nga prokura, sikurse edhe kjo e fundit, teorikisht mund të mos jetë mjeti juridik më efikas për të realizuar dhurimin e të ardhurave. Për këto arsye, pretendimi për të përllogaritur të ardhura nga qiraja e një

⁹⁸Shih paragrafin 35.2 më sipër, me rezultatet e hetimit të datës 27.1.2021, (-) 5.510.528 lekë për të mbuluar investimet e kryera deri në prill 2007.

⁹⁹ Transferta bankare, të cilat subjekti i rivlerësimit pretendon se janë dërguar nga z. A. B. në adresë të personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit, shkojnë në shumën 28.776 GBP ose 5,3 milionë lekë [afërsisht]. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar, transferata të dërguara personalisht nga A. B. apo nëpërmjet kompanisë së tij private, janë vetëm disa, në vlerën totale prej 12.948,71 GBP apo në ekuivalenten prej 2.338.002 lekësh. Veprimet e tjera [në total prej rreth 16.000 GBP] janë transferata të mbërritura në llogarinë e ish-bashkëshortit nga persona të tretë, të cilët, sipas subjektit të rivlerësimit, i kanë kryer transfertat për llogari të z. A. B..

¹⁰⁰ Referuar dhe cituar më sipër në paragrafin 34.4/b dhe poshtëshënimin nr. 90.

prone në kushtet e mungesës së titullit të pronësisë, është i pabazuar në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe, si i tillë, nuk u pranua nga trupi gjykues i Kolegjit¹⁰¹.

35.14. Përpos sa më sipër, trupi gjykues vëren se sipas përgjigjes nga organet tatimore¹⁰², rezulton se të ardhurat janë deklaruar nga personi i lidhur në DIVA, me datë regjistrimi në 09.01.2018, çka provon që përmbushja e detyrimeve tatimore lidhur me të ardhurat e realizuara nga marrëdhënia e qirasë, ka ndodhur pas dorëzimit të deklaratës *vetting*. Bazuar edhe në jurisprudencën e konsoliduar tashmë të Kolegjit, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, këto të ardhura nuk kalojnë testin e ligjshmërisë e, për pasojë, nuk mund të përfshihen në të ardhurat e përlllogaritura.

35.15. Për sa më sipër, për pasurinë e paluajtshme “*Godinë banimi 5-katëshe, ndodhur në rrugën “{***}”*”, e cila nga provat e administruara, rezulton të jetë përfunduar pas lidhjes së martesës, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur gjenden në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, minimalisht për katin të cilin ata kanë deklaruar si banesë në deklaratën e pasurisë *vetting*, Kolegji arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dështoi të përmbushë barrën e provës për të vërtetuar se personi i lidhur kishte mundësi financiare për të mbuluar me të ardhura të ligjshme investimin e kryer për këtë pasuri në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i gjen të bazuara shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik dhe vëren se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm e, për pasojë, gjen zbatim neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

B. Lidhur me vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës

- 36.** Komisioneri Publik, referuar edhe përmbajtjes së rekomandimit dhe shtesës së tij, konstaton se arsyetimi i Komisionit nuk përmban shpjegime për arsyet e refuzimit të gjetjes, sikurse urdhëron neni 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016. Komisioni nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për verifikimin e rrethanave objektive që ishin pasqyruar në gjetjen e ONM-së. Gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar konsiderohen në cilësinë e provës që dëshmon faktin, rrethanën apo standardin ligjor të parashtruar në të dhe, si të tilla, ato duhet të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit, dhe eventualisht të ballafaqohen me pretendimet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, përfshirë dhe sa është parashtruar në shtesën e rekomandimit të paraqitur nga Komisioni, prej 3 vëzhguesish ndërkombëtarë, duke mbajtur në konsideratë po ashtu edhe marrëdhëniet e interesit financiar të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, në kushtet e të ardhurave të siguruara nga ana e vëllait të personit të lidhur, në krijimin e pasurive të deklaruara për efekt të procesit të rivlerësimit.

¹⁰¹ Shih edhe vendimin e Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit Xhezair Zaganjori [JR nr. 19/2019], https://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-Zh_Zaganjori-i-anonimizuar-perfshire-mendimin-paralel.pdf.

¹⁰² Shkresat e DRT-së, datë 18.02.2021, datë 11.11.2019, të depozituara nga subjekti gjatë hetimit administrativ.

36.1. Në parashtrimet e tij në Kolegj, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit, Komisioneri Publik risolli në vëmendje të Kolegjit tri çështjet që lidhen me elementin rivlerësues të kontrollit të figurës të subjektit të rivlerësimit, të cilat gjejnë trajtim në dy gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, e konkretisht, në atë të datës 08.10.2020 [nr. 796 prot.] dhe të datës 21.10.2020 [nr. 850 prot.], të paraqitura dhe të administruara nga Komisioni, si dhe në shtesën (*addendum*) e rekomandimit të datës 29.06.2021, paraqitur në Institucionin e Komisionerëve Publikë.

36.2. Në mënyrë të përmbledhur, në dy gjetjet e sipërcituara edhe në shtesën e rekomandimit, vëzhguesi ndërkombëtar, në funksion të së drejtës së garantuar nga neni B, pika 3, germa “b” e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016, parashtron fakte që lidhen me dënimin penal në ngarkim të personit të lidhur dhe vëllait në Itali dhe efektit që kanë këto të dhëna në perceptimin e publikut për subjektin e rivlerësimit dhe në analizën që duhej të kryente Komisioni në funksion të qëllimit të procesit të rivlerësimit, përcaktuar nga neni 179/b i Kushtetutës. Konkretisht, dy gjetjet parashtrjnë sa vijon.

- a. Në gjetjen me datë 08.10.2020, ONM-ja parashtron një vendim të Dhomës Penale të Gjykatës së Distriktit Romë (Itali), të datës 19.12.2002. Sipas vëzhguesit, ky informacion është absolutisht relevant në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit dhe duhet të bëhet pjesë e dosjes së çështjes. Nëpërmjet tij, rezulton të jenë dënuar: *B. A. [...] dhe B. A. (ish-kunati i subjektit të rivlerësimit, vëlla i ish-bashkëshortit dhe që jeton në të njëjtën godinë me subjektin e rivlerësimit). [...] dy personat e lartpërmendur janë dënuar me 8 vjet burgim dhe një gjobë prej 55.000 eurosh për përfshirjen e tyre në trafikimin e qenieve njerëzore dhe prostitucion.*
- b. Në vijim dhe në konsideratë të gjetjes së referuar më sipër, më datë 21.10.2020, ONM-ja ka parashtruar: *[...] në dritën e standardeve ndërkombëtare [...] dhe provave në dispozicion, subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar sipas kuptimit të nenit Dh, paragrafi 3 i Aneksit të Kushtetutës. Gjetja sjell në vëmendje që padijenja për përfshirjen e personave në krimin e organizuar, nëse provohet nga subjekti i rivlerësimit, përbën vetëm një rrethanë lehtësuese sipas nenit 38, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Po ashtu, duke pasur parasysh objektivin e procesit të rivlerësimit, për shkak të vazhdimësisë në dukje të kontakteve [...] kjo situatë nuk mund të çlirojë Komisionin e Pavarur të Kualifikimit nga detyrimi i tij për ta konsideruar negativisht këtë sjellje nga pikëpamja e etikës, në dritën e standardeve ndërkombëtare të gjithëpranuara të etikës. Në rastin më të fundit, aplikimi korrekt i standardeve ligjore të përmendura në këtë dokument, duhet të çojë KPK-në për t’iu referuar nenit 61, paragrafi 5 i ligjit të vettingut dhe të vendosë për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj [...].*

36.3. Më datë 04.02.2022, ndërsa çështja ishte në proces përgatitjeje në Kolegj, ONM-ja ka depozituar një gjetje të tretë që lidhet me kontrollin e kriterit të figurës dhe vlerësimin e përgjithshëm. Në gjetje parashtrohet që dënimi penal në Itali, në ngarkim të A. B., ish-kunatit të subjektit të rivlerësimit, paraqet rëndësi jo vetëm për komponentin e vlerësimit të figurës së saj,

por edhe në funksion të vlerësimit të pasurisë. Konkretisht, gjetja fokusohet në faktin që ndërtesa ku subjekti i rivlerësimit jeton nga viti 2007 e aktualisht, është fryt edhe i kontributit financiar të A. B.. Ky fakt rezulton edhe nga marrëveshja e dhurimit që ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka lidhur me vëllanë e tij, A. B., datë 28.01.2017. Në përmbajtjen e marrëveshjes së dhurimit, me objekt katin e dytë, z. A. B. deklaron se shtëpia është ndërtuar edhe me të ardhurat e realizuara nga A. B.. Në këto kushte, dedukton gjetja, meqenëse A. B. është i dënuar për veprat penale të fushës së krimit të organizuar në vitin 2002, është logjike të konkludohet se A. B. ka realizuar të ardhura të paligjshme si anëtar i një grupi të strukturuar kriminal, dhe se këto të ardhura të fituara në mënyrë të paligjshme i ka investuar në ndërtimin e shtëpisë në të cilën jeton edhe sot Elizabeta Imeraj. Komisioni e ka pranuar të besueshëm shpjegimin se edhe A. B. ka investuar në ndërtimin e banesës familjare të sipërpërmendur, ndonëse nuk ka kryer *asnjë* analizë financiare për të përcaktuar saktësisht vlerën e investimit të kontribuar nga A. B. në ndërtimin e kësaj shtëpie, sikurse nuk ka kryer një analizë financiare për të konfirmuar ligjshmërinë e këtyre të ardhurave.

36.4. Gjetja specifikon në detaj faktet mbi të cilat bazohet konkluzioni për identitetet false të dy individëve në fjalë. Ndër to, vlen të përmenden fakti se së pari, i dënuari A. K. njihet edhe me mbiemrin B., ka atësi dhe amësi identike me të – babai T. dhe nëna S. – të njëjtat data lindjeje të prindërve [respektivisht 20.10.1948 dhe 11.07.1949], dhe të njëjtën ditëlindje ai vetë me ish-kunatin e subjektit të rivlerësimit [15.10.1975]. Të gjitha këto coincidenca përjashtojnë rastësinë. Së dyti, i dënuari A. K. dhe ish-kunati i subjektit, A. B., kanë një shenjë të dukshme në pamje, identike, në faqe – sipas dokumenteve zyrtare aktuale, të lëshuara nga autoritetet shqiptare¹⁰³, krahasuar me aktet e përcjella nga autoritetet italiane. Për sa i përket të dënuarit A. B., ndonëse mungojnë atësia dhe amësia në dokumentet e referuara nga autoritetet italiane dhe referohet një ditëlindje më e hershme prej ekzaktësisht tre (3) vjetësh, në fashikull rezultojnë akte që provojnë se është vizituar në paraburgim nga “kunata”, sipas autoriteteve italiane, I. B. dhe nipi A. B.. Nga të dhënat në sistemin TIMS, dy individë me këta dy emra – I. B. dhe A. B. – kanë udhëtuar të paktën 16 herë me vëllanë tjetër të ish-bashkëshortit të subjektit, z. A. B., në periudhën kohore 2008 - 2019. Udhëtimet tregojnë se janë familjarët e z. A. B., vëllait të z. A. B.¹⁰⁴. Për sa më sipër, është e qartë që znj. I. B. është kunata që ka vizituar të pandehurin A. B., që konfirmon faktin që ai individ është ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në paraburgim në Itali.

36.5. Gjetja parashtron se në analizën mbi *marrëdhënien financiare dhe personale* të subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, ish-bashkëshortit të saj dhe ish-kunatit, duhet të merret në konsideratë kredia për shumën 100.000 euro me BKT-në, lidhur në datën 29.01.2008, me kredimarrës z. A. B., garantuese e së cilës ishte Elizabeta Imeraj. Për më tepër, një pjesë e konsiderueshme e asaj kredie, në vlerën prej së paku 45.000 eurosh, sipas Elizabeta Imerajt dhe deklaratës noteriale të M. D.t, është shpenzuar për pagimin e borxhit të A. B. kundrejt M. D.. Me

¹⁰³ Shih edhe një përmbledhje të akteve mbështetëse të gjetjes, referuar në poshtëshënimin 107. Në shtojcë gjenden katër (4) imazhe fotografike për individin me emër A. B., disa prej të cilave të zmadhuara për lehtësi pamjeje. Dy prej tyre janë pjesë e fashikujve të përcjellë nga autoritetet italiane, të tjerat nga dokumentacioni i gjeneruar në Republikën e Shqipërisë.

¹⁰⁴ I. dhe A. B. nuk rezultojnë të kenë dokumentacion identifikues të lëshuar nga autoritetet shqiptare.

fjalë të tjera, gjatë vitit 2008 Elizabeta Imeraj ka qenë garante e kredisë për shlyerjen e borxhit të A. B.. Sa më sipër, përpos kontrollit të figurës, duhet të analizohen edhe në vlerësimin e përgjithshëm për të përcaktuar nëse faktet e mësipërme kanë *cenuar në mënyrë të pakthyeshme besimin e publikut* tek Elizabeta Imeraj. Në përfundim të gjetjes, vëzhguesi përmbledh sa vijon:

- *A. B., ish-bashkëshorti i Elizabeta Imerajt, dhe A. B., ish-kunati i saj, janë në të vërtetë personat të cilët nën identitetet false të A. B.1 (lindur më 20.01.1970 në Jugosllavi) dhe A. K. (lindur më 15.10. 1975 në Kosovë), janë dënuar me vendimin e shkallës së parë të Gjykatës së Rrethit, Kolegji Penal, Romë, për veprën penale të imigracionit të paligjshëm, veprën penale vazhduese të shfrytëzimit të prostitucionit e kryer në bashkëpunim dhe veprën penale vazhduese të rrëmbimit të kryer gjithashtu në bashkëpunim. A. B. është dënuar me tetë vjet burgim dhe gjobë prej 55.000 eurosh, ndërsa A. B. me shtatë vjet burgim dhe gjobë prej 54.000 eurosh. Në apel, me vendim të Gjykatës së Apelit të Romës, A. B. është shpallur i pafajshëm. A. B. është dënuar përfundimisht me shtatë vjet burgim, me gjobë prej 54.000 eurosh (vini re, në vijim dënimi i tij është reduktuar në katër vjet burgim dhe 10.000 euro gjobë, në bazë të të ashtuquajturit instituti “indulto”, një masë faljeje që mund të ulë dënimin, por nuk shuan përgjegjësinë penale).*
- *Elizabeta Imeraj mund dhe duhej t’i kishte vërtetuar lehtësisht këto fakte dhe t’i kishte deklaruar ato në përputhje me nenin 35, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.*
- *Të gjitha faktet e sipërpërmendura duhet të konsiderohen dhe të vlerësohen jo vetëm për sa i përket vlerësimit të figurës së Elizabeta Imerajt, por gjithashtu në kuadër të vlerësimit të pasurisë dhe vlerësimit të përgjithshëm¹⁰⁵.*

36.6. Gjatë hetimit administrativ, sa i përket gjetjes së depozituar në atë fazë procedurale [referuar në paragrafin 36.2 dhe nënpjesët e tij], subjekti i rivlerësimit deklaroi se ajo përbën qëndrim *subjektiv* të vëzhguesit dhe që asaj duhej t’i ishte dhënë mundësia të jepte shpjegime përpara se vëzhguesi ta kualifikojë atë rrethanë “si gjetje apo para se t’i vendoste titullin që ai mendon si më të drejtin”. Subjekti parashtroi se është njohur dhe më pas martuar me bashkëshortin e saj në prill të vitit 2007, fakt i provuar nga certifikata e martesës¹⁰⁶. Po ashtu, sipas saj, personat me emrat A. B. dhe A. B. [me ditëlindjet përkatëse, sipas fashikujve të procedimit penal në Itali] nuk janë ish-bashkëshorti dhe ish-kunati i saj, pasi kanë të dhëna të ndryshme të identitetit. Nuk ka pasur asnjë

¹⁰⁵ Gjetjes i janë bashkëngjitur 20 dokumente shtojcë, përfshirë fotografi të ish-bashkëshortit të subjektivit të rivlerësimit dhe ish-kunatit, nga sistemi TIMS, fotografi të dy individëve të referuar, marrë nga autoritetet italiane gjatë procedimit penal në Itali, vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Romë i datës 19.12.2002 dhe ai i apelit i datës 09.12.2004, të përkthyer në gjuhën shqipe, certifikatë lindjeje lëshuar nga autoritetet e ish-Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë, në shqip dhe serbisht, në emër të A. K.t, kopje e kartës së identitetit të avokatit për z. A. B., leje e lëshuar për znj. I. B. dhe A. B. për të takuar të pandehurin A. B. në burg, të dhëna për hyrje-daljet e A., I. dhe A. B nga dhe për në Republikën e Shqipërisë, nga sistemi i kontrollit kufitar, TIMS, kontratë mes A. B. dhe “{***}” në vitin 2015, kontratë dhurimi e vitit 2017 mes A. B. dhe A. B., kopje e kartës së identitetit dhe e lejes së qëndrimit të A. B. në Britaninë e Madhe, caktimi i një numri identiteti në Britaninë e Madhe për A. B. dhe kopje e lejes së drejtimit të automjetit për të në Britaninë e Madhe.

¹⁰⁶ Në kushtet kur fëmija i parë ka lindur në prill 2007, njohja mes ish-bashkëshortëve duhet të datojë minimalisht nga mesviti 2006.

indicie nga asnjë institucion, për përfshirje të tyre në veprimtari kriminale. Dijenia e pretenduar e saj për këto rrethana, është e pabazuar.

36.7. Komisioni konkludoi se subjekti ka kryer deklaram të saktë në deklaratën e figurës dhe se ajo nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në veprimtari kriminale lidhur me vepra që përfshihen në krimin e organizuar. Në kushtet kur gjeneralitetet e personave të përmendur në vendimin e gjykatës italiane nuk përkohjnë me gjeneralitetet e ish-bashkëshortit dhe ish-kunatit të subjektit të rivlerësimit, dhe asnjë institucion shqiptar nuk dispononte të dhëna se ish-bashkëshorti i subjektit dhe ish-kunati kanë qenë apo janë të dënuar për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar, Komisioni argumentoi se këta dy individë nuk kanë qenë të dënuar për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar. Pavarësisht nga sa më sipër, në konkluzion Komisioni rezultoi të jetë mbështetur në faktin e vendimit të pafajësisë për z. A. B., duke referuar se ai është deklaruar i pafajshëm me vendim penal të formës së prerë, që nën dritën e nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, e përjashton qenien kontakt i papërshtatshëm. Në arsyetimin e Komisionit nuk rezultoi një analizë për sa i përket të pandehurit A. K., në kushtet kur vendimi i Gjykatës së Apelit Romë nuk rezultoi ta ketë shpallur atë të pafajshëm.

36.8. Nga përmbajtja e vendimit të Komisionit, nuk rezultoi vendim lidhur me pranimin apo refuzimin e gjetjeve, çka e bën të paqartë statusin mbi bazën e të cilit këto dokumente i janë përcjellë subjektit. Nga ana tjetër, Komisioni ka pasqyruar gjerësisht deklaramet e subjektit në prapësim të këtyre gjetjeve dhe ka nxjerrë konkluzione mbi aktet e paraqitura nga subjekti, pa i ballafaquar ato me rezultatet e mundshme të ndonjë hetimi të kryer.

36.9. Gjatë seancave gjyqësore publike në Kolegj, subjekti i rivlerësimit parashtroi se në fakt Komisioni ka kryer hetim për gjetjen e paraqitur nga vëzhguesi i ONM-së dhe ka vendosur mbi bazën e provave dhe *bindjes së brendshme*. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, argumentoi se nuk ka qenë në dijeni të rrethanave të pasqyruara në gjetje dhe ka sjellë aktet “*e mundshme*”, që dëshmonin padijeninë e saj. Nuk ka pasur informacion nga ish-bashkëshorti e as ish-kunati dhe asnjë indicie nga autoritetet shqiptare që t’i krijonte dyshim për ekzistencën e ndonjë episodi të konkluduar me pafajësi të formës së prerë, parë jo vetëm në kuadrin e marrëdhënieve të përditshme, por edhe në funksion të ushtrimit të detyrës së saj. Faktet e pretenduara kanë ndodhur përpara martesës së saj, ndërsa në deklaramin për kontrollin e figurës, neni Dh i Aneksit vendos një afat kohor duke filluar nga 1 janari 2012. Subjekti po ashtu parashtroi se nuk ka deklaruar asnjëherë marrëdhënie interesi me ish-kunatin dhe, duke iu referuar pretendimeve për të cilat arsyetohet gjerësisht më sipër për mungesë pasurish në emër të saj, e konsideroi këtë vlerësim të vëzhguesit, jologjik, në tejkallim të Kushtetutës dhe ligjit, si dhe diskriminim.

36.10. Në funksion të këtij shkaku ankimi, subjekti ka kërkuar nga Kolegji administrimin në cilësinë e provës së 21 akteve, pohimin gjyqësor të bërë prej saj në seancën gjyqësore në Kolegj, si dhe pyetjen me cilësinë e dëshmitares së ish-vjehrrës. Në aktet e sjella prej saj, rezultojnë tri shkresa nga Departamenti i Policisë Kriminale, lëshuar më datë 18.02.2022, dy shkresa nga Drejtoria e

Përgjithshme e Gjendjes Civile, po ashtu të lëshuara në datën 18.02.2022, katër shkresa nga Interpol Tirana, datë 17.02.2022, katër shkresa nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, po ashtu në datën 17.02.2022, shkresë nga DSIK-ja, datë 18.02.2022, kërkesë dhe kthim përgjigjeje nga ish-bashkëshorti, vendim i Gjykatës së Apelit Romë [datë 09.12.2004], dy dëshmi penaliteti nga autoritetet italiane për z. A. B., identifikuar me dy ditëlindjet e referuara më sipër [20 janar 1970 dhe 1973], dhe së fundmi, dëshmi penaliteti nga autoritetet italiane për A. B..

36.11. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të shkaqeve të ankimit të Komisionerit, gjetjes së datës 04.02.2022, konkluzioneve të Komisionit dhe argumenteve të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara në fakte dhe në ligj. Po ashtu, trupi gjykues vëren se pretendimet e subjektit për natyrë diskriminuuese, subjektive dhe të pambështetura në dokumente, të të dhënave të rezultuara nga gjetjet e ONM-së që janë përthithur nga ankimi i Komisionerit apo për veprime jokorrekte në përmbajtjen e gjetjes së fundit të ONM-së, janë të pabazuara. Pretendimet dhe shpjegimet e parashtruara nga subjekti për të vënë në dyshim identitetin e personave për të cilët janë administruar akte për procedim penal në Itali në vitet 2002-2004, të cilat më pas evoluuan në mungesë përgjegjësie për deklaram apo mungesë dijenie prej saj, nuk arritën të zhbëjnë sa parashtron Komisioneri Publik, bazuar në vlerësimet e kryera nga ONM-ja gjatë procesit të rivlerësimit. Për të njëjtat arsye, konkluzioni i Komisionit bazuar në një analizë të përciptë të fakteve, provave dhe dispozitave ligjore që normojnë kontrollin e kriterit të figurës, është i pabazuar në prova dhe në ligj.

36.12. Konkluzioni i mësipërm bazohet në disa aspekte të analizuara nga Kolegji në funksion të pretendimeve të Komisionerit dhe subjektit të rivlerësimit. Së pari, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje që një prej kompetencave të njohura ONM-së nga Aneksi i Kushtetutës, është edhe paraqitja e gjetjeve mbi çështjet që shqyrtohen nga Komisioni dhe Kolegji. Kjo kompetencë është parashikuar në nenin B, pika 3, germa “b” e Aneksit të Kushtetutës dhe zbërthyer në terma praktikë në dispozitat e nenit 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon që:

[...] Gjetja, e paraqitur në formën e një deklaratë ose raporti të dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar, përbën provë që dëshmon një fakt, rrethanë ose standard ligjor, i cili ekziston ose ka ndodhur. Gjetja parashtron rrethanat për konstatimin e bërë. Komisioni ose Kolegji e çmon gjetjen si të barasvlershme me mendimin e dhënë nga një ekspert. Refuzimi i gjetjes bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionit ose të Kolegjit të Apelimit [...].

36.13. Në lexim të sa më sipër, gjetjet e vëzhguesve ndërkombëtarë, të depozituara në formën dhe në institucionin e rivlerësimit përkatës, sipas fazës procedurale, janë pjesë integrale e procesit të rivlerësimit dhe, si të tilla, nuk mund të argumentohen si *imponim* ndaj Komisionerit në momentin kohor përkatës. Po ashtu, nën dritën e përcaktimit ligjor të referuar më sipër, argumenti i ngritur nga subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, se përfaqësuesit e ONM-së duhet së pari të kërkojnë marrjen e provave e më pas të konkludojnë me gjetje – parashtruar prej saj në parashtrimet në Kolegji – është i pabazuar jo vetëm në ligj, por edhe në fakte. Sjellim në vëmendje

që gjetja e datës 04.02.2022 ishte e shoqëruar me 21 akte shkresore, të cilat përbëjnë pjesë integrale të saj dhe mbi të cilat mbështetet konkluzioni i mbërritur nga përfaqësuesi i ONM-së për identitetin e dy personave të dënuar. Me fjalë të tjera, në kushtet kur gjetja shoqërohet me dokumentacion mbështetës të konsiderueshëm, kërkimi i provave të tjera duket një kërkesë që nuk do të sillte asnjë vlerë të shtuar apo ndihmonte procesin nga ana procedurale.

36.14. Nga ana tjetër, aktet e sjella nga subjekti i rivlerësimit në prapësim të këtij shkak ankimi [përmbledhur më sipër në paragrafin 36.10], nuk arritën të zhbëjnë sa rezulton qartë nga dokumentacioni i përcjellë në Kolegj nga Komisioni apo aktet e përcjella së bashku me gjetjen e datës 04.02.2022. Nga të gjitha këto dokumente, rezulton që dy individët e referuar në procedimin penal, janë ish-bashkëshorti dhe ish-kunati i subjektit të rivlerësimit. Të dy janë dënuar fillimisht për vepra penale të cilat përfshihen në rrethin e veprave të krimit të organizuar, sipas përcaktimeve të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016. Me vendim të formës së prerë, ish-bashkëshorti i subjektit është shpallur i pafajshëm në apel, ndërsa për ish-kunatin e subjektit, z. A. B., vendimi i shkallës së parë që e ka gjetur fajtor dhe dënuar, ka marrë formë të prerë. Fakti që këto ngjarje kanë ndodhur përpara martesës së subjektit të rivlerësimit, përbën rrethanë lehtësuese për ekzistencën e kontaktit të papërshtatshëm – në rastin e ish-kunatit të subjektit të rivlerësimit – parashikuar nën dritën e nenit 38, pika 5, germa “dh” e ligjit nr. 84/2016, por jo përjashtuese.

36.15. Për sa i përket saktësisë së deklaramit nga ana e subjektit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në mënyrën se si e ka trajtuar këtë aspekt të hetimit dhe procesit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, në tërësi nuk është bindëse për mungesën e dijenisë dhe as është treguar bashkëpunuese nën dritën e nenit 48 të ligjit nr. 84/2016¹⁰⁷. Në këtë konkluzion, trupi gjykues çmon të theksojë që mungesa e sinqeritetit të subjektit të rivlerësimit në përballjen me këto të dhëna, shfaqet qartë edhe nëse konsiderohet si moment i parë marrje dijenie tetori 2020, nëpërmjet gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar [cituar në paragrafin 36.2 më sipër]. Gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, në ballafaqim me këtë pretendim, subjekti nuk ka demonstruar asnjë shenjë reflektimi për veprime që do duhej të ishin ndërmarrë prej saj, në skenarin hipotetik të prezantuar prej asaj vetë – se nuk ishte në dijeni të këtyre fakteve. Përkundrazi, përgjatë procesit, përgjigjet e saj kanë evoluuar nga kontestim i gjetjes si mjet ligjor në dispozicion të vëzhguesve, në përpjekje për të mohuar kredibilitetin e tyre, në mohim të çdo probabiliteti që dy të pandehurit mund të ishin ish-bashkëshorti dhe ish-kunati, për shkak të ndonjë detaji të ndryshëm në gjeneralitetet e tyre – që rezultuan të pavërteta – duke theksuar faktin që aktet flasin për dy shtetas me vendlindje në Kosovë, e deri në mungesë dijenie për shkak të kohës. Një qasje e tillë reflekton qartë përpjekje për të evituar përgjegjësi apo për të pranuar ekzistencën e një fakti potencialisht dëmtues, në çdo formë të mundshme, duke goditur kredibilitetin e provave mbi bazën e detajeve me natyrë tërësisht

¹⁰⁷ Neni 48 i ligjit nr. 84/2016 parashikon që: “Subjekti i rivlerësimit bashkëpunon me Komisionin dhe Kolegjin e Apelimit, të cilët, në marrjen e vendimit, mbajnë parasysh gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit.”

teknike, apo duke kontestuar motivet e përfaqësuesve të ONM-së gjatë ushtrimit të detyrës si mendime “subjektive”, të cilat cilësohen nga vëzhguesi “sipas dëshirës”.

36.16. Në të njëjtën mënyrë u konsideruan edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, për padijeni, bazuar në aktet zyrtare të kërkuara dhe marra prej saj nga institucione të ndryshme në Republikën e Shqipërisë, listuar më sipër. Nga përmbajtja e akteve, deduktohet informacion dhe fakte të cilat nuk janë vënë kurrë në dyshim dhe, për pasojë, nuk sjellin asnjë vlerë të shtuar. Me fjalë të tjera, 21 aktet e sjella nga subjekti, nuk vërtetojnë asgjë të re pasi provojnë fakte të rezultuara gjatë gjyqimit. Konkretisht, një analizë e tyre tregon: (i) që autoritetet shqiptare nuk kanë asnjë të dhënë për procedim penal apo vendime penale për ish-bashkëshortin e subjektit në Shqipëri, apo për një individ me të njëjtin emër dhe ditëlindje që përkon me atë që posedojnë autoritetet italiane; (ii) që autoritetet shqiptare nuk kanë asnjë të dhënë për procedim penal apo vendime penale për ish-kunatin e subjektit të rivlerësimit, me cilëndo datëlindje të pasqyruar në aktet e ndryshme; (iii) që të dy këta individë kanë adresa banimi përkatëse në Tiranë; (iv) që Gjykata e Apelit të Romës ka marrë vendim pafajësie për ish-bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit; (v) që DSIK-ja ka hartuar dhe përcjellë një raport pozitiv për subjektin e rivlerësimit në kuadër të vlerësimit të kriterit të figurës.

36.17. Po ashtu, trupi gjykues vëren që thirrja në cilësinë e dëshmitares së ish-vjehrrës së subjektit të rivlerësimit, nuk do të sillte asnjë vlerë të shtuar në proces pasi nuk do të mund të provonte padijeninë e subjektit për procedimin penal në Itali të ish-bashkëshortit apo ish-kunatit dhe as të zhbënte sa përcakton dënimi penal i formës së prerë. Edhe sikur të abstragohet nga besueshmëria e diskutueshme e dëshmisë së një anëtari të familjes, në rrethana me rëndësi për të ardhmen profesionale të subjektit të rivlerësimit, në rastin konkret pretendohet të provohet që një ndodhi specifike nuk ka qenë objekt bisede e një forumi të caktuar njerëzish, por nuk mund të përjashtojë sa është ndarë në forume dhe midis anëtarëve të tjerë të familjes, në të cilat ish-vjehrra e subjektit nuk ka qenë e pranishme. Për këto arsye, kërkesa për thirrjen e kësaj dëshmitareje nuk u pranua nën dritën e përcaktimeve të nenit 49, pika 6, gerat “a” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, si një provë e panevojshme dhe të dhënat që do të rezultonin prej dëshmisë si mjet i papërshtatshëm¹⁰⁸.

36.18. Së fundmi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, nuk u tregua koherente dhe as e sinqertë në proces edhe për sa i përket çështjes së ndërthurjes së interesave të saj personale me ish-kunatin, z. A. B.. Ndryshe nga sa ka pretenduar në procesin në Kolegj, se argumentet në fjalë janë diskriminuese apo jologjike, meqenëse ajo nuk ka deklaruar pasuri, në arsyetimin më sipër, konkretisht në paragrafët 32.8/b, 32/8/e dhe 33.5/e, është shtjelluar në detaj se si akte shkresore të ndryshme, të hartuara ndër vite, referojnë përzierje interesash financiarë, edhe të vetë subjektit të rivlerësimit me këtë individ. Së pari, sjellim në vëmendje se (i)

¹⁰⁸ Neni 49, pika 6, gerat “a” dhe “c” respektivisht parashikojnë se: “6. Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; [...] c) mjeti i provës është tërësisht i papërshtatshëm ose i paarritshëm [...]”.

kredia prej 100 mijë eurosh nga BKT-ja, pretendohet nga subjekti vetë të jetë destinuar pjesërisht për të shlyer një hua që ish-kunati, z. A. B., i kishte çiftit D.. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, ishte garantuese e kësaj kredie. Së dyti, subjekti ka jetuar duke filluar nga viti 2007, në një godinë 5-katëshe që, ndonëse e gjitha në emër të bashkëshortit, është pretenduar të përfaqësonte një investim edhe të ish-kunatit, z. A. B.. Pikërisht për të justifikuar mjaftueshmërinë e burimeve financiare të disponuara për investimin në këtë ndërtesë, në përgjigje të rezultateve të hetimit të parë administrativ [16.10.2019], subjekti ka pretenduar një kontribut prej **6.970.700** lekësh nga z. A. B. në vitin 2004 për ndërtimin e godinës. Në përgjigje të rezultateve të dyta të hetimit administrativ, datë 27.01.2021, disa muaj pasi ishte njohur me gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar në tetor 2020, për procedimin penal në ngarkim të ish-kunatit, ajo ka ndryshuar qëndrim: duke mos i atribuar tanimë z. A. B. asnjë kontribut financiar. Nga ana tjetër, ky i fundit është një ndër përfituesit e kontratës së dhurimit të vitit 2018 për njërin prej kateve të ndërtesës 5-katëshe, analizuar në pjesën e arsytimit që mban numrin 5 të këtij vendimi, gjë që në parim nënkupton që deklarimi i subjektit të rivlerësimit në hetimin e parë administrativ përputhet me sa disponon kontrata e dhurimit.

36.19. Për gjithë sa më sipër, pasi dëgjoi parashtrimet e palëve, analizoi provat e administruara dhe shqyrtoi në tërësi aktet në fashikujt e Komisionit, trupit gjykues i rezultoi se z. A. B. (ish-kunati i subjektit të rivlerësimit) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale të cilat përmbushin testin e përcaktuar në nenin 3, paragrafi 15 i ligjit nr. 84/2016, për t'u konsideruar person i përfshirë në krimin e organizuar. Qasja e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të njohjes me këtë fakt, minimalisht nëpërmjet gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar, e vlerësuar në tërësi, u konsiderua në kundërshtim me detyrimet e nenit 48 të ligjit nr. 84/2016. Në këtë konkluzion, trupi gjykues merr në konsideratë, ndër të tjera, ndryshimet e qëndrimeve të subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, si për sa i përket kontributit financiar të vëllait të ish-bashkëshortit në funksion të mohimit të kontributit financiar të tij në *pasurinë e paluajtshme "Godinë banimi 5-katëshe, ndodhur në rrugën "{***}"*, si dhe ndryshimin e deklarimeve të saj në proces, që evoluuan nga mohim i bazuar mbi të dhënat e identitetit, në mohim të dijenisë për rrethanat faktike dhe ligjore në lidhje me faktin e dënimit penal. Mohimi i fakteve të dokumentuara që evoluoi në pretendim për mungesë dijenie, dëshmon përpjekje për të shmangur përgjegjësinë dhe mungesë vullneti për të qartësuar rrethanat me përpikëri. Të gjitha këto konkluzione, vlerësohen në cilësinë e fakteve që tregojnë sjellje të papërshtatshme për një magjistrat.

C. Lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale

- 37.** Komisioneri Publik, referuar edhe përmbajtjes së rekomandimit dhe shtesës përkatëse të tij, konstaton se Komisioni ka munguar të arsyetojë lidhur me arsyet e refuzimit të gjetjes, ndërsa subjekti i rivlerësimit, duke shfrytëzuar të drejtën e saj procedurale, ka paraqitur parashtrimet e saj dhe akte mbi të cilat ka pretenduar se bazohen ato parashtrime. Komisioni nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për verifikimin e rrethanave objektive që ishin pasqyruar në gjetjen e ONM-së, sikurse urdhëron neni 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016. Gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar

konsiderohen në cilësinë e provës që dëshmon faktin, rrethanën apo standardin ligjor të parashtruar në të dhe, si të tilla, ato duhet të merren në shqyrtim nga Kolegji, dhe eventualisht të ballafaqohen me pretendimet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, përfshirë dhe sa është parashtruar në shtesën e rekomandimit, të paraqitur nga 3 vëzhguesit ndërkombëtarë, lidhur edhe me vendimin penal të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda me nr. 51/2016, në të cilin subjekti i rivlerësimit ka përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Në parashtrimet e tij në Kolegj, Komisioneri Publik u qëndroi të gjitha shkaqeve të ankimit.

37.1. Në mënyrë të përmbledhur, në gjetjen e depozituar në Komision më datë 06.08.2020 dhe në shtesën e rekomandimit të paraqitur më datë 21.06.2021, në zbatim të së drejtës së garantuar nga neni B, pika 3, germa “b” e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016, vëzhguesit ndërkombëtarë parashtrojnë fakte dhe vlerësime referuar dy procedimeve penale, në të cilat subjekti ishte në cilësinë e prokurorit të çështjes. Konkretisht:

- a. Për procedimin penal në ngarkim të z. Xh. M., ONM-ja parashtron se *shtyrjet* e afateve të hetimit nga subjekti i rivlerësimit kanë qenë të pabazuara në ligj dhe të paarsyetuara. Më datë 29.12.2011, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të shtyjë hetimin, të ndajë çështjen e Xh. M. nga procedimi kryesor, si dhe të shpallë *moskompetencë*, duke e transferuar çështjen në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me arsyetimin se gjykimi ndaj tre të pandehurve të tjerë për ngjarje të ndodhura në mars dhe qershor 2010, ka arritur në një fazë që e bën proceduralisht të pamundur që subjekti i rivlerësimit t’i drejtohet gjykatës me një kërkesë për gjykim për z. M.. Subjekti po ashtu ka pretenduar se, meqenëse ky person akuzohet vetëm për prodhim të narkotikëve, vepra është jashtë kompetencës së Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit ndaj z. Xh. M. është i pajustificuar, krahasuar me qëndrimin që ajo ka mbajtur të paktën ndaj një prej të akuzuarve të tjerë [z. A. M.]. Pas transferimit të çështjes te Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, pozita e personit të hetuar [Xh. M.] ishte qartësisht më e favorshme. Në vitin 2012, Gjykata e Gjirokastrës e gjeti atë të *pafajshëm*.
- b. Për procedimin penal në ngarkim të z. B. P., në mënyrë të përmbledhur ONM-ja parashtron një sërë problemesh në veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në lidhje me mungesën e arsyetimit të vendimit të marrë për shpalljen e moskompetencës, nën dritën e provave ekzistuese për të përcaktuar fajësinë. Si rezultat i veprimeve të paargumentuara dhe të pabazuara të subjektit të rivlerësimit dhe një prokurori tjetër, çështja është mbyllur nga Prokuroria e Krimeve të Rënda për moskompetencë dhe është dërguar në Prokurorinë e Rrethit Shkodër: *(1) pa hetim gjithëpërfshirës dhe të plotë, që mund të kishte çuar në mbledhjen e më shumë provave mbi përcaktimin e fajësisë së mundshme për një vepër penale dhe përcaktimin e rolit të B. P. në aktivitetin e trafikimit të lëndëve narkotike, dhe (2) me argumente të paqarta dhe kundërshtuese mbi provat ekzistuese [...]*¹⁰⁹.

¹⁰⁹ Faqe 8 dhe 9 e gjetjes së datës 06.08.2020.

- c. Për vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nr. 51, datë 20.04.2016, me kërkues Prokurorinë pranë asaj gjykate, të përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit, me të pandehur C. A. P. T., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Trafikim i narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/a/2-22 i K.Penal, i dënua me 15 vite burgim. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. 67, datë 10.06.2016. Ndërkohë që nga shqyrtimi i shtesës së rekomandimit, rezulton që vëzhguesit ndërkombëtarë janë shprehur për mangësi në hetim, dështim në kryerjen e veprimeve hetimore efektive, dështim në drejtimin e hetimit, dëmtim të cilësisë së hetimit në përputhje me rregullat procedurale penale.

37.2. Komisioni shqyrtoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të gjetjes së datës 06.08.2020 dhe në konkluzion, nuk konstatoi problematika në veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit për këto dy procedime penale, meqenëse vendimi i marrë nga subjekti në cilësinë e prokurores së çështjes për shpalljen moskompetencës, nuk është kundërshtuar nga prokuroritë e rretheve Gjirokastër dhe Shkodër, të cilave u janë përcjellë për kompetencë, sikurse edhe që gjykatat nuk kanë ngritur pretendime në lidhje me kualifikimin e veprës penale.

37.3. Në shpjegimet e saj në procesin e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, ka parashtruar argumente për procedimin penal në lidhje me Xh. M. dhe B. P.. Në përmbledhje, argumentet e subjektit në atë fazë procedurale, kanë qenë sa vijon.

- a. Për çështjen që i përket z. M., flitej për një grup personash që kultivonin dhe shisnin bimë narkotike [Cannabis Sativa] në fshatin {***} të Gjirokastrës, të cilët ishin vënë në përgjim. Në hetimin e procedimit penal të vitit 2010 dhe në hetimin e zhvilluar në ngarkim të Xh. M., Prokuroria për Krime të Rënda ka bashkëpunuar me Shërbimin Informativ dhe strukturat e Policisë së Shtetit. Çdo vendimmarrje në raport me këtë çështje në hetim, është bërë mbi bazën e një plani hetimor për të cilin është rënë dakord nga disa institucione bashkërisht. Ky individ është hetuar për veprën penale sipas nenit 283/2 të Kodit Penal – prodhimi dhe shitja e narkotikëve në bashkëpunim dhe/ose në mënyrë të përsëritur – dhe jo sipas neneve 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal – trafikimi i narkotikëve në bashkëpunim dhe/ose në mënyrë të përsëritur, në tentativë. Edhe masa e sigurimit personal “arrest në burg” i është caktuar sipas nenit 283/2 të Kodit Penal. Në këtë mënyrë, qëndrimi i Prokurorisë për Krime të Rënda për shpalljen e moskompetencës lëndore, ka qenë i qëndrueshëm në raport me kualifikimin që i është bërë veprës penale të kryer nga Xh. M..
- b. Për procedimin penal në ngarkim të B. P., subjekti i rivlerësimit argumentoi se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme dhe ka konkluduar me një akuzë, e cila nuk ishte në kompetencën e saj. Në lidhje me konstatimet e bëra nga vëzhguesi ndërkombëtar, subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, ka shpjeguar se ka marrë vendim mbi bazën e tagrave të saj ligjorë mbi bazën e provave dhe bindjes së brendshme. Sipas subjektit, prokurori B. D. që ka ndjekur çështjen që në fillim të hetimit, nuk ka marrë një vendim mase sigurimi personal “arrest në burg”. Ajo dhe kolegu P. morën masat e nevojshme për ngritjen e një akuze të trafikimit, sipas nenit

283/a/2, për B. P., por largësia e veprimeve hetimore në kohë, për faj të pasivitetit të prokurorit të mëparshëm, si dhe fakti që asnjë nga të dënuarit nuk pranoi të jepte deklarime të tjera, nuk lejoi të krijoheshin kushtet për ngritjen e një akuze. Subjekti parashtron se kjo situatë mbetet e debatueshme, sidomos kur bëhet fjalë për analizën mbi ekzistencën e lidhjes shkakësore në kryerjen e një vepre penale.

37.4. Gjatë seancave gjyqësore publike në Kolegj, për çështjen që i përket procedimit penal në ngarkim të z. P. T., përpos disa shpjegimeve të kontekstit në të cilin u zhvillua procedimi penal, subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, referoi që çështja është dërguar për gjykim për trafikim të lëndëve narkotike, në lidhje dhe me hetime të tjera për persona të tjerë të përfshirë në këtë veprimtari dhe është veçuar çështja dhe është vendosur hetimi i mëtejshëm në drejtim të evidentimit final, nëse destinacioni ishte Shqipëria. Në vitin 2018, kur ajo është larguar nga Prokuroria e Krimeve të Rënda për t'u caktuar drejtuese në Prokurorinë e Tiranës, çështja i është shortuar një tjetër prokurori. Ky i fundit ka vendosur kalimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të mungesës të kompetencës lëndore për trafikimin e lëndëve narkotike. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se i mungon informacioni i detajuar për veprimet e ndërmarra nga prokurori i çështjes, ndonëse ushtron detyrën e drejtueses. Në këtë të fundit, tagrat sipas ligjit nr. 96/2016, lidhen vetëm me të dhëna që janë të hedhura në regjistër. Çështja në fjalë është akoma në hetim. Çdo individ që i atribuon probleme në procedimin penal asaj [subjektit] nuk ka pasur informacionin e duhur se çfarë është bërë në raport me çështjen. Kjo çështje ka kaluar në duart e 3 prokurorëve të tjerë dhe është hetuar në bashkëpunim me strukturat e policisë, për të marrë përgjigje nëpërmjet ndihmës juridike ndërkombëtare. Ky individ është dërguar për gjykim dhe është i dënuar.

37.5. Në mbështetje të shpjegimeve të saj, subjekti kërkoi administrimin në cilësinë e provave të 13 akteve, ndër të cilat, pesë (5) gjendeshin në fashikujt e përcjellë në Kolegj nga Komisioni. Dy të tjera janë vendime të Komisionit për konfirmimin në detyrë të dy prokurorëve të përfshirë në procedimin penal për z. B. P. – respektivisht prokurorët B. D. dhe D. P.. Gjashtë aktet e tjera përbëhen nga dokumentacion që provon punën e kryer nga subjekti ndër vite, akte që lidhen me organizimin e punës në prokurori dhe akte që provojnë se subjekti ka pasur kanosje për shkak të detyrës dhe është marrë në mbrojtje të veçantë. Trupi gjykues i Kolegjit mori aktet e reja në cilësinë e provës.

37.6. Në vijim të sa më sipër, sa u përket akteve të reja të sjella nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren që ato provojnë fakte të pakontestuara apo çështje që nuk përbëjnë objekt shqyrtimi në procesin e rivlerësimit në Kolegj. Si të tilla, korrespondenca elektronike mes subjektit të rivlerësimit dhe Prokurorisë së Përgjithshme apo procesverbali që dokumenton mënyrën e organizimit të ngarkesës në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, janë jorelevante në analizën e veprimeve hetimore të kryera apo të munguara në tri procedimet penale objekt shqyrtimi. Për të njëjtën arsye, janë jorelevante faktet që lidhen me kanosjen e subjektit për shkak të detyrës apo

mbrojtjen e veçantë që i është njohur asaj. Vendimet e konfirmimit në detyrë të magistratëve P. dhe D., po ashtu janë përtej kontrollit që ushtron Kolegji për këtë shkak ankimi.

37.7. Në analizë të gjithë sa më sipër për këtë shkak ankimi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se veprimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, në cilësinë e prokurores së çështjes në procedimin penal që lidhet me z. P. dhe atë që lidhet me z. P. T., rezultojnë me mangësi serioze. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk ishin bindëse. Veprimet e kryera prej saj në këto dy çështje, analizuar nën dritën e neneve 73, pika 2¹¹⁰ dhe 74, pikat 1 dhe 2¹¹¹ të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ishin të pamjaftueshme për të demonstruar një qasje të plotë dhe proaktive në drejtim të përgjegjësisë penale të individëve përgjegjës. Ky konkluzion merr në konsideratë veprimet e subjektit të rivlerësimit në funksion të hapave hetimorë të ndërmarrë për mbledhjen e provave dhe për interpretimin e ligjit.

37.8. Konkretisht, nga aktet në fashikull, rezulton që procedimi në lidhje me z. P., ndër të tjerë, lidhet me hetimin e nisur në vitin 2013 sipas nenit 283/a, paragrafi II i Kodit Penal për veprën penale të trafikimit të narkotikëve, rrjedhojë e bashkëpunimit mes autoriteteve shqiptare dhe atyre italiane. Në tetor 2014, shtatë (7) persona u morën në cilësinë e të pandehurve pasi policia parandaloi trafikimin e 780 kg *cannabis sativa* në Itali. Në tetor 2015, prokurori B. D. ndau procedimet për këta individë, duke nisur çështjen për gjykim. Për sa i përket z. P. dhe dy të tjerëve, hetimi u vlerësua se duhej të vazhdonte. Të shtatë të pandehurit u dënuan në maj 2016, me vendimin e gjykatës me nr. 69/2016. Gjykata e Apelit konfirmoi vendimin e shkallës së parë me ndryshime të vogla lidhur me cilësimin e veprës penale për dy të pandehur. Prokuroria e Krimeve të Rënda përfaqësohej nga prokurori B. D., i cili ndoqi hetimet në procedimin në fjalë.

37.9. Sipas vendimit të gjykatës, dy nga të pandehurit kishin krijuar lidhje ndër të tjera, me z. B. P. në Velipojë, i cili kishte lëndë narkotike për të shitur. Për më tepër, sipas të njëjtit vendim, dy nga të pandehurit, nën urdhrat e z. P., shtruan rrugën në {***}{***} për të lejuar automjetet që do të transportonin lëndën narkotike në breg të detit. Policia fillimisht arrestoi edhe z. P., duke e lënë më pas të lirë nën monitorim, meqenëse nuk u gjet në posedim të lëndës narkotike. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë, përveç përkrahimit të mësipërm të rolit të luajtur nga z. P., përmban

¹¹⁰ Neni 73, pika 2 përcakton: “[2.] Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën [...]”.

¹¹¹ Dispozitat e cituara nga neni 74, parashikojnë përkatësisht: “[1.] Me anë të kriterit të aftësisë organizative vlerësohet aftësia e magistratit për të përballuar ngarkesën e punës dhe për të kryer procedurat hetimore ose gjyqësore, si dhe aftësia për të administruar dosjet gjyqësore, duke shmangur rrethanat, të cilat nuk varen nga magistrati dhe që kanë efekt negativ në rezultatet e rivlerësimit [...]” – dhe: “[4.] Në rastin e prokurorit, aftësia e prokurorit për të kryer në mënyrë të efektshme procedura hetimore dhe procedura të tjera të sistemit të prokurorisë matet duke u bazuar në treguesit e kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale brenda afatit kohor të përcaktuar, të mbledhjes së provave të nevojshme, duke përfshirë mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit [...]”.

edhe përgjime të bisedave telefonike dhe përgjime ambientale të mbledhura nga prokuroria. Ndër to, ka biseda ku z. P. dëgjohej të flasë direkt, sikurse edhe të tjera kur përmendet emri i tij.

37.10. Më 12 maj 2017, subjekti i rivlerësimit dhe një prokuror tjetër, të cilëve u ishte kaluar çështja nga drejtuesi i prokurorisë, urdhëruan shënimin e emrit të B. P. dhe dy të pandehurve në regjistrin e veprave penale [procedimi 245/2013], për veprën penale të trafikimit të narkotikëve në bashkëpunim, më shumë se një herë, në tentativë [neni 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal]. Më 25 maj 2017, subjekti i rivlerësimit kërkoi masën e sigurisë “arrest në burg” për të dyshuarin. Gjykata pranoi kërkesën, mbi bazën e të dhënave të sipërcituara nga përgjimi i telefonatave që referon rolin e z. P. në ngjarjet e sipërshtjelluara, të dhëna të tjera për lidhjen mes z. P. dhe të dyshuarve të tjerë, dhe *dyshimin e bazuar* për trafikimin e narkotikëve në bashkëpunim. Një muaj më pas, më 18 qershor 2017, me kërkesën e prokurorisë – subjektit të rivlerësimit dhe prokurorit tjetër – masa e sigurisë ndryshoi në *detyrim për paraqitje*. Më 24 korrik 2017, prokurorët njoftuan të dyshuarin P. që tanimë vepra penale në ngarkim të tij, ishte “moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, e cila nuk përbën kompetencë lëndore të Prokurorisë për Krimet e Rënda. Për pasojë, në datën 28 korrik 2017, subjekti i rivlerësimit dhe prokurori tjetër marrin vendim për shpalljen e moskompetencës lëndore për këtë të pandehur [dhe dy të tjerët]. Çështja u gjykua nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila në bazë të marrëveshjes së pranimit të fajësisë nga i pandehuri, e dënoi këtë të fundit me një gjobë 200 mijë lekë për “moskallëzim krimi”.

37.11. Nga sa më sipër, rezulton që si rezultat i veprimeve të subjektit të rivlerësimit [dhe prokurorit tjetër], në harkun kohor nga *maji* deri në *korrik*, procedimi penal i një personi për të cilin kishte përgjime telefonike dhe transkriptime përgjimesh ambientale që tregonin minimalisht rol kyç në përpjekjet për trafikimin e 780 kg *cannabis*, evoluoi nga *dyshim i bazuar në prova për trafikim narkotikësh në bashkëpunim*, në *moskallëzim krimi*, duke rezultuar në një gjobë modeste. Gjithë ky proces ndodhi pavarësisht nga sa ishte konstatuar me vendim gjykate për rrethanat e faktit dhe pavarësisht se në dërgimin e procedimit penal për të pandehurit e tjerë, prokurori i mëparshëm kishte konstatuar nevojë për hetim të mëtejshëm për të proceduarit. Nga aktet në fashikull, nuk rezulton *asnjë* veprim hetimor si pasojë e të cilit subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, të ketë mbledhur prova që dëshmojnë se sa është konstatuar më herët nga ajo, më 12 maj 2017, për sa i përket nevojës për zbatimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, ndër të tjera, për shkak të rrezikshmërisë së lartë shoqërore që paraqiste z. P. si individ, por edhe për shkak të provave të reja që mbështesin sa pretendohet në korrik 2017 për lidhje shoqërore mes të pandehurve dhe z. P., ashtu si nuk rezulton se këto konstatime analizoheshin kundrejt informacionit të konsiderueshëm që rrjedh nga hetimet e mëparshme dhe nga kontrolli i kryer në automjetin ku udhëtonte edhe ky individ. Konkretisht, në bisedat telefonike, z. P. rezulton porositi i veprimeve dhe në automjetin ku ai udhëtonte, janë gjetur doreza dhe shirit ngjitës natriban dhe qese plastike të përdorura për të mbajtur lëndën narkotike. Në vendim, subjekti arsyeton vetëm mungesën e provave daktiloskopike të z. P. në lëndën e konfiskuar narkotike dhe rrethanat që çuan në praninë e tij në automjetin e drejtuar nga i pandehuri Ç., siç janë referuar nga të pandehurit, por mungon një analizë për hetimet e kryera që kanë konfirmuar këtë version të fakteve apo si janë vlerësuar prej saj dhe prokurorit

tjetër, sendet e gjetura të fshehura në automjet – dorezat, natribani dhe qeset plastike mbështjellëse. Nuk rezulton po ashtu asnjë veprim hetimor që të shpjegojë ndryshimin e konsiderueshëm në interpretimin që u është bërë dispozitave ligjore që zbatoheshin, në harkun kohor mes majit dhe korrikut 2017, që passolli konkluzionin që përfshirja e këtij të dyshuari ishte e papërfillshme, pavarësisht nga sa dëshmojnë përgjimet telefonike të kryera, sipas të cilave deduktohet që personat e përfshirë i raportojnë z. P. detaje për mbarëvajtjen e procesit.

37.12. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në procedimin penal të analizuar, subjekti ka treguar mungesë të aftësive për të ndërmarrë hetimin dhe mbledhur provat e kërkuara me ligj, duke passjellë përcjelljen e çështjes në gjykim pa ia nënshtuar një hetimi të gjithanshëm dhe interpretimi të drejtë të ligjit, që do të lejonte përcaktimin e fajësisë së mundshme bazuar mbi rolin e luajtur nga secili i pandehur, përfshirë z. P.. Po ashtu, veprimet kontradiktore të kryera në harkun kohor maj - korrik 2017, në drejtim të masës së sigurimit personal, u panë nga trupi gjykues edhe në drejtim të standardeve minimale kohore, kërkesë e pikës 2 të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, si një tregues domethënës i mënyrës se si subjekti i rivlerësimit ka përballuar ngarkesën, nën dritën e rrethanave ligjore dhe faktike konkrete. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, ka kërkuar zbatimin e dy masave të ndryshme dhe zgjatjen e gjendjes së cenimit të lirisë së të pandehurit, në kushtet kur sipas vendimit të saj të mëpasmë dhe mungesës së hetimeve, asnjëra prej tyre nuk ishte e nevojshme.

37.13. Lidhur me procedimin penal në ngarkim të z. P. T., nga vendimi nr. {***}/2016 i gjykatës, rezulton se procedimi penal i përket një shtetasi të huaj, i dënuar për trafikim të lëndëve narkotike sipas nenit 283/a/2, në bashkëpunim dhe në tentativë nga autoritetet shqiptare. Si pasojë e koordinimit mes autoriteteve shqiptare, italiane dhe malazeze, në qershor 2014 u parandalua trafikimi në territorin e Republikës së Shqipërisë i 227,6 kg kokainë me prejardhje nga Amerika e Jugut. I pandehuri P. T. kishte ardhur në Shqipëri për të marrë pagesën e cila përllongaritej mes 600 mijë – 1 milionë euro. I pandehuri u shpall fajtor dhe u dënua me 15 vjet burgim.

37.14. Në vendim, gjykata është shprehur qartë se lënda narkotike kishte destinacion Shqipërinë, ishte pjesë e një veprimtarie të organizuar të trafikimit ndërkombëtar të kokainës dhe i pandehuri ka vepruar në bashkëpunim, si ekzekutor, pjesë e një mekanizmi të trafikimit të lëndës narkotike të organizuar, ka kontaktuar persona shqiptarë, të cilët e kanë orientuar. Bashkëpunëtorët nuk janë identifikuar për shkak se prokuroria ka kryer “një hetim të mangët [...] duke mos kryer veprime hetimore në drejtim të identifikimit të bashkëpunëtorëve të të pandehurit, porositësve të tij, organizatorëve të trafikimit ndërkombëtar të një sasive të madhe të lëndës narkotike, kryerjes së veprimeve hetimore të përbashkëta me autoritetet e huaja në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, dërgimit të letërporosive autoriteteve të huaja [...] apo kryerjen e veprimeve hetimore në Shqipëri në lidhje me personat që kontaktonin të pandehurin dhe prisnin lëndën narkotike të konfiskuar [...], si dhe identifikimin në tërësi të rrethit të personave të përfshirë në këtë veprimtari kriminale dhe as personin që kishte telefonuar i pandehuri [...], veprime që nuk janë kryer në kohë dhe nuk mund të kryhen nga gjykata gjatë gjykimit të çështjes [...]”. Gjykata

ka konstatuar edhe që në kohën në fjalë, prokuroria nuk ka asnjë të dyshuar apo hetim tjetër për këtë ngjarje. Mosveprimi i organit të akuzës gjatë hetimeve paraprake, me kryerjen e veprimeve procedurale të papërsëritshme, ka dëmtuar cilësinë e rezultatit të hetimeve duke mos përmbushur detyrimin ligjor e kushtetues për një hetim të plotë e të gjithanshëm me të cilin ngarkohet organi i prokurorisë. Si pasojë e këtyre mangësive, në një procedim penal për trafikimin e një sasive të madhe narkotikësh, është sjellë për gjykim vetëm një i pandehur, shtetas i huaj, ndërkohë që shtetasit shqiptarë apo të huaj që kanë përfshirë të pandehurin, nuk u identifikuan. I pandehuri nuk është pyetur asnjëherë nga prokuroria që nga data e ndalimit, një mangësi tjetër hetimore nën dritën e detyrimit procedural të prokurorit nga neni 256 i KPrP. Ky qëndrim pasiv i Prokurorisë u dëshmuar edhe gjatë gjykimit, në kushtet kur dëshmitarët e thirrur nga gjykata nëpërmjet policisë gjyqësore të Prokurorisë, nuk u dëgjuan asnjëherë, me gjithë thirrjet e gjykatës, duke cenuar parimin e marrjes së provës në mënyrë të drejtpërdrejtë nga gjykata.

37.15. Trupi gjykues i analizoi faktet e prezantuara në vendimin e gjykatës nën dritën e neneve 73, pika 1 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016 dhe vlerësoi se mungesa e theksuar e veprimeve hetimore kritike për identifikimin e gjithë personave të përfshirë, referuar edhe nga vendimi i gjykatës, ka çuar në pandëshkueshmërinë e një rrethi të caktuar personash të përfshirë në një veprimtari kriminale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore. Në kushtet kur asnjë nga mosveprimet e konstatuara nuk bën pjesë në interpretimin e logjikës së subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, në cilësinë e prokurores së çështjes, veprimet e munguara në hetimin e kryer prej saj, parë nën dritën e aftësive për të ndërmarrë logjikshëm hetimin dhe mbledhur provat e domosdoshme për identifikimin e pritësve porositës të lëndës narkotike në Shqipëri, kanë dëmtuar hetimin. Këto mosveprime janë deduktime të drejtpërdrejta të logjikës së fakteve: z. P. T. ka ardhur në Shqipëri për të marrë pagesën e lëndës narkotike [kokainë] nga pritësit e ndodhur në territorin e Shqipërisë, ka kontaktuar disa persona gjatë qëndrimit të tij në Shqipëri, dhe autoritetet e huaja ligjzbatuese kanë sinjalizuar destinacionin e dërgesës në Shqipëri. Në këto rrethana, pasiviteti për të hetuar për destinacionin e kokainës dhe identitetin e pritësve, ashtu si edhe pasiviteti për të pyetur të pandehurin apo dëgjuar dëshmitarët e thirrur nga gjykata, kanë passjellë dëmtimin e hetimit në mënyrë të pakorrigjueshme.

37.16. Për sa më lart, pasi i analizoi dy procedimet penale të shtjelluara më sipër, nën dritën e nenit 44, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe të neneve 73, pika 2, dhe 74, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 96/2016, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se hetimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, në cilësinë e prokurores që ka ushtruar ndjekjen penale, rezultojnë me mangësi në veprimtarinë hetimore të tyre, si pasojë e të cilave është dëmtuar cilësia e hetimeve, duke passjellë pandëshkueshmërinë e çdo pjesëmarrësi në veprimtarinë kriminale.

37.17. Për sa i përket procedimit penal që lidhet me të pandehurin Xh. M., trupi gjykues konstaton që nga analiza e detajuar e akteve në fashikull, rezulton që në veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, nuk rezultojnë mangësi. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se cilësimi i veprës penale dhe masa e sigurisë kanë qenë koherentë, qëndron.

D. Lidhur me çështje të etikës dhe vlerësimit tërësor

38. Në ankim dhe në seancën gjyqësore në Kolegj, Komisioneri Publik ka evidentuar sa përcjellin vëzhguesit ndërkombëtarë nëpërmjet gjetjeve të paraqitura nga ONM-ja gjatë hetimit administrativ të Komisionit për vlerësimin e etikës dhe vlerësimin tërësor të çështjes dhe në rekomandimin për ankim, përfshirë pretendimin se sjellja e subjektit të rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore në Komision, edhe e parë e vetme, konsiderohet e mjaftueshme për minimin e besimit në sistemin e drejtësisë. Komisioneri Publik vlerëson se gjetjet duhet të vlerësohen nga Kolegji në cilësinë e provës, në vlerësimin tërësor të çështjes, bazuar në parashikimet e pikës 2, nenit 4 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

38.1. Komisioneri ka evidentuar tri gjetje të ONM-së, e konkretisht: (i) atë të datës 30.09.2020, që lidhet me ndikimin tek ish-vëzhguesi ndërkombëtar Hans Kijlstra, dhe argumentohet për sjellje joprofesionale dhe joetike e ndikim të paligjshëm në procesin e rivlerësimit; (ii) gjetjen e datës 21.10.2020, lidhur me procedurat gjyqësore të zgjidhjes së martesës nga subjekti i rivlerësimit, dhe së fundmi; (iii) gjetjen e datës 21.12.2020, që lidhet me dorëheqjen e njëres prej anëtareve të trupit gjykues të Komisionit, argumentuar si pasojë e sjellës joprofesionale dhe joetike të subjektit të rivlerësimit. Shkurtimisht, argumentohet sa vijon në secilën prej tyre.

(i) Në gjetjen e datës 30.9.2020, vëzhguesi ndërkombëtar parashtron dy aspekte, një situatë të relatuar atij nga ish-vëzhguesi ndërkombëtar [Hans Kijlstra], si dhe një denoncim nga një individ me emrin Rr. Sh.. Sa i përket çështjes së parë, rezulton se më 5 shtator 2020, z. Kijlstra ka dërguar nëpërmjet postës elektronike një deklaratë në të cilën trajton disa ngjarje të periudhës kur ai ishte vëzhguesi ndërkombëtar i caktuar në çështjen e rivlerësimit të subjektit, znj. Elizabeta Imeraj. Nga *e-mail*-i rezultojnë tri momente kohore me rëndësi: (i) letra e dërguar nga subjekti i rivlerësimit më 16 tetor 2019 ku ajo ankohej se një qytetar pretendon se ka dijeni që vëzhguesi [“holandez”] Kijlstra do ta shkarkojë; (ii) një kërkesë e saj një ditë më pas për përjashtimin e vëzhguesit mbi bazën e kësaj letre dhe pretendimeve në të për mungesë paanësie nga vëzhguesi; (iii) dhe një *e-mail*, dërguar prej saj më 4 nëntor 2019, direkt z. Kijlstra, në adresën e tij zyrtare. Në *e-mail* subjekti shpreh bindjen për paanësinë dhe profesionalizmin e z. Kijlstra dhe referon probleme shëndetësore të sajat. Vëzhguesi ndërkombëtar [Theo Jacobs] argumenton se nëpërmjet *e-mail*-it të datës 4 nëntor 2019, subjekti i rivlerësimit ka kryer sjellje joprofesionale dhe ka shkelur etikën në përpjekje për të ndikuar në procesin e rivlerësimit. Ndërsa sa i përket denoncimit të individit të identifikuar si Rr. Sh., vëzhguesi argumenton se sa referohet në letrën e tij, konfirmon informacionin e përcjellë nga ish-vëzhguesi ndërkombëtar për kohën e zgjedhur nga subjekti i rivlerësimit për të dërguar *e-mail*-in – në mëngjesin e fluturimit të tij kthyes në Shqipëri nga Amsterdami – për dijeninë e subjektit nëpërmjet veprimeve të paligjshme tëurvejimit, për lëvizjet e vëzhguesve apo të dhëna të tjera me natyrë personale.

(ii) Në gjetjen e datës 21.12.2020, duke marrë shkas nga kërkesa për përjashtim kryer nga njëra nga anëtarët e trupit gjykues të shortuar në Komision – pranuar me vendimin e datës 3 dhjetor 2020 – vëzhguesi ndërkombëtar sjell në pah disa probleme që tregojnë se subjekti i rivlerësimit ishte në dijeni të veprimeve të kryera në Komision gjatë përgatitjes së çështjes, që pretendimet e

komisioneres Çiftja, si edhe ato të ish-vëzhguesit Kijlstra tregojnë për një mënyrë sjelljeje të mirëmenduar të subjektit, për të ushtruar ndikim të paligjshëm duke iniciuar komunikim direkt me një komisionere. Në konkluzion, vëzhguesi identifikon sjellje joetike dhe joprofesionale nga subjekti i rivlerësimit, në kushtet kur komisionerja referon se është kontaktuar nga persona të ndryshëm që kanë shprehur “shqetësimet” e subjektit të rivlerësimit.

38.2. Pasi ka administruar shpjegimet e paraqitura nga subjekti, Komisioni konkludoi se nuk ka sjellje joprofesionale të subjektit apo që përbëjnë shkelje etike, dhe nuk mund të paragjykojë kërkesën për heqje dorë të komisioneres, në kushtet kur një trupë gjykuese e ka marrë në shqyrtim dhe është shprehur me vendim duke e pranuar atë. Komisioni konstatoi se nuk rezultoi asnjë e dhënë apo provë që të lidhë subjektin e rivlerësimit me pretendimin e ngritur përurvejim në shkelje të ligjit dhe vëzhguesi nuk e ka adresuar shqetësimin e tij gjatë qëndrimit në Shqipëri në asnjë nga agjencitë kompetente për ndjekjen e rastit.

38.3. Në prapësimet e saj, subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, ka theksuar se pretendimi për sjellje joetike/ushtrimi i ndikimit të paligjshëm në procesin e rivlerësimit, nuk qëndron. Ajo mohoi të ketë dijeni të detajeve të jetës personale të ish-vëzhguesit ndërkombëtar Hans Kijlstra dhe nuk ka asnjë përfshirje në ndonjë përgjim të mundshëm të vëzhguesit. Përgjimi përbën veprën penale të “shpërdorimit të detyrës” nëse kryhet në funksion të detyrës, ndërsa në rang privat, përbën veprën penale të përndjekjes, e si rrjedhojë duhet t’i nënshtrohet një hetimi penal dhe jo administrativ. Pretendimet për përpjekje për ndikim janë të pavërteta, dhe se ndihet “e fyer” dhe “e intimiduar” nga ky pretendim “i prezantuar si gjetje”. Kërkesat e bëra prej saj duhet të lexohen siç janë prezantuar prej saj. Subjekti po ashtu mohoi çdo lidhje direkte apo indirekte me kërkesën për heqje dorë të komisioneres Çiftja, dhe që institucionet nuk disponojnë asnjë informacion për ndonjë problematikë të tillë.

38.4. Nga përmbajtja e vendimit të Komisionit nuk rezulton analizë për sa parashtrohet në secilën nga dy gjetjet, në zbatim të përcaktimit të nenit 49, pika 10¹¹² e ligjit nr. 84/2016. Për sa u përket çështjeve ligjore të ngritura në gjetjen e datës 30.09.2020, Komisioni ka riprodhuar tekstualisht pretendimet e subjektit përkundër sa argumentohet në gjetje, në 12 faqe¹¹³ të vendimit. Në konkluzion, është e paqartë se si janë vlerësuar këto çështje nga Komisioni. Kështu, Komisioni ka konstatuar vetëm që, sa denoncohet nga z. Rr. Sh., nuk mbështetet në akte zyrtare, ndërsa nuk rezulton asnjë analizë për sa i përket aspektit kryesor të gjetjes, kontaktimi direkt i një vëzhguesi nga subjekti i rivlerësimit dhe si mund të interpretohet ky veprim në kontekstin profesional apo në atë të procesit të rivlerësimit. Për sa i përket gjetjes së datës 21.12.2020, që lidhet me pretendime për ndikim të paligjshëm ndaj një komisionereje, konstatohet se në vendim mungon një analizë e argumenteve të parashtruara nga gjetja, në zbatim të nenit 49, pika 10, ndonëse Komisioni ka zgjedhur të riprodhojë literalisht pretendimet e subjektit të rivlerësimit për pesë (5) faqe¹¹⁴. Në

¹¹² Shih edhe poshtëshënimin nr. 67.

¹¹³ Faqe 83-95 e vendimit të Komisionit, me germa të pjerrëta.

¹¹⁴ Faqe 106-111 e vendimit të Komisionit, me germa të pjerrëta.

vijim të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimi i Komisionerit se qëndrimi i Komisionit ka qenë vetëm konstatues, është i bazuar.

38.5. Përpos sa shtjellohet më sipër, në lidhje me prapësimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, ndaj shkaqeve të ankimit, në parashtrimet e saj në seancën gjyqësore publike në Kolegj, subjekti argumentoi edhe se dërgimi i *e-mail*-it vëzhguesit Kijlstra ka qenë një zgjedhje personale e saj, pa asnjë tendencë, e që nuk përbën shkelje të ligjit nr. 84/2016. Sa u përket çështjeve të parashtruara si pasojë e kërkesës për heqje dorë të komisioneres, subjekti i rivlerësimit argumentoi që bëhet fjalë për veprime subjektive dhe shqetësime emocionale të komisioneres, të cilat nuk mund t'i atribuohen asaj [subjektit] dhe, për analogji, shpjegoi se si ajo i përballon këto probleme në përditshmërinë e saj. Ajo kontestoi edhe mënyrën se si pretendohet të ketë ndikuar dhe theksoi që është normale që shqetësimi për mbarëvajtjen e procesit të rivlerësimit, është pritshmëri. Së fundmi, subjekti parashtroi se në gjetjet e parashtruara nga vëzhguesi ndërkombëtar, prezantohen edhe fakte penale të cilat passjellin rregulla procedurale specifike për barrën e provës. Në mbështetje të këtyre argumenteve, subjekti referoi se ka depozituar edhe një kallëzim penal për të hetuar në lidhje me: (i) nëse është përgjuar z. Kijlstra¹¹⁵, rrethanat dhe autorët; (ii) nëse ka pasur presion të ushtruar dhe në çfarë rrethanash, mbi anëtarët e ndryshëm të trupës gjyqësore [të Komisionit]; (iii) identitetin e personit/personave që kanë falsifikuar denoncimin e përcjellë nën identitetin e z. Rr. Sh..

38.6. Në mbështetje të pretendimeve të saj përkundër këtij shkakut ankimi, subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, ka kërkuar edhe administrimin si prova të shtatë (7) akteve, duke kërkuar njëkohësisht nga trupi gjykues i Kolegjit që të marrë në cilësinë e provës informacion mbi një procedim penal të nisur prej saj në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Ndër aktet e përcjella prej subjektit, renditen: (i) një kërkesë e subjektit për informacion asaj prokurorie; dhe (ii) përgjigjja mbi kallëzimin penal të ushtruar nga ajo vetë [sipërcituar]; (iii) akte procedurale të administruara në kuadër të kallëzimit penal të ushtruar prej saj në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë [sipërcituar]¹¹⁶; (iv) përgjigje nga institucionet ligjzbatuese që konfirmojnë se nuk ka pasur asnjë të dhënë zyrtare që mbështet pretendimet e z. Kijlstra dhe të znj. Çiftja; (v) verifikime të kryera nga subjekti për personat me emrin Rr. Sh.; (vi) përgjigje nga SPAK-u që konfirmon se nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal në emër të subjektit të rivlerësimit, kurse lidhur me denoncimet e përcjella nga vëzhguesi i ONM-së, ka rezultuar se nuk është identifikuar ndonjë shtetas me emrin V. Y. dhe, në bazë të nenit 283/3 të Kodit Penal, është përcjellë për verifikim institucioneve të tjera. Lidhur me kallëzimin penal nr. 702 prot., datë 28.12.2020, të shtetases E. F., kjo prokurori ka vendosur ta dërgojë për vlerësim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan me shkresën nr. {***} prot., datë 30.12.2020; dhe (vii) një vendim i Fakultetit të Drejtësisë i vitit 1999, që ka marrë masën disiplinore të pezullimit për ish-bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit gjatë kohës kur ai ndiqte studimet. Një analizë e këtyre akteve shtjellohet në vijim.

¹¹⁵ *Procedimi penal me numër 2883/2021.*

¹¹⁶ *Procedimi penal me numër 2252/2021.*

38.7. Në analizë të sa është përmbledhur më sipër, pasi mori në konsideratë gjithë aktet në fashikull dhe pretendimet në seancën gjyqësore publike në Kolegj, trupi gjykues vëren se sjellja e subjektit të rivlerësimit përbën qasje të papranueshme në procesin e rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa që përcjellin një qasje joprofesionale dhe në mospërputhje me detyrimin që lind nga neni 48 i ligjit nr. 84/2016 për sjellje bashkëpunuese. Nëse shqetësim do të ishte kryerja e një hetimi të drejtë dhe të thelluar, subjekti mund të përcillte provat në formën dhe rrugën e parashikuar me ligj. Komunikimi me një subjekt procedural, qoftë ai/ajo vëzhgues, apo anëtar/e i një prej institucioneve të rivlerësimit, nuk mund të perceptohet ndryshe, përveçse një ndërhyrje e drejtpërdrejtë ndaj pavarësisë së këtyre individëve në kryerjen e detyrës së tyre. Pavarësisht përbajtjes së korrespondencës elektronike, trupi gjykues vlerëson se vendosja e kontakteve personale, të drejtpërdrejta dhe jashtë formës së parashikuar nga ligji, për çfarëdo arsye, nga subjektet e rivlerësimit me pjesëmarrës në proces në kapacitet zyrtar, qofshin këta anëtarë të institucioneve të rivlerësimit apo vëzhgues ndërkombëtarë, është një sjellje e papërshtatshme për subjektet e rivlerësimit dhe, për pasojë, e papranueshme.

38.8. Për sa i përket problematikës së ngritur në gjetje si pasojë e heqjes dorë të anëtares së trupit gjykues në Komision, trupi gjykues vëren se në rrethanat faktike dhe ligjore të parashtruara, e konkretisht, në kushtet kur një komisioner ndihet nën ndikim të paligjshëm, ligji nr. 84/2016 ka parashikuar rregulla specifike. Nuk rezulton nga aktet që komisionerja të ketë ndjekur ndonjë nga hapat e parashikuar nga ligji. Ndërkohë, në kushtet kur vendimi i trupës gjykuese të Komisionit për pranimin e heqjes dorë, është i paankimueshëm dhe nuk rezulton që komisionerja ta ketë materializuar shqetësimin e saj në veprime institucionale përtej heqjes dorë, trupi gjykues i Kolegjit çmon se kjo çështje nuk paraqet asnjë arsye ligjore që të diktojë përsiatje të mëtejshme.

38.9. Trupi gjykues i Kolegjit, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të mos e pranojë kërkesën për informacion për procedimin penal me numër 2252/2021 pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës [kallëzimi penal i ushtruar nga subjekti i rivlerësimit] lidhur me gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, të datave 30.09.2020 dhe 21.12.2020, analizuar më sipër. Në këtë konkluzion, trupi gjykues pati në konsideratë që, parë në dritën e dispozitave të nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur aktet në fashikuj përmbajnë dokumentacion të mjaftueshëm për vendimmarrjen, çdo informacion mbi kallëzimet penale të ushtruara nga subjekti i rivlerësimit për ndikimin e paligjshëm ndaj z. Kijlstra apo znj. Çiftja, është i panevojshëm.

38.10. Shkaqet e tjera të ankimit të pashtjelluara më sipër, që lidhen me etikën dhe vlerësimin tërësor, u konsideruan jopërcaktuese për kontrollin e vendimit objekt shqyrtimi, në kushtet kur si rezultat i vlerësimit të tri kritereve të sipërcituara, u arrit një vendimmarrje për zgjidhjen e çështjes. Për të njëjtat arsye, edhe aktet e sjella nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provës, si dhe kërkesat e saj procedurale për sa u përket këtyre aspekteve, konsiderohen të panevojshme për trajtim të mëtejshëm në këtë arsyetim.

39. Në analizë të pretendimeve të përfaqësuesit ligjor të subjektit të rivlerësimit, z. Thuan, referuar gjerësisht në paragrafin 26.2, lidhur me prezencën e vëzhguesve ndërkombëtarë në këshillim, parë në kontekstin e të drejtave të subjektit të rivlerësimit për proces të rregullt, trupi gjykues së pari vëren se nga leximi harmonik i dispozitave kushtetuese dhe ligjore, që normojnë rolin dhe detyrat ONM-së dhe vëzhguesve, rezultojnë qartë që vëzhguesit nuk kanë përgjegjësi të natyrës së ekspertit, të një pale në proces apo një anëtar të pavarur vendimmarrës. ONM-ja kryen *monitorimin* dhe *mbikëqyrjen* e procesit. Nëpërmjet vëzhguesve, ky rol dybinarësh materializohet, ndër të tjera, në formën e gjetjeve dhe mendimeve, paraqitjes së rekomandimeve dhe aksesit të informacionit që lejojnë këto detyra në kohë reale dhe në të gjitha fazat¹¹⁷. Kjo dinamikë është *sui generis*, dhe ka marrë parasysh natyrën kalimtare dhe të jashtëzakonshme të procesit të rivlerësimit dhe qëllimet për të cilat ligjvënësi e konsideroi procesin të domosdoshëm për kthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Për pasojë, këto pretendime të përfaqësuesit ligjor rezultojnë të pabazuara, pasi nuk mbështeten në sa ka rregulluar GjEDNj-ja nëpërmjet jurisprudencës së saj dhe janë në përputhje me garancitë e sanksionuara në atë kontekst.

39.1. Procesi i rivlerësimit bazohet tërësisht në parimet e procesit të rregullt, të sanksionuara nga Kushtetuta dhe normat ndërkombëtare të cilat zbatohen drejtpërdrejt nga gjykatat në Shqipëri, përfshirë edhe Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Për sa më sipër, në kushtet kur vëzhguesit ndërkombëtarë nuk luajnë rolin e ekspertit apo të palës në proces, duke pasur parasysh mbi të gjitha ngritjen e rolit të tyre në nivel kushtetues, trupi gjykues çmon se problematikat e konstatuara në shkeljet e nenit 6 § 1 nga GjEDNj-ja, për shkelje të gjykimit kontradiktor apo të pamjes së mundësishme të paanësisë, ndër të tjera në *Kress* dhe *Martinie*, nuk mund të argumentohet se gjejnë zbatim në procesin e rivlerësimit. Sjellim në vëmendje në këtë kontekst, që subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, është njohur me të gjitha mendimet dhe gjetjet e vëzhguesve, si dhe me rekomandimin e shtesën e tij dhe ka dhënë qëndrimin e saj qoftë në Komision, ashtu edhe në Kolegj. Për pasojë, edhe arsyetuar në nivelin e rrethanave të çështjes konkrete, të drejtat e subjektit për një proces kontradiktor nuk janë kontestuar asnjëherë. Po ashtu, në procesin e subjektit të rivlerësimit janë përfshirë vëzhgues të ndryshëm ndërkombëtarë, përfshirë edhe në seancën gjyqësore në Kolegj. Për rrjedhojë, edhe nëse analizohen konkluzionet e GjEDNj-së në *Kress* në një këndvështrim tejet garantist dhe që abstragon nga sa arsyetohet më sipër mbi dallimin esencial mes rolit të ONM-së edhe atij të ekspertit, nuk mund të argumentohet se vëzhguesi i caktuar në procesin gjyqësor në Kolegj, kishte shprehur mendime më parë për subjektin e rivlerësimit.

40. Në të njëjtën, linjë trupi gjykues i sheh të pabazuara në ligj edhe pretendimet që lidhen me mundësinë e vëzhguesve për të influencuar vendimmarrjen apo për shkak të së drejtës që ata gëzojnë për të nisur procedim disiplinor ndaj anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit. Së pari, siç dëshmon ky arsyetim dhe procesi gjyqësor publik i zhvilluar, trupi gjykues i Kolegjit ka kryer një vlerësim të pavarur të fakteve dhe ligjit dhe të pretendimeve të palëve. Përfundimet për çdo shkak ankimi, bazohen mbi këtë analizë të hollësishme të kryer nga Kolegji, përfshirë edhe me ndihmën e Njësisë së Shërbimit Ligjor, për çdo kriter të ankimit, përfshirë edhe aspektet financiare

¹¹⁷ Neni B, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 5, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

në kriterin e vlerësimit të pasurisë. Më fjalë të tjera, vetë analiza e shtjelluar në këtë vendim, zhbën argumentin që trupi gjykues ka qenë influencuar në vendimmarrje nga vëzhguesit. Ky vlerësim mbështetet edhe në faktin që përkundër sa ka pretenduar subjekti në procesin gjyqësor në Kolegj, trupi gjykues i Komisionit rezultoi të ketë marrë një vendim jashtë “ndikimit” të vëzhguesit të caktuar nga ONM-ja në atë fazë të procesit. Subjekti kërkoi lënien në fuqi të atij vendimi pasi ishte dakord me gjithë konkluzionet e arritura nga Komisioni. Me fjalë të tjera, pretendimi i përfaqësuesit ligjor do të bënte kuptim teorikisht, nëse subjekti do të kërkonte ndryshimin e vendimit. Së fundmi, të drejtën për nisjen e procedimit disiplinor për anëtarët e institucioneve të rivlerësimit nuk e kanë vëzhguesit ndërkombëtarë ekskluzivisht. Sipas nenit 17, pika 1, gjerat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, çdo anëtar i institucioneve të rivlerësimit ka të drejtë të kërkojë fillimin e hetimit disiplinor për të barabartët e vet. Për më tepër, sipas përcaktimeve në vijim të së njëjtës dispozite, janë gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit ata që kanë tagrin përfundimtar vendimmarrës për procedurën disiplinore. Në këto kushte, nëse do të pranohej argumenti i përfaqësuesit ligjor për ndikim potencial serioz ndaj pavarësisë së komisionerëve, nën dritën e ligjit, hipotetikisht, ky ndikim do të duhej t’i atribuohet Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, dhe jo vëzhguesve ndërkombëtarë. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i përfaqësuesit ligjor të subjektit të rivlerësimit rezultoi i pabazuar në fakte dhe ligj.

41. Po ashtu, përfaqësuesi ligjor i subjektit të rivlerësimit i kërkoi trupit gjykues të Kolegjit të deklarojë të papranueshme katër (4) gjetje¹¹⁸ ose t’i rrëzojë ato si të pabazuara. Siç është trajtuar më sipër, me vendimin e ndërmjetëm të shpallur në datën 04.04.2022, trupi gjykues vlerësoi që gjetjet e vëzhguesve ndërkombëtarë, në zbatim të nenit B, pika 3, germa “b” e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016, përbëjnë provë në vetvete dhe, si të tilla, iu nënshtruan shqyrtimit gjyqësor. Sipas të njëjtave dispozita, organet e rivlerësimit kanë diskrecion që t’i refuzojnë gjetjet vetëm pas kryerjes së një analize gjithëpërfshirëse dhe arsyetimi në harmoni me të gjitha provat. Po ashtu, edhe aktet mbi të cilat mbështeten gjetjet e rekomandimet e ONM-së, duke qenë pjesë integrale e tyre, shqyrtohen nga organet e rivlerësimit. Për këto arsye, trupi gjykues vendosi që shqyrtimit dhe analizës nga trupi gjykues i Kolegjit, t’i nënshtrohen edhe shtojca e rekomandimit të ONM-së të datës 29.06.2021, me katër [4] dokumentet mbështetëse të listuara në faqen 3 të saj, akti i përcjellë në adresë të Kolegjit më datë 08.07.2021 [nr. ref. 408/4], dhe gjetja e datës 4 shkurt 2022, së bashku me dokumentet shoqëruese.

41.1. Në vijim të sa është theksuar më sipër, për arsyetimin vetëm të akteve procedurale mbi të cilat u bazua vendimmarrja, trupi gjykues do t’i analizojë pretendimet e përfaqësuesit ligjor vetëm në funksion të vlerësimit të aspekteve që kanë pasur relevancë në zgjidhjen e çështjes. Për pasojë,

¹¹⁸ Ndonëse në titullin III, përfaqësuesi referon tri gjetje, në përmbajtjen e kësaj pjese të parashtrimeve detajon katër gjetje, e konkretisht: gjetjen me nr. prot. 1001, datë 21.12.2020, që lidhet me kërkesën për heqje dorë të ushtruar nga komisionerja E. Çiftja; gjetjen me nr. prot. 850, datë 21.10.2020, që lidhet me dënimin e ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe ish-kunatin nga gjykata italiane në dhjetor 2002 dhe rrethanat lehtësuese për mungesë dijenie; gjetjen nr. 849, datë 21.10.2020, që lidhet me fiktivitetin e divorcit, bazuar në denoncimin e Rr. Sh., më 24 gusht 2020; dhe gjetjen nr. 764 datë 30.09.2020, që lidhet me deklaratën e nderit nga ish-vëzhguesi Hans Kijlstra dhe denoncimi i Rr. Sh..

ky pretendim i përfaqësuesit ligjor do t'i nënshtrohet analizës në funksion të sjelljes së subjektit të rivlerësimit, pasi u njoh me gjetjen për vendimin penal për ish-bashkëshortin dhe ish-kunatin, në kontekstin e procesit të rivlerësimit [gjetja nr. 850 e datës 21.10.2020] dhe në funksion të *e-mail-it* të dërguar prej saj ish-vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra. Pa përsëritur analizën e themelit dhe konkluzionet për këto dy aspekte, shtjelluar gjerësisht më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se minimalisht për këto dy elemente, gjetjet përbëjnë provë dhe dëshmojnë *një fakt e rrethanë që ka ndodhur*¹¹⁹. Asnjë nga dy këto dy aspekte nuk i referohet një prezumimi të pafuzueshëm. Konkretisht, siç është arsyetuar më sipër, identiteti i ish-bashkëshortit dhe ish-kunatit të subjektit të rivlerësimit qartazi është ai i personave të dënuar. Edhe ndërthurja e interesave financiarë të subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, me ish-kunatin, provuar me dokumentacion dhe nga pretendimet e saj¹²⁰ – arsyetuar gjerësisht më sipër – është po ashtu fakt i pakontestueshëm. Është mënyra se si subjekti i rivlerësimit ka zgjedhur ta ndërtojë rolin e saj procedural, pasi është ballafaquar me fakte të pakontestueshme në saje të dokumentacionit zyrtar, që ka përbërë objekt vlerësimi që ka kryer trupi gjykues në proces. Arsyetimi më sipër është shterues edhe në këtë drejtim. Për të njëjtën logjikë, në kushtet kur është fakt i pakontestuar që subjekti i rivlerësimit ka kontaktuar direkt vëzhguesin ndërkombëtar, është vlerësimi i kryer më sipër nga Kolegji për papërshtatshmërinë e veprimeve të tjera dhe pasojat e tij, që paraqesin relevancë në procesin e rivlerësimit. Për rrjedhojë, jurisprudenca e referuar e GjEDNj-së për prezumimet faktike apo thëniet, nga përfaqësuesi ligjor, nuk gjen zbatim as në nivel teorik në rrethanat konkrete faktike.

41.2. Është po ashtu fakt i pakontestueshëm që subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, është njohur me gjetjet në çdo hap të procesit dhe ka dhënë qëndrimin e saj. Në këto kushte, garancitë e saj procedurale, përfshirë edhe parimin e barazisë së armëve, janë respektuar në çdo fazë procedurale, për çdo gjetje, përfshirë edhe pjesët e tyre që kanë relevancë në vendimin e Kolegjit.

- 42.** Së fundmi, përfaqësuesi ligjor kërkon nga trupi gjykues të mos zbatohet neni 61 i ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti i rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, nuk gjendet në asnjë nga situatat ligjore të përcaktuara: dyfishi i pasurisë, deklarimi i pamjaftueshëm i pasurisë dhe figurës, nuk është e papërshtatshme në kriterin e vlerësimit profesional dhe nuk ka cenuar besimin e publikut. Trupi gjykues risjell në vëmendje se arsyetimi i mësipërm është shterues për sa i përket konstatimit të deklarimit të pamjaftueshëm në kriterin e kontrollit të vlerësimit të pasurisë. Subjekti është vlerësuar në situatën e deklarimit të pasaktë dhe mungesës së burimeve për të kryer shpenzimet ndër vite. Sa i përket cenimit të besimit të publikut, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se

¹¹⁹ Neni 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016.

¹²⁰ Konkretisht, kontributi i ish-kunatit në ndërtimin e njërit prej kateve dhe kredia bankare e marrë nga ish-bashkëshorti në janar 2008 për të shlyer një hua të ish-kunatit. Në përgjigje të rezultateve të hetimit të parë administrativ, subjekti ka referuar një shumë prej 6,9 milionë lekësh nga ish-kunati për ndërtimin e godinës 5-katëshe ku ajo ka jetuar gjatë martesës. Ndërkohë, subjekti ka qenë garantuese e kredisë prej 100 mijë eurosh, pjesë e së cilës është përdorur për një hua prej 45 mijë eurosh, të marrë nga ish-kunati, sipas huadhënësve deklarues. Shih arsyetimin më sipër për pasurinë në rrugën “{***}” dhe shlyerjen e kredisë së marrë në vitin 2008.

ky vlerësim është pasojë e disa hapave të ndërmarrë në analizë, të cilët kanë passjellë këtë konstatim.

43. Së pari, cenimi i besimit të publikut, parashikuar si një ndër situatat ligjore që passjellin masën disiplinore të shkarkimit, rezulton si një zberthim në ligj i nevojës për të cilën është krijuar sistemi i rivlerësimit kalimtar në Republikën e Shqipërisë, parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës dhe nenin 1 të ligjit nr. 84/2016. Ky vlerësim për subjektin e rivlerësimit, shtjelluar gjerësisht më sipër, është pasojë e vlerësimit të Kolegjit se si veprimet dhe mosveprimet e demonstruara prej subjektit të rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës dhe jashtë saj, si dhe gjatë procesit të rivlerësimit, shihen nga një vëzhgues i pavarur dhe vlerësohen prej qytetarëve në drejtim të drejtësisë në tërësi¹²¹. Analiza për mënyrën se si magistratët duhet të normojnë sjelljen profesionale dhe personale në funksion të ruajtjes së besimit të publikut, për shkak të rëndësisë themelore që ajo ka për ekzistencën dhe funksionimin e shtetit të së drejtës, përfshin veprimet që mund të perceptohen si favorizuese ndaj palëve procedurale ose me standarde të dyfishta, respektimin e ligjit edhe në jetën personale, evitimi i përdorimit të detyrës për përfitime personale, ashtu si edhe një sërë elementesh të tjera. Trupi gjykues i Kolegjit konstatoi gjendjen e cenimit të besimit të publikut për subjektin e rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, mbi bazën e një analize të detajuar më sipër, që mori në konsideratë mangësitë në hetimet e kryera prej saj, që kanë sjellë pandëshkueshmëri të individëve të përfshirë në trafik narkotikësh, sjelljen e saj në procesin e rivlerësimit dhe ndërthurjen e interesave personale me një person të dënuar për vepra që përfshihen në krimin e organizuar, parë nga këndvështrimi i publikut.
44. Në përmbledhje të sa është konstatuar më sipër për kriterin e kontrollit të pasurisë, kriterin e figurës, kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, në analizë të problematikave të konstatuara, në një vlerësim të përgjithshëm të tri kriterëve të rivlerësimit dhe pas një vlerësimi tërësor të procedurave sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e këtij ligji.
45. Për pasojë, duke bërë një vlerësim të ndryshëm nga Komisioni të situatës faktike dhe të zbatimit të ligjit, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin që vendimi i Komisionit nr. 363, datë 01.04.2021, për subjektin e rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj, duhet të ndryshohet dhe subjekti i rivlerësimit të shkarkohet nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

¹²¹ Ndër të tjera, shtjelluar edhe në Komentarin për Parimet e Bangalores për Pavarësinë e Gjyqësorit dhe Opinionin nr. 3/2002 të CCJE në: <https://rm.coe.int/16807475bb>.

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 363, datë 01.04.2021, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 27.04.2022.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi